

Rrugat e Arbërit



www.rrugearberit.com

GAZETË E PAVARUR. NR. 5 (109). MAJ 2015. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

PROFIL

Biznesmeni që ringjall shpresat e fermerëve

NGA MIRAN TAFA - FAQE 14,15

KUJTESË

Profili i një personaliteti Krenar për ty!

NGA DR. LAURANT BICA

NGA ARDITA NURI ABDIU - FAQE 18,19

SPORT

Rikthimi i madh i Korabit në Kategorinë e parë

NGA S.NDREKA, D. METHASANI - FAQE 13

CIKEL POETIK nga

Halil Teodori

Redaksia e gazetës falënderon z. Halil Teodori për kontributin financiar të dhënë për botimin e gazetës. Ai jeton prej vitesh në SHBA dhe ka botuar disa libra në prozë dhe poezi. Një përshkrim më të zgjeruar të veprimtarisë së tij do të lexoni në numrat e ardhshëm të gazetës. Në këtë numër, në faqen 21, mund të lexoni një cikël poetik kushtuar Dibrës.

ZGJEDHJET VENDORE: PROBLEMET ME TË CILAT DO TË PËRBALLEN BASHKITË E REJA DHE ZGJIDHJET QË OFROJNË KANDIDATËT QË NË VITIN E PARË TË QEVERISJES

Programet e zhvillimit

Premtimet e kandidatëve për ndërtimin e infrastrukturës rrugore, arsimore dhe shëndetësore dhe prioritetet për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, turizmit, pyjeve etj. Sfidat dhe përgjegjësitë.



Punë dhe Dinjitet
Nezir Rizvanin për Matin

RIZVAN NEZIRI: Investimet publike do të adresohen në përmirësimin dhe ndërtimin e një infrastrukture rrugore bashkëkohore



ADELINA FARRICI
DREJTIMI I DUHUR
PËR MATIN

ADELINA FARRICI: Do t'i japim dorën njëri-tjetrit dhe do të ngrihem bashkë për të ecur përpara në drejtimin e duhur



Punë dhe Dinjitet
Ilir Krosi për Dibrën

ILIR KROSI: Bashkërisht ta dërgojmë Dibrën atje ku e meriton



SHUKRI XHELILI
DREJTIMI I DUHUR
PËR DIBRËN

SHUKRI XHELILI: Ta kthejmë Dibrën në drejtimin e duhur



Punë dhe Dinjitet
Basir Çupa për Klosin

BASIR ÇUPA: Brenda dy viteve do të shtrohen të gjitha rrugët lidhëse me çakull dhe asfalt



VALBONA KOLA
DREJTIMI I DUHUR
PËR KLOVIN

VALBONA KOLA: Qytetari do të jetë i pari në të gjitha proceset e vendimmarrjes së bashkisë



Punë dhe Dinjitet
Durim Balla për Bulqizën

DURIM BALLA: Punë dhe dinjitet për Bulqizën



MELAIM DAMZI
DREJTIMI I DUHUR
PËR BULQIZËN

MELAIM DAMZI: Më shumë shërbim dhe punësim

Tetë kandidatët nga dy forcat kryesore politike i janë përgjigjur disa pyetjeve që kanë të bëjnë me qeverisjen e nesërme lokale, në qoftë se kandidatët do të ishin fitues.

Pyetjet kanë të bëjnë me problematikat më emergjente që shfaqen në bashkitë përkatëse, zgjidhjen që ofrojnë kandidatët, synimet brenda vitit të parë të qeverisjes, kriteret për emërimet e administratorëve lokalë, mekanizmat që kanë të bëjnë me konsultimet me qytetarët, infrastrukturën shkollore dhe shëndetësore, zhvillimin bujqësor dhe blegtoral, administrimin e territorit, turizmin, pyjet etj.

Mbrojtja e Setës, Shoqata "Çidhna dhe Kastriotët"
u bën thirrje kandidatëve për kryebashkiakët të prononcohen

aktualitet



Gazetë e pavarur.
Nr. 5 (109). 1 - 31 Maj 2015

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më datë 20 të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:

Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:

Hysen LIKDISHA
Sashenka NDREKA
Abdurahim ASHIKU

Kontribuan për këtë numër:

Miran Tafa
Defrim METHASANI
Edmond HASANI
Laurant BICA
Ardita ABDIU
Islam SHAROFI
Dhimitër SHTËMBARI
Halil TEODORI
Viron GRAÇI
Besnik ALKU
Sulejman TOMÇINI
Illi DERVISHI
Mevlud BUCI
Fehmi LLESHI

Nuk do të votojmë kandidatët që nuk mbrojnë burimet natyrore të Setës



Shoqata "Çidhna dhe Kastriotët" vazhdon të mbledhë firma dhe të protestojë pranë institucioneve qendrore dhe lokale, lidhur me projektet për ndërtimin e një hidrocentrali mbi lumin Seta në Dibër.

Gjatë muajit Maj, një ekip i Ministrisë së Energjisë, i shoqëruar nga anëtarë të kryesisë së shoqatës realizuan një vëzhgim në terren. Anëtarët e kryesisë, Mustafa Tola dhe Ali Hoxha, së bashku me anëtarë të tjerë të shoqatës në vend, argumentuan nevojën e ndalimit të menjëhershëm të projekteve mbi lumin Seta, duke paralajmëruar pasoja të pariparueshme në mjedis dhe ekonominë e zonës.

Gjithashtu, kryesia e shoqatës u ka bërë thirrje partive politike, dhe veçmas kandidatëve për kryebashkiakë të Dibrës, të prononcohen për këtë çështje. "Kryesia e shoqatës ndjek në

vijimësi programet elektorale të kandidatëve për kryetarë bashkie dhe ka opsionet dhe rekomandimet e saj lidhur me përfshirjen në këtë fushatë të programeve të zhvillimit të kësaj zone", thuhet në një reagim të shoqatës.

"Shoqata jonë ka në përbërjen e saj mjaft intelektualë dhe banorë të kësaj krahine që janë votues të Bashkisë Peshkopi.

Ata mund të kontribuojnë në përmirësimin e programeve të forcave politike dhe kandidatëve për Kryetar Bashkie", thuhet në deklaratën e shoqatës.

Më pas, pasi bëhet një pasqyrë e resurseve historike e turistike të zonës, shoqata kërkon që kandidatët të marrin parasysh protestën e tyre në mbrojtje të burimeve të Setës

"Shoqata jonë është jo politike. Ne nuk ndërhyjmë në veprimtarinë elektorale të partive politike, por është në detyrën dhe programin

tonë të ngremë zërin në mbrojtje të zhvillimit të krahinës dhe ruajtjes së vlerave historike, etnokulturore, turistike dhe arkeologjike.

Ndaj kemi të drejtë t'ju kërkojmë kandidatëve për kryetar bashkie në Dibër të marrin në konsideratë kërkesat tona që njëkohësisht janë dhe kërkesat e banorëve dhe votuesve të tyre", thuhet në deklaratë.

Një anëtar i kryesisë tha për gazetën "Rruga e Arbërit" se ne jemi në pritje të reagimeve të kandidatëve për kryetar bashkie, veçanërisht Ilir Krosit dhe Shukri Xhelilit, se në qoftë se ndonjëri prej tyre është "pro" devijimit të burimeve të Setës, atëherë shoqata pak ditë para zgjedhjeve, do të dalë me një deklaratë ku do të bëjë thirrje popullit të Çidhnës që të votojnë kundër kandidatit, pavarësisht se cilën forcë politike përfaqëson.

Korresp. Rr.A

Bujar Kapexhiu zgjidhet kryetar i Bashkësisë Dibrane

Me rastin e 115 vjetorit të Bashkësisë Dibrane, në mjediset e Akademisë së Shkencave, me 2 maj 2015, u organizua një akademi solemne.

Në këtë veprimtari, krahas anëtarëve të kryesisë së SHBD dhe anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm të SHBD, ishin të pranishëm, studiues, intelektualë, qytetarë, përfaqësues të artit dhe të kulturës, si dhe kandidati për drejtimin e Bashkisë së Tiranës, Dr. Halim Kosova. Në këtë takim, Kosova shprehu publikisht edhe rrënjët e tij dibrane, nga nëna.

Në këtë veprimtari u vlerësuan nga Bashkësia Dibrane me Certifikata Mirënjohjeje disa figura të artit, kulturës, shkencës, mjekësisë, ndërtimit, sportit dhe besimit me prejardhja nga Dibra e Madhe. Nder këto figura përmendim: skenaristi dhe regjizori, Gëzim Erebara; kompozitori Agim Krajka; dijetari dhe eruditi, Hoxhë Said Najdeni (Hoxhë Vokri); doktori Azmi Dibra; aktori i njohur i skenës, Fadil Kujofsa; shkencëtar dhe matematicieni, prof. dr. Ylli Vejsiu; balerina e parë e operas, Mukades Erebara; patrioti Ibrahim Jegeni (Dibra); prof. dr. Hiqmet Gonxhe; mësuesi i popullit, Moisi Tërshana; ing. Irfan Findo; specialisti i sportit dhe basketbollit, Astrit Greva; prof. i shkencave Juridike, Zejnullah Ballanca, etj.

Një rezymë të veprimtarisë së SHBD-së, përgjatë periudhës 2010-2015 u bë nga Sekretari i Përgjithshëm, z. Saimir Shatku. Më pas, mbi risitë dhe të rejtat më të fundit mbi rrugën e shumëpritur të Arbrit foli z. Tefik Jegeni. Ky material ishte përgatitur nga projektuesi i kësaj rruge, dr. Faruk Kaba. Ndërsa me temën për "Mbrojtjen e Radikës, sfidat dhe identitetin e saj", hodhi dritë me fakte dhe argumente



Bujar Kapexhiu

historik, shkencor, të marrëveshje ndërkufitare të viteve 1947;1958;1962; studiuesi Ing.Tefik Jegeni.

Për të pranishmit, shfaqti interes referimi i shkrimtarit dhe publicistit z. Shpëtim Kodra, i cili foli për figurat kombëtare me prejardhje dibrane që përmenden në periudhën moderne në historinë dhe letërsinë shqiptare e atë europiane.

Me pas referuar statutit të SHBD (neni 4) dhe funksionit të Kryetarit të Shoqatës, u votua me konsensus nga anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm, përzgjedhja e Kryetarit me votim të hapur. Ndërsa si kandidat për të drejtuar Shoqatën u miratua me konsensus të plotë, ajo e anëtarit të Kryesisë së SHBD-së, prof. dr. Bujar Kapexhiu.

Pas zgjedhjeve, z. Kapexhiu foli shkurtimisht. Ai tha se së bashku dhe me ndihmën tuaj, do të bëjmë aktivitete, ku do të kënaqemi të gjithë.

KONSTITUOHET "KËSHILLI I TË URTËVE"

Në mbledhjen e parë të Shoqatës "Bashkësia Dibrane" në Tiranë u miratua kryesia e re, si organi më i lartë vendimmarrës dhe ekzekutiv i kësaj Shoqate. Nder të tjera, në fjalën e tij, Kryetari i ri i SHBD-së Prof. dr. Bujar Kapexhiu, vlerësoj punën dhe angazhimin e Kryesisë së shoqatës "Bashkësia Dibrane" në Tiranë në një sërë nismash, aktiviteteve, sociale, kulturore dhe akademike, duke përfshirë fokusin te ndërtimi i rrugës së Arbrit dhe problematikat e ekosistemit, të faunës dhe florës mbi lumin Radika.

Ai shtoi në fjalën e tij duke evidentuar faktin se ka vetëm një shoqatë "Bashkësi Dibrane", e cila do të përfaqësoj vlerat, trashëgiminë kulturore dhe qytetarinë e komunitetit dibrane në Tiranë. Ai ftoi komunitetin dibrane në Tiranë ti bashkohet këtyre nismave, në aktivitetet e SHBD-së.

Për herë të parë në këtë Shoqatë u përfshi dhe një organ me karakter konsultativ dhe këshillimor, që do të merret me problemet teknike, shkencore, si dhe të evidentimit të figurave të trashëgimisë kulturore të Dibrës së Madhe, i quajtur "Këshilli i të Urtëve";

Kryesia e re e Bashkësisë Dibrane përbëhet nga Bujar Kapexhiu kryetar dhe anëtarë Saimir Shatku, Mukades Erebara, Flamur Gjymishka, Roald Hysa, Edvin Cami dhe Mira Pirdeni.

Ndërsa në këshillin e të urtëve u zgjedhën Tofik Jegeni – kryetar, dhe anëtare Astrit Daci, dr. Orhan Sakiqi, dr. Faruk Kaba, prof. Shpëtim Kodra, Niazi Kosovrasti dhe Asim Prega.

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit www.rrugearberit.com.

Falënderojmë z. AGIM DEVA për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:

Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:

Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. + 355 4 22 33 283
+ 355 69 20 68 603

E-mail: rrugearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Ligji në ngërç, botohet në fletoren zyrtare, por Presidenti nuk e firmos

Nga BUJAR KAROSHI

LIGJI, PRESIDENTI NUK E FIRMOS

"Presidenti Bujar Nishani ka vendosur t'i vijë në ndihmë PD-së në këtë prag fushate", shkruani disa gazeta në versionet online më 20 maj, duke theksuar se ai ka vendosur të mos e dekretojë ligjin e miratuar në parlament më 16 prill 2015, për dhënien me koncesion të Rrugës së Arbrit kompanisë kineze "China State Construction Company".

Por, një ditë më parë, më 19 Maj 2015, në Fletoren Zyrtare nr. 78, faqe 3461, është botuar ligji nr. 41/2015, datë 16.4.2015, "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës koncesionare/PPP, me objekt ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Rrugës së Arbrit, ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërisë "China State Construction Company".

Ky ligji, sipas nenit 5 të tij, hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, kështu që efektet e tij fillojnë pas datës 3 qershor 2015.

Një jurist, i kontaktuar nga gazeta tha se "pavarësisht se ligji është botuar në fletoren zyrtare, ai nuk mund të merret për bazë në qoftë se nuk është dekretuar nga Presidenti".

I pyetur se pse ajo atëherë është botuar në Fletoren Zyrtare, ai tha se një gjë e tillë mund të jetë edhe gabim. Por, meqë ligji u votuar nga të dy krahët politikë në seancën e 16 prillit, ndoshta Presidenti nuk ka asnjë arsye politike për ta vonuar dekretimin. Ndoshta, sipas tij, meqë kontrata do të miratohet sërish në Parlament, ai edhe mund të mos e firmosë ligjin 41/2015, duke ruajtur të drejtën që ta vërë firmën e tij duke pasur një kontratë të miratuar në tavolinë.

"Argumenti se Presidenti me mungesën e firmës po ndihmon Partinë Demokratike në fushatë nuk qëndron. Mungesa e firmës së Presidentit mund të jetë një argument i mirë për qeverinë për të justifikuar vonesat e fillimit të punimeve".

Sipas ligjit të botuar në Fletoren Zyrtare, "procedura e negociimit për lidhjen e kontratës ndiqet nga Komisioni i Negocimit të Kontratës, kryesuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, dhe me anëtarë, përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Drejtësisë dhe Avokaturës së Shtetit". (Neni 2)

"Projektkontrata, e shoqëruar me relacionin përmblyllës të negociatave, brenda një afati prej 60 ditësh nga nisja e negociatave, i dërgohet për nënshkrim Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes" (Neni 1).

"Nënshkrimi i kontratës, thuhet në nenin 3 të ligjit, bëhet nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Ministri i Financave dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes pas dorëzimit të projektkontratës dhe relacionit përmblyllës të negociatave nga komisioni negociues. Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Ministri i Financave dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes mund t'i kërkojnë komisionit negociues rishikimin e projektkontratës" Ndërkohë, "Komisioni i Negocimit të Kontratës duhet të rinegociojë dhe t'u paraqesë për nënshkrim ministrave projektkontratën,

Fletorja Zyrtare Viti 2015 - Numri 78

LIGJ
Nr. 41/2015

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË PËR NEGOCIMIN DHE LIDHJEN E KONTRATËS KONCESIONARE/PPP, ME OBJEKT NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE MENAXHIMIN E RRUGËS SË ARBRIT, NDËRMJET SHQIPTAR DHE SHOQËRISË "CHINA STATE CONSTRUCTION COMPANY"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:
Neni 1
Qëllimi

Neni 3
Nënshkrimi i kontratës

Nënshkrimi i kontratës bëhet nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Ministri i Financave dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes.

Ky ligj përcakton procedurën...

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare Viti: 2015 - Numri: 78

Tiranë - E martë, 19 maj 2015

PËRMBAJTJA Faqe

Ligj nr. 41/2015
datë 16.4.2015

Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës koncesionare/PPP, me objekt ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Rrugës së Arbrit, ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërisë "China State Construction Company"..... 3461

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.4.2015 **KRYETARI**
Ilir Meta

Faqe|3461

shoqëruar me relacionin përmblyllës të negociatave brenda afatit kohor prej 30 ditësh, duke filluar nga data e kthimit".

Pas miratimit të kontratës nga tre ministrat, Komisioni i Negocimit të Kontratës harton projektligjin e miratimit të saj dhe ia dërgon për miratim Këshillit të Ministrave brenda një afati 10 ditor. Më pas, Kontrata do të miratohet në Kuvendin e Shqipërisë.

Pra, sipas ligjit të botuar në fletoren zyrtare një ditë më parë, afati më i afërt i nisjes së punimeve parashikohet në vjeshtë, në qoftë se gjithçka ecën normalisht.

Ministri i Transportit tha në seancën e 16 prillit se ato do të fillojnë në vitin 2016. Me sa duket, ai ka pasur parasysh procedurat burokratike që në Shqipëri nuk kanë afate.

KA PROJEKT - S'KA PROJEKT, DEBATI I VJETËR QË SHFAQET ÇDO FUSHATË

Gjatë prezantimit të kandidatit të Aleancës së Majtë në qytetin e Peshkopisë, Kryeministri Edi Rama e rivuri theksin edhe njëherë të ndërtimi i rrugës së Arbrit.

"U desh 23 qershori që ne t'i japim drejtim rrugës së Arbrit, tha ai. Pas votimit në parlament janë duke u zhvilluar negociatat përfundimtare

institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale".

Komisioni i Negocimit të Kontratës negocion me shoqërinë "China State Construction Company" propozimin e paraqitur pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe përpilon projektkontratën finale, shoqëruar me relacionin përmblyllës të negociatave.

Projektkontrata, e shoqëruar me relacionin përmblyllës të negociatave, brenda një afati prej 60 ditësh nga nisja e negociatave, i dërgohet për nënshkrim Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes.

Dyshimet se ka projekt - nuk ka projekt janë aq të vjetra sa historia e rrugës. Çdo parti në qeverisje ka theksuar se ose janë duke e hartuar projektin, ose e kanë përfunduar atë. Dhe vonesat në tenderim dhe ndërtimin e rrugës janë justifikuar gjithmonë me mungesën e një projekti tërësor, të detajuar dhe final.

janë justifikuar gjithmonë me mungesën e një projekti tërësor, të detajuar dhe final.

I kontaktuar nga gazeta, hartuesi i saj, Ing. Faruk Kaba, tha se nuk ishte në dijeni të deklaratës së kryeministrit. Ai theksoi se ka një projekt të rrugës të dorëzuar në Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe se ishte i gatshëm të mbronte çdo detaj të saj, kurdo që të ishte e nevojshme.

Sidoqoftë, pavarësisht rezultatin zgjedhor për të majtën në qarkun e Dibrës, pavarësisht faktit që Presidenti i Republikës nuk e ka firmosur akoma Ligjin, rruga e Arbrit duket se ka marrë një zgjidhje. Dhe sipas kryeministrit Rama, brenda pak muajve do të hapet përfundimisht kantieri i madh i rrugës së Arbrit. Dhe shpresojmë që ky deklaram të jetë jo sa për fushatë.

QEVERIA VENDOS SHPRONËSIMIN E BANORËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS

Qeveria shqiptare, me vendimin nr 321, datë 15 prill 2015, ka vendosur të shpronësojë banorët e Planit të Bardhë, në tokën e të cilëve do të kalojë Rruga e Arbrit.

"Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë për tokë "arë", "truall" dhe "objekte", me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 5 239 726.

Me këtë vlerë do të shpronësohen 3 719 m2 tokë arë, 1 060 m2 truall dhe objekte të tjera.

Vendimi përcakton pronarët, pasuritë e të cilëve janë konfirmuar nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive, të likuidohen pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Po ashtu, vendimi përcakton se brenda 30 ditëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, në favor të shtetit.

Sipas këtij vendimi, 17 familje nga fshati Plan i Bardhë do të shpronësohen. Familja e Bajram Skordha do të shpronësohet me vlerën më të vogël, 4030 lekë për 26 m2 tokë arë, ndërsa më shumë, 2332506 lekë, do të marrë familja e Hysen Tafës, e cila shpronësohet për 70 m2 tokë truall dhe shtëpinë në vlerën rreth 2.3 milionë lekë.

Si vlerë shpronësimi për objekte, kryesisht shtëpi, do të shpronësohet edhe familja e Sadik Allës, Hike Jaurri dhe B. Kuka.

Çmimi i shpronësimeve për tokën truall në vendim është përcaktuar 637 lekë/m2, ndërsa për tokën arë 155 lekë.

Mungesa e shpronësimeve në aksin Qafë e Buallit - Ura e Vashës, ka qenë një ndër arsytet e vonesave të ndërtimit të këtij segmenti.

Sipas ligjit të botuar në fletoren zyrtare, afati më i afërt i nisjes së punimeve parashikohet në vjeshtë, në qoftë se gjithçka ecën normalisht.

SHËNIM I REDAKSISË

Në kuadër të projektit "Nxitja e llogaridhënies në qeverisje vendore përmes pjesëmarrjes dhe gazetarisë qytetare", zhvilluar nga BIRN Albania me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë, tetë kandidatët nga dy forcat kryesore politike i janë përgjigjur disa pyetjeve që kanë të bëjnë me qeverisjen e nesërme lokale, në qoftë se kandidatët do të ishin fitues.

Pyetjet kanë të bëjnë me problematikat më emergjente që shfaqen në bashkitë përkatëse, zgjidhjen që ofrojnë kandidatët, synimet brenda vitit të parë të qeverisjes, kriteret për emërimet e administratorëve lokalë, mekanizmat që kanë të bëjnë me konsultimet me qytetarët, infrastrukturën shkollore dhe shëndetësore, zhvillimin bujqësor dhe blegtoral, administrimin e territorit, turizmin, pyjet etj.

Gazetari ynë **HYSEN LIKDISHA** ka realizuar intervistat dhe në po i botojmë në këtë raport special.

Titujt e intervistave janë nxjerrë nga redaksia, ndërsa fotot

ilustruese janë marrë mnga faqet në Facebook të kandidatëve për kryetarë bashkie.

Besojmë se në të ardhmen, kryetarët e bashkive do të jenë më bashkëpunues me median dhe gazetarët, për një informim më të mirë të qytetarëve, por edhe për një informacion më shumë rreth punës së të zgjedhurve lokalë në shërbim të komunitetit.

Gazeta këtë numër ka refuzuar botimin e disa opinioneve, komenteve dhe shkrimeve me synime elektorale, me qëllim që të mos ndikojë në fushatat elektorale. Dhe kjo për arsye se ne nuk kemi infrastrukturën e nevojshme të verifikojmë rastet për vërtetësinë e tyre.

Gazeta "Rruga e Arbërit", ashtu si deri më sot, mbetet e hapur ndaj informacioneve, opinioneve, komenteve dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me zhvillimin e qarkut të Dibrës, me zhvillimin ekonomik dhe social, si dhe më pozicionin e saj si një media e pavarur në shërbim të komunitetit.

Redaksia

zgjedhjet

Bëj pajtimin tënd me



përmes emailit

<rrugaearbërit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: 600 lekë.

Në Europë: 10 Euro.

Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

INTERVISTË / **ADELINA FARRICI,**

Kandidate e Aleancës së Shqipërisë Europiane për bashkinë Mat.

Do t'i japim dorën njëri-tjetrit dhe do të ngrihem bashkë për të ecur përpara në drejtimin e duhur

- Cili mendoni se është problemi më i madh i bashkisë së Matit dhe çfarë hapash do të ndërmerri për ta zgjidhur këtë problem gjatë mandatit tuaj?

Adelina Farrici: Problemi më i prekshëm është infrastruktura rrugore ndërlidhëse të zonave rurale dhe periferike me qendrën dhe çështjet e ujit të pijshëm dhe infrastrukturës vaditëse. Rrjedhimisht këto çështje madhore kanë ndikim të drejtpërdrejtë në punësim, prosperitet e zhvillim të qëndrueshëm të zonës.

Hapat që do të ndiqen janë strategjikisht të qartë: Plan zhvillimi strategjik i zonës, planifikim infrastrukturor, hartimi i projekteve, aprovimi nga qeveria me përparësi dhe zbatim i tyre, nxitja e tregtisë, punësimit dhe angazhimi i komunitetit për të përfutur një jetesë më të mirë dhe të begatë me anë të kësaj infrastrukture të përmirësuar.

- Cilat janë ndërhyrjet që ju planifikoni të ndërmerri brenda vitit të parë të mandatit tuaj për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, godina arsimore apo shëndetësore në bashkinë e Matit? (Kërkohet një listë sa më konkrete e objekteve që synohen të riparohen).

Adelina Farrici: Qasja ime administrative si kryetare e bashkisë së Matit do të jetë, ajo e konsultimit me ekspertët përkatës, vendosja e përparësive dhe zbatimi edhe simulimi i këtyre ndërhyrjeve në fusha të ndryshme, në shpërndarje të drejtë e sipas emergjencës në Mat. Kryefjala është gjithëpërfshirja dhe më i dobëti ndihmohet i pari. Në Mat ne do të japim dorën njëri-tjetrit e do të ngrihem bashkë për të ecur përpara në drejtimin e duhur.

- A keni një listë kriteresh për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të njësive administrative të bashkisë Mat dhe cilat janë ato?

Adelina Farrici: Lista nuk është një menu, por konsulenca e profesionistëve të burimeve njerëzore do të jetë e rëndësishme në këtë proces. Për të mbajtur standardet që dëshirojmë, duhen profesionistë dhe njerëz të përkushtuar, me vullnetin për të gjetur zgjidhje për përfaqësuesit e komunitetit.

- Cilat mekanizma do të ndërtoni në mënyrë që të siguroni pjesëmarrjen dhe konsultimin me qytetarët në procesin e vendimmarrjes së bashkisë? (Për hartimin e buxhetit, planit urbanistik, ndërhyrjet në infrastrukturë etj.?)

Adelina Farrici: Këto mekanizma janë tashmë pjesë e aplikueshmërisë nga ana e Bashkisë Burrel këto vite dhe eksperienca e fituar në përzgjedhjen e kapaciteteve dhe në komunikimin ballë për ballë, kombinuar edhe me median sociale, dixhitalizimin e komunikimit, lejojnë tashmë platforma për konsultim jo vetëm lokal por edhe të banorëve me origjinë matjane në diasporë.



- Çfarë masash do të ndërmerri për të siguruar transportin e nxënësve në shkollë nga fshatrat e thellë brenda vitit të parë të mandatit tuaj?

Adelina Farrici: Pyetja është ndër më të bukurat, domethënëset dhe me sfidaeset. Jo për nga vështirësia logjistike apo organizimi

kompleks, sesa për nevojën dhe domosdoshmërinë që brezat e rinj duhet të kenë të gjithë akses në arsimim dinjitoz.

Do të kemi këshillim me ekipin tim dhe do të përpilojmë zgjidhjen më të mirë që rrethanat të kthehen në favor të fëmijëve dhe edukimit të tyre në Mat.

Qasja ime administrative si kryetare e bashkisë së Matit do të jetë, ajo e konsultimit me ekspertët përkatës, vendosja e përparësive dhe zbatimi edhe simulimi i këtyre ndërhyrjeve në fusha të ndryshme, në shpërndarje të drejtë e sipas emergjencës në Mat. Kryefjala është gjithëpërfshirja dhe më i dobëti ndihmohet i pari. Në Mat ne do të japim dorën njëri-tjetrit e do të ngrihem bashkë për të ecur përpara në drejtimin e duhur.

- Çfarë masash do të ndërmerri për të garantuar pastrimin e Bashkisë Mat, veçanërisht brigjeve të lumit Mat të cilat janë aktualisht të mbushura me plehra?

Adelina Farrici: Masat edhe në këtë rast do të bashkërendohen me institucionet mjedisore dhe organizatat e profilizuara në ekspertizë në këtë fushë.

- Çfarë hapash do të ndërmerri për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet e paligjshme, mbrojtjen e liqeneve nga peshkimi i paligjshëm me dinamit dhe për zhvillimin e turizmit?

Adelina Farrici: Për çdo seksion, ekspertët dhe profesionistët që do të ftoj të konsultohemi do të hartojnë planin më realist dhe ne do të konkurrojmë në shkallë kombëtare që Qeveria të japë përparësi projekteve të domosdoshme, dinjitoze dhe që i shërbejnë zhvillimit të qëndrueshëm. Fletëpalosja ime elektorale i ka të specifikuar këto qasje.

- Çfarë do të bëni si kryebashkiake për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Matit?

Adelina Farrici: Atë që kam bërë edhe më parë, lobimin, mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e e përkujdesjen për trashëgiminë në breza.

Me shume informacione mbi veprimtarine elektorale të kandidatës **ADELINA FARRICI** mund të ndiqni faqen në FB:

<https://www.facebook.com/Adelina.Farrici.Politician>

Investimet publike do të adresohen në përmirësimin dhe ndërtimin e një infrastrukture rrugore bashkëkohore

- Cili mendoni se është problemi më i madh i Bashkisë së Matit dhe çfarë hapash do të ndërmerri për ta zgjidhur këtë problem gjatë mandatit tuaj?

Rizvan Neziri: Problemi më i madh në bashkinë Mat është ai i papunësisë, nivelit të ulët të jetesës dhe varfërisë. Kjo gjendje është rrjedhojë e një infrastrukture të munguar dhe në gjendje shumë të vështirë, të mungesës së furnizimit me ujë të pijshëm dhe ujit vaditës, të mungesës së prodhimit për treg, ku pjesa dërrmuese e fermerëve prodhojnë vetëm për vetkonsum, të papunësisë së lartë në qytetin e Burrelit etj.

Problemet e mësipërme nuk zgjidhen pa siguruar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të mbështetur në burimet dhe resurset ekonomike të zonës, duke nxitur degët prioritare të ekonomisë, mbi të cilat do të mbështetet ky zhvillim ekonomik, që sipas mendimit tim janë bujqësia, blegtoaria, ekoturizmi, agro-turizmi, industria agropërpunuese dhe artizanati.

Për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik në radhë të parë duhet të krijohen kushtet e domosdoshme për arritjen e një synimi të tillë që janë infrastruktura rrugore, furnizimi me ujë dhe krijimi i mundësive të prodhimit për treg.

Për këtë arsye investimet publike do të adresohen kryesisht në përmirësimin dhe ndërtimin e një infrastrukture rrugore bashkëkohore, në furnizimin me ujë të pijshëm dhe ujë vaditës.

Do të ulen taksat për biznesin brenda kufijve që mundëson ligji.

Do të ndihmohet me asistencë teknike profesionale biznesi dhe fermerët në drejtim të hartimit të programeve të zhvillimit, kreditimit, të tregjeve, të cilësisë së farërave, përmirësimit racor etj.

- Cilat janë ndërhyrjet që ju planifikoni të ndërmerri brenda vitit të parë të mandatit tuaj për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, godina arsimore apo shëndetësore në bashkinë e Matit? (Kërkohe një listë sa më konkrete e objekteve që synohen të riparohen).

Rizvan Neziri: Aty ku janë nevojat më jetike të qytetarëve siç janë lidhja me rrugët e fshatrave Batërr e Madhe, Rremull, Shoshaj, Stojan etj., përmirësimi i cilësisë së furnizimit me ujë të pijshëm në fshatrat Gërman, Lis e Baz si dhe disa ndërhyrje në furnizimin me ujë vaditës. Në shumicën e rasteve nuk kërkohen fonde të mëdha financiare, por një menaxhim më i mirë i burimeve ekzistuese dhe një vëmendje më e madhe. Këto që përmenda janë një pjesë e atyre rasteve ku kërkohet ndërhyrje urgjente, por përpara mbylljes së vitit aktual dhe miratimit të buxhetit të vitit të ardhshëm do të hartohet dhe miratohet një listë e prioriteteve ku do të adresohen investimet publike për vitin e ardhshëm.

- A keni një listë kriteresh për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të njëjve administrative të bashkisë Mat dhe cilat janë ato?

Rizvan Neziri: Profesionalizmi dhe aftësitë administrative, pastërtia e figurës, besueshmëria të qytetarët dhe përkushtimi ndaj detyrës.

- Cilat mekanizma do të ndërtoni në mënyrë që të siguronit pjesëmarrjen dhe konsultimin me qytetarët në procesin e vendimmarrjes së bashkisë? (Për hartimin e buxhetit, planit urbanistik, ndërhyrjet në infrastrukturë etj.)



Rizvan Neziri: Organizimi dhe përdorimi efektiv i mbledhjeve të hapura me komunitetin, anketimi dhe vrojtimi për problematika të caktuara, organizimi i mbledhjeve të hapura me grupet e interesit, organizimi i mbledhjeve dhe konsultimeve me përfaqësuesit direkt të qytetarëve në lagje apo fshatra (pleqtë, kryepleqtë).

- Çfarë masash do të ndërmerri për të siguruar transportin e nxënësve në shkollë nga fshatrat e thellë brenda vitit të parë të mandatit tuaj?

Rizvan Neziri: Problemi kryesor i nxënësve në fshatrat e thella është cilësia e mësimdhënies për shkak të mësimdhënies në klasa kolektive si dhe mungesa e infrastrukturës rrugore për mundësimin e transportit të tyre. Pa përmirësimin e infrastrukturës rrugore nuk mund të mundësohet transporti i nxënësve në shkollat më të afërta që mundësojnë një mësimdhënie në klasa normale. Megjithatë, në qytetin e Burrelit ndodhet një konvikti me kapacitete të mjaftueshme dhe me kushte normale që në konsultim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe qytetarët mund të përdoret për mundësimin e arsimimit të këtyre nxënësve në shkollat e qytetit të Burrelit.

- Çfarë masash do të ndërmerri për të garantuar pastrimin e Bashkisë Mat, veçanërisht brigjeve të lumit Mat, të cilat janë aktualisht të mbushura me plehra?

Rizvan Neziri: Mbetjet urbane janë një problem shqetësues për të gjithë Bashkinë Mat. Duke filluar nga rruga hyrëse në grykën e Shkopetit gjatë gjithë gjatësisë së rrugës, në të gjitha rrugët hyrëse të qytetit të Burrelit, nëpër luginën e lumit Mat, kudo shikon mbetje urbane të hedhura që ndotin ambientin dhe

dëmtojnë mjedisin. Për përmirësimin e situatës do të sigurohet mbledhja, tërheqja dhe trajtimi i mbetjeve urbane të paktën në të gjitha zonat ku infrastruktura e krijon këtë mundësi.

Do të hartohet projekti dhe mundësohet ndërtimi i një landfilli të depozitimit të mbetjeve urbane.

- Çfarë hapash do të ndërmerri për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet e paligjshme, mbrojtjen e liqeneve nga peshkimi i paligjshëm me dinamit dhe për zhvillimin e turizmit?

Rizvan Neziri: Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në konsultim me komunitetin do të gjenden rrugë të bashkëpunimit dhe administrimit të përbashkët qeverisje vendore – komunitet të pyjeve dhe burimeve ujore. Nga ana tjetër, nga strukturat ekzekutive të Bashkisë dhe administratorët do të realizohet zbatimi i ligjshmërisë për pyjet dhe burimet ujore.

Përsa i përket zhvillimit të turizmit theksojmë se Bashkia Mat me resurset e saj ka kushte shumë të përshtatshme për zhvillimin e ekoturizmit dhe agro-turizmit. Për zhvillimin e kësaj dege të ekonomisë nevojitet ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme, sidomos asaj rrugore, specializimi, trajnimi dhe edukimi i popullsisë në këtë drejtim, ruajtja e mjedisit. Ekoturizmi dhe agroturizmi janë një faktor i rëndësishëm i rritjes ekonomike dhe të nivelit të jetesës në zonat rurale.

- Çfarë do të bëni si kryebashkiak për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Matit?

Rizvan Neziri: Bashkia Mat përmbledh në vetvete disa krahina me specifikat e tyre etnokulturore si Ulza, Baz-Komsi, Lis dhe Prelli. Në këto kushte në radhë të parë do t'i kushtohet rëndësi mbledhjes dhe ruajtjes

Organizimi dhe përdorimi efektiv i mbledhjeve të hapura me komunitetin, anketimi dhe vrojtimi për problematika të caktuara, organizimi i mbledhjeve të hapura me grupet e interesit, organizimi i mbledhjeve dhe konsultimeve me përfaqësuesit direkt të qytetarëve në lagje apo fshatra (pleqtë, kryepleqtë).

së kësaj trashëgimie. Po ashtu, e gjithë treva e Bashkisë Mat është e pasur me objekte arkeologjike shumë pak të zbuluara dhe pothuajse aspak të shfrytëzuara, kështu që do të bëhen përpjekjet maksimale që t'i kushtohet një vëmendje edhe kësaj trashëgimie. Në këto kushte do të marrë një vëmendje më të madhe dhe një dimension të ri edhe qendra kulturore ekzistuese në Bashkinë Burrel si dhe muzeu historik, i cili do të vitalizohet. Do të synohet një partneritet publik-privat për t'i dhënë një shtytje të re zhvillimit të sportit.

Më shumë informacione mbi veprimtarinë elektorale të kandidatit **RIZVAN NEZIRI** mund të ndiqni faqen në FB:

<https://www.facebook.com/NezirRizvani/timeline>

INTERVISTË / **DURIM BALLA**,
kandidat i PD për bashkinë Bulqizë.

zgjedhjet

- Cili mendoni se është problemi më i madh i Bashkisë së Bulqizës dhe çfarë hapash do të ndërmerri për ta zgjidhur këtë problem gjatë mandatit tuaj?

Durim Balla: Problemi më i madh që neve sot konstatojmë me tërë qytetarët e Bashkisë së re Bulqizë është punësimi, varfëria e madhe si dhe kriza ekonomike që ka pllakosur, jo vetëm banorët e qytetit Bulqizë, por të tërë rrethit të Bulqizës. Për gjatë takimeve që kemi patur me banorë të lagjeve të qytetit, me banorë të fshatrave të Komunës Gjoricë, banorë të Komunës Ostren, banorë të Komunës Shupenzë, dëgjon nga ana e tyre mbi papunësinë, mbi varfërinë të vjen keq dhe ndjehesh shumë keq, kur dëgjon se shumë banorë nuk kanë mundësi të blejnë bukë, të blejnë ushqimet, të blejnë ilaçet, nuk kanë mundësi të paguajnë energjinë elektrike, nuk kanë mundësi të paguajnë tarifën për studentët, ku për të përballuar këtë gjendje të mjereshme kanë shitur gjënë e gjallë, bagëtitë, lopën dhe delen, vezët dhe së fundi edhe pulat. Mësuesit dhe buxhetorët në përgjithësi kanë marrë kredi e kështu me radhë, ndërsa pjesa tjetër e banorëve që nuk mund të paguajnë energjinë elektrike mbeten edhe sot në errësirë, ku shumë prej tyre kanë përfunduar në burg. Listat e borxheve janë shtuar në maksimum. Pra, kur qytetari përballet me urinë dhe krizën ekonomike, shoqëria nuk mundet të bëjë hapa progresive përpara, por është e dështuar duhet patjetër të ndërhyhet dhe të përmirësohet situata. Ndaj, duhen marrë hapa konkrete në fushën e punësimit, në gjetjen e burimeve financiare, në përthithjen e donatorëve të brendshëm dhe të jashtëm, me qëllim që të kemi investime dhe të zbutet varfëria ekstreme që ka pushtuar Bulqizën. Ulja e taksave vendore, shtimi i bizneseve, lehtësimi i barrës fiskale, gjetja e donatorëve të huaj, financimi në fushën e turizmit, sidomos atij malor, do të jetë prioriteti ynë në zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e situatës ekonomike të sotme në bashkinë e Bulqizës.

- Cilat janë ndërhyrjet që ju planifikoni të ndërmerri brenda vitit të parë të mandatit tuaj për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, godina arsimore apo shëndetësore në bashkinë e Bulqizës? (Kërkohe një listë sa më konkrete e objekteve që synohen të riparohen).

Durim Balla: Bashkia e re me qendër në Bulqizë kërkon përmirësim të ndjeshëm të infrastrukturës në disa fusha, si në rrugë, godina arsimore, qendra shëndetësore, si financime në fushën e sportit. Konkretisht, riparimet dhe ndërtimet e rrugëve të brendshme të lagjeve të qytetit, si në Qytet të Ri, asfaltimi i rrugës që lidh Qytetin e Ri me Dragunin dhe zyrat e Komunës Fushë-Bulqizë, rrugët dytësore në qytet të vjetër, asfaltimin e rrugës tek N/stacioni elektrik, asfaltimi i rrugës së Fushë-Bulqizë-Kodra Danit, asfaltimi i unazës Tre Cezmat-Zerqan, asfaltimi i rrugës Ura Serbinit-Zogje, ndërtime dhe shtrime me çakull të rrugës Zogje-Bllacë, hapja e rrugës Gjuras- në drejtim të Peshkopisë, shtrim me çakull të rrugës Mazhicë, shtrim me çakull rruga e varrezave Gjoricë etj. Investime në shkolla dhe kopshte, të cilat kërkojnë mirëmbajtje në tërë rreth. Investime në qendrat shëndetësore Mazhicë, Zogje, Bllace etj., të cilat mungojnë plotësisht.

- A keni një listë kriteresh për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të njësive administrative të bashkisë Bulqizë dhe cilat janë ato?

Durim Balla: Kriteret për emërimin dhe largimin e administratorëve janë të përcaktuar me ligjin organik të pushtetit vendor si dhe me ligjet tjera. Marrëdhëniet e punës rregullohen po me ligje të veçanta, si "Ligji për statusin e nëpunësit civil", "Kodi i punës" etj. Në administratën e Bashkisë do të punojnë tërë punonjësit e sotëm, të cilët janë specialist të fushës përkatëse si dhe të gjithë të tjerët që do të vijne përsëri do të jenë specialistë të fushës si dhe me përvojë eksperiencë. Në administratë patjetër do të punojnë punonjës që kanë dhe ruajnë etikën, kanë marrëdhënie të mira me publikun, kanë figurë të pastër morale dhe shoqërore. Nuk do të ketë paragjykime nga ana ime në lidhje me bindjet politike.

Punë dhe dinjitet për Bulqizën



- Cilat mekanizma do të ndërtoni në mënyrë që të siguronit pjesëmarrjen dhe konsultimin me qytetarët në procesin e vendimmarrjes së bashkisë? (Për hartimin e buxhetit, planit urbanistik, ndërhyrjet në infrastrukturë etj.)

Durim Balla: Zgjedhjet vendore ose organet e pushtetit vendor që dalin nga këto zgjedhje janë pushteti më i prekshëm për qytetarin, sepse pushteti vendor administrohet pronat vendore: tokat, pyjet e ulëta, ujin e pijshëm dhe ujin vaditës, rrugët, kullotat, ndihmën ekonomike, bursat e nxënësve dhe të studentëve, buxhetin, taksat, tarifën, sheshet publike, ambientet social kulturore, pastrim gjelbërimin, ndriçimin etj. Pushteti vendor është pushteti i drejtpërdrejtë i qytetarit, pushteti vendor trajton problemet e tërë qytetarëve që jetojnë në atë komunitet. Ndaj zgjedhjet kanë shumë rëndësi të madhe. Në përvojën time që kam si administrator ndër vite nuk më ka munguar komunikimi me qytetarët, takimi në çdo lagje dhe fshat, takimi me çdo banor, pasi dëgjimi i problemeve të shumta që ato kanë, duke parë situatën faktike në vend, të obligon në zgjidhjen e problemeve të mëvonshme që kërkon financime. Buxheti vendor miratohet nga këshilli Bashkiak, mbledhje e cila duhet të bëhet patjetër publike dhe para se të bëhet vendimmarrja patjetër duhet të organizohet një dëgjese publike për të marrë dhe parë në vend problematikën që kërkon zgjidhje. Po kështu, ndërtimi i planit urbanistik, ndërtimi i mjediseve publike, infrastruktura kërkon patjetër konsultim me banorët, të cilët do të përfitojnë të mirat publike nga ndërtimi apo ndryshimi i tyre. Ndaj konsultimi, bashkëbisedimi marrja e mendimit qytetarë janë vlerat kryesore të qeverisjes në vendet demokratike. Ky është ndryshimi në qeverisje. Ky është ndryshimi në qeverisje dhe në bërjen transparente të tërë shpenzimeve buxhetore të Bashkisë, ku këto veprime bëhen së bashku me administratën dhe sektorët që neve do të punojmë së bashku.

- Si do të përdoren të ardhurat nga renta minerare nga bashkia?

Durim Balla: Në komunikim me qytetarët e Bashkisë Bulqizë po marr çdo ditë shqetësimin e madh të gjendjes ekonomike, ku kemi një rrudhosje të ekonomisë së çdo qytetari, ndjehet varfëria, ndjehet në maksimum rënia ekonomike. Në komunikim me bizneset që operojnë si në Bashki edhe në Komuna po marr shqetësimin e madh se nuk ka fuqi blerëse, nuk kanë shumë xhiro, nuk ka shumë qarkullim të mallrave, ka shumë qytetarë që janë me lista borxhesh, kemi një varfëri shumë të lartë. Motoja jonë ne duhet të vijmë në pushtet dhe do të ulim taksat për bizneset e vogla, tarifën do të ulen ose do të hiqen fare sipas rastit, me qëllim që të japim

lehtësirat përkatëse për shtimin e bizneseve, arrijen e punësimeve, dhe të rriten konsumi duke shtuar të ardhurat për çdo familje. Por me taksat që do të mblidhen dhe do të grumbullohen nga bizneset, nga taksat e tokës, nga taksat për ujërat, në vizionin tim në përvojën time kjo taksë do të kthehet pro qytetarit në investime, pra për qëllimin që është vjelur, si dhe do të bëhet harmonizimi i tyre sipas emergjencës që do të lindë, pasi shtimi i buxhetit në ujë vaditës është shumë i domosdoshëm për ekonominë e çdo qytetari që ka pronë etj. Renta minerare që në kohën që qeveriste PD ishte 20% ajo sot është bërë 5%. Në do të kërkojmë me forcë që t'i rikthehet Bashkisë Bulqizë, pasi është vendi ku prodhohet mineral kromi, është vendi ku kjo taksë të investohet në radhë të parë në rritjen e mirëqenies së familjeve me jetimë të vrarë në minierë, për përmirësimin e jetës së tyre, si dhe në infrastrukturë dhe në investime. Por, përdorimi i të ardhurave dhe i rentës minerare do të bëhet me transparencë me të madhe duke bashkëbiseduar me qytetarët e Bashkisë Bulqizë, ku marrja e mendimit të qytetarit do të jetë në plan të parë.

- Çfarë masash do të ndërmerri për rigjenerimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe për zhvillimin e turizmit malor?

Durim Balla: Bashkia e re me qendër në Bulqizë ose rrethi i Bulqizës sot është vendi me pyje të rralla në Shqipëri. Shohim se sot makina shtetërore ka marrë një hap mjaft të rrezikshëm për shfrytëzimin e tyre duke marrë parcelat e bukura dhe të mëdha si në malet e Martaneshit, të Fushë-Bulqizës, të Zerqanit, të Gollobordës si dhe të Shupenzës. Ky shfrytëzim, i cili tashmë është bërë monopol, i shton obligimin çdo qytetari dhe votuesi të Bashkisë Bulqizë që ti thotë "Stop" shfrytëzimit barbar, sepse janë dashur shekuj për t'u rritur, janë kurorat më të bukura dhe më të rralla që natyra i ka falur Bulqizës. Ndaj mbrojtja e tyre është imperativ i kohës sot. Shfrytëzuesit nuk kanë lidhje me banorët dhe qytetarët e Bulqizës, me Zerqanin, me Martaneshin, me Gollobordën me Shupenzën. Makina shtet po dëmton në vend që ti mbrojtë, ndaj thirrja ime është e qartë për banorët e çdo zone në mbrojtje të pasurisë së tyre. Kjo bukuri e rrallë natyrore si Martanesh në Balle, në Bulqizë Liqenit e Duricit dhe Mali Dhoksit, në Zerqan Liqeni Zi dhe tërë masivi kurora Mali i Dhoksit - Liqeni Zi, në Gollobordë Mali Raducit, në Fushë-Bulqizë Mali Bardhë, bëjnë perlën më të bukur e të pasfrytëzuar jo vetëm të Bulqizës, por tërë Shqipërisë. Kemi plane për ndërtimin e turizmit malor si një ndër fushat kryesore për përfshirjen e Bashkisë së Bulqizës në hartën e turizmit kombëtar dhe ndërkombëtar, për mundësinë e hapjes së vendeve të reja të punës, për ta bërë Bulqizën

Duhen marrë hapa konkrete në fushën e punësimit, në gjetjen e burimeve financiare, në përthithjen e donatorëve të brendshëm dhe të jashtëm, me qëllim që të kemi investime dhe të zbutet varfëria ekstreme që ka pushtuar Bulqizën. Ulja e taksave vendore, shtimi i bizneseve, lehtësimi i barrës fiskale, gjetja e donatorëve të huaj, financimi në fushën e turizmit, sidomos atij malor, do të jetë prioriteti ynë në zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e situatës ekonomike të sotme në bashkinë e Bulqizës.

të njihet jo vetëm për prodhimin e mineralit të kromit, por edhe në fushën e turizmit. Kjo bukuri e rrallë natyrore do të shfrytëzohet jo vetëm për turizmin veror, por edhe për turizmin dimëror, le ti japim Klenjës gjallërinë që i ka munguar ndër vite. Do të ndërtojmë guidën e turizmit për Bashkinë Bulqizë, do të ftojme biznesmenët shqiptarë vendas si dhe do të llobojmë fuqishëm për të thithur donator të huaj, veçanërisht zvicerianë, për të bërë të mundur ndërtimin në fushën e turizmit.

- Çfarë hapash do ndërmerri për pjesëmarrjen minoriteteve të ndryshme etnike në vendimmarrjet e Bashkisë Bulqizë?

Durim Balla: Në rrethin e Bulqizës bën pjesë edhe zona e Gollobordës, ku ndeshemi me prezoncës e pakicave që i përkasin etnisë maqedonase, ku në këtë kuadër në këtë zonë aktualisht veprojnë dy shoqata maqedonase; "Most" dhe "Ilinden".

Natyrshtëm duke qenë në pakicë, minoriteti maqedonas në zonën e Gollobordës, nuk mundet për shkak të mungesës së numrave që të përfshihet në listat e këshilltarëve të bashkisë së re në zgjedhjet e 21 qershorit, për të patur zërin e saj në vendimmarrjet e këtij këshilli. Për këtë, unë në krye të bashkisë Bulqizë, pas zgjedhjeve, do ndërmarr hapat e duhur për përfshirjen e kësaj etnie në vendimmarrjet e këshillit bashkiak. Kështu krerët e shoqatave "Most" dhe "Ilinden", do jenë prezent në të gjitha mbledhjet e këshillit bashkiak, si dhe do përfshihen në grupet e konsulencës të Bashkisë së Re, për të dëgjuar zërin e tyre për problematikat me të cilat ata përballen, për tu dhënë kështu atyre rëndësinë dhe zgjidhjen e duhur që meritojnë.

- Cilat janë rrugët lidhëse me fshatrat që ju gjykoni se kanë nevojë më imediate për t'u ndërtuar apo rikonstruktuar? Brenda çfarë afatesh synoni t'i ndërtoni këto rrugë?

Durim Balla: Në programin tonë ndërtimi i rrugëve pas furnizimit me ujë të pijshëm ka një prioritet të madh. Ndërtimi rrugës Ura Serbinit-Zogje, ndërtimi rrugës Fushë-Bulqizë - Kodër Danit, ndërtimi rrugës Qytet Ri - Dragu - Fushë-Bulqizë, ndërtimi rrugës Tre Cezmat - Zerqan, ndërtimi rrugës Cerenec i Epër, ndërtimi rrugës Ostren i Vogël, ndërtimi rrugës Lubalesh etj., do të jenë prioriteti i punës time brenda një afati dyvjeçarë, ku për ndërtimin e tyre do të kërkojmë fonde si nga buxheti shtetit, ashtu edhe nga donatorë të huaj.

Më shumë informacione mbi veprimtarinë elektorale të kandidatit **DURIM BALLA** mund të ndiqni faqen në FB:

<https://www.facebook.com/pages/Durim-Balla-per-Bulqizen/94337319040222?fref=ts>

Më shumë shërbim dhe punësim

- Cili mendoni se është problemi më i madh i Bashkisë së Bulqizës dhe çfarë hapash do të ndërmerri për ta zgjidhur këtë problem gjatë mandatit tuaj?

Melaim Damzi: Kur themi Bashkia Bulqizë duhet të mësohemi se nuk po flasim vetëm për qytetin, por për të gjithë rrethin e Bulqizës. Sigurisht që zonat Urbane kudo kanë probleme ndaj dhe do të kenë një trajtim të veçantë.

Qyteti i Bulqizës është një qytet industrial, i cili është krijuar për shkak të pasurisë natyrore të kromit dhe të mirat dhe të këqijat i kanë ardhur prej këtij minerali. Them të mirat dhe të këqijat, pasi prej tij ka mbijetuar, por në jo pak raste ka qenë edhe burim aksidentesh. Konjuktura e çmimit të mineralit pas viteve '90 ka qenë e lëvizshme sipas kërkesave të tregut. Fatmirësisht, ka vite që ajo ka pasur një çmim të leverdishëm për investitorët. Por lidhja e fateve të një qyteti vetëm me këtë aktivitet përbën një risk, ndaj në strategjinë time për zhvillimin e Bashkisë Bulqizë do të kem hapjen e alternativave të tjera të punësimit sidomos të grave dhe vajzave, pasi puna në mineral e tyre është e lodhshme, por edhe shumë e papërshtatshme.

Kjo do të arrihet nëpërmjet hapjes së industrive fason, nxitjes së vetëpunësimit në aktivitetet fitimprurëse.

Tashmë përfshirja në një të vetme edhe e zonave rurale do të japë mundësi të zhvillimit të turizmit rural dhe agroturizmit, çka do të ketë impakt edhe në zonën urbane pasi do tu japë mundësi punësimi qoftë direkt por edhe indirekt në këtë sektor.

Do të nxisim shkollimin e të rinjve në shkolla profesionale dhe të mësimi të gjuhëve të huaja që të jenë sa më atraktiv në shërbim të këtyre sfidave dhe të punësimit të tyre.

- Cilat janë ndërhyrjet që ju planifikoni të ndërmerri brenda vitit të parë të mandatit tuaj për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, godina arsimore apo shëndetësore në bashkinë e Bulqizës? (Kërkohe një listë sa më konkrete e objekteve që synohen të riparohen).

Melaim Damzi: Tashmë Bashkia e Re e Bulqizës me 7 njësi administrative ka nevojë për shumë investime dhe ndërhyrje në infrastrukturë qoftë kjo rrugore, arsimore apo shëndetësore. Sigurisht, që sipas buxhetit në dispozicion, do të përcaktohen edhe prioritetet. Kështu, në infrastrukturën rrugore prioritet do të jetë rruga Qafë e Buallit Krastë, Ura Serbinit - Zogje dhe Ostren - Rruga e Librazhdit si nyje që nuk lidh një fshat, por një njësi administrative apo një zonë.

Në infrastrukturën arsimore do të investohet në të gjitha shkollat në përmirësimin kryesisht me mjete logjistike dhe me pajisje të nevojshme, për të bërë sa më efikas procesin mësimor. Do të shohim mundësinë që për të rritur cilësinë e mësimdhënies më mirë, do të ishte investim për mjete transporti që për fshatrat me 3-4 nxënës për klasë dhe me klasa kolektive nga 1-5 të bëhet transporti i tyre në shkollat më të afërta që dhe cilësia e mësimdhënies është më e lartë.

Qendrat Shëndetësore, megjithëse në disa zona janë ndërtuar të reja, ka nevojë të ndërtohen edhe konsultore në fshatra, por imediate është plotësimi me pajisje të nevojshme për shërbim të urgjencës si dhe për zonat e thella blerja e mjeteve specifike të transportit për raste emergjence.

- A keni një listë kriteresh për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të njësisë administrative të bashkisë Bulqizë dhe cilat janë ato?

Melaim Damzi: Ligji për Organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal në ndryshimet e tij në përshtatje me Reformën Territoriale ka përcaktuar që Komunat aktuale të quhen njësi administrative dhe Kryetarët e këtyre njësisë tashmë nuk do të quhen më Kryetar Komunash dhe nuk do zgjidhen me votime popullore, por do të quhen administrator të



njësisë administrative dhe do të emërohen nga Kryetari i Bashkisë.

Sigurisht që është një proces delikat dhe do kërkojë një trajtim të veçantë.

Për emërimin e Administratorëve të njësisë administrative do të kem parasysh së pari aftësitë menaxheriale dhe organizative të individëve, integritetin moral dhe shoqëror por sigurisht pa lënë pas dore edhe kontributin politik të dhënë në këto zgjedhje.

Kur flasim për shkarkimin e tyre, në fazën e parë nuk kemi të bëjmë me një të tillë pasi Kryetarët aktual të njësisë vendore u mbaron mandati në bazë të Ligjit, ndërsa për Administratorët e rinj, sigurisht që do të mbikëqyren dhe vlerësohen në punën e tyre. Padyshim, që ata janë grupi më i afërt i punës së Kryetarit të Bashkisë dhe çdo punë e mirë e tyre është vlerësim indirekt për mua dhe e kundërta.

Në rastet kur nga komuniteti i njësisë administrative, por edhe nga mbikëqyrja e punës së administratorëve nga strukturat e Bashkisë ka vërejtje, mangësi apo shkelje të ligjit, sigurisht që shkarkimi është hapi i duhur që do të bëjë.

- Cilat mekanizma do të ndërtoni në mënyrë që të siguroni pjesëmarrjen dhe konsultimin me qytetarët në procesin e vendimmarrjes së bashkisë? (Për hartimin e buxhetit, planit urbanistik, ndërhyrjet në infrastrukturë etj.)

Melaim Damzi: Në fakt është bërë diçka rutinë shprehja politike në fushatë që pas fitores do të vijmë tek Ju do të bisedojmë me Ju, do ti vendosim gjërat së bashku etj., por në fakt gjithmonë ka ndodhur ndryshe, që edhe në rastet kur është bërë ndonjë dëgjese publike me komunitetin nuk janë marrë parasysh ata çka ata kanë kërkuar.

Nga natyra ime, që shumë herë për vendime që kanë lidhje me disa persona konsultohem me miq dhe shok.

Në këtë rast miq dhe shokë do të jenë komuniteti. Sigurisht jo për çdo gjë pasi dhe teknikisht është e pamundur, por për gjëra madhore që kanë ndikim direkt në jetën e komunitetit dhe që janë afat gjata do të ishte më se e domosdoshme marrja e mendimit të tyre.

Listimi i disa prej tyre në pyetjen Tuaj është adekuat. Pavarësisht se Kryetari i Bashkisë ka marrë qoftë gjatë fushatës, por edhe më pas nga strukturat e tij problemet, shqetësime, nevojat e komunitet, radha e plotësimi të tyre do të përcaktohet nëpërmjet dëgjësive publike. Sigurisht, që shtrirja e Bashkisë tashmë në nivel rrethi e vështirëson këtë proces, por do të gjejmë forma të tilla bashkëbisedimi për të thithur sa më shumë mendimin e tyre. Pse

Qyteti i Bulqizës është një qytet industrial, i cili është krijuar për shkak të pasurisë natyrore të kromit dhe të mirat dhe të këqijat i kanë ardhur prej këtij minerali. Them të mirat dhe të këqijat, pasi prej tij ka mbijetuar, por në jo pak raste ka qenë edhe burim aksidentesh. Konjuktura e çmimit të mineralit pas viteve '90 ka qenë e lëvizshme sipas kërkesave të tregut. Fatmirësisht, ka vite që ajo ka pasur një çmim të leverdishëm për investitorët.

jo edhe përdorimi i rrjeteve sociale, sidomos për të rinjtë, do të ishte një formë dhe dëgjese shumë e mirë.

Nuk do të kishte kuptim, por as vlerë hartimi i planit urbanistik të Bashkisë pa përfshirjen e të gjithë aktorëve të interesuar dhe komunitetit, pasi është një dokument afat gjatë që le gjurmë për shumë vite në Komunitet. Të gjithë shohim pasojat e ndërtimeve të pa studiara dhe të pa konsultuara.

- Si do të përdoren të ardhurat nga renta minerare nga bashkia?

Melaim Damzi: Një ndër pasuritë më të mëdha natyrore që ka sot Bashkia Bulqizë është kromi. Është ky mineral që ndër vite ka identifikuar dhe bërë të njohur edhe vetë Bulqizën. Dikur thuhej se ai çante bllokadën. Tashmë jetojmë në një sistem tjetër dhe sigurisht që miniera dhe galeritë e nxjerrjes së kromit janë privatizuar ose dhënë me koncesion.

Janë dhjetëra subjekte që kanë privatizuar galeri të ndryshme në Bulqizë, por është dhe Kompania Balfin Group që ka me koncesion pusin e vjetër dhe po punon për hapjen e pusit të ri në thellësi të mëdha.

Këto subjekte kanë vërtet impakt në zhvillimin e qytetit nëpërmjet pagesës së taksave sipas Ligjit dhe të rentës minerare që është një taks e veçantë.

Do të isha me parimin që taksat aty ku paguhet aty edhe të përdoret për të bërë të mundur përmirësimin e kushteve të punës dhe jetesës së komunitetit. Me këtë kuptoj që kjo taksë të përdoret specifikisht në qytetin e Bulqizës, në infrastrukturë të qytetit, në përmirësimin e jetës kulturore dhe arsimore të qytetit. Padyshim, që puna është bërë në qytet por ka akoma për të bërë. Kromi i jep vlerë dhe emër qytetit, por krijon edhe probleme në varësi të konjunkturave. Me të ardhurat nga renta do të mundohemi që të investojmë edhe në projekte punësimi të tjera që nuk kanë lidhje me kromin kryesisht për gratë dhe vajzat pasi puna e tyre në këtë sektor është e rëndë.

- Çfarë masash do të ndërmerri për rigjenerimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe për zhvillimin e turizmit malor?

Melaim Damzi: Pak më lart përmendëm që kromi është një pasuri madhore për Bulqizën, por do të vlerësoja që pas tij pasuri tjetër me vlerë janë pyjet. Bashkia e Bulqizës, besoj se duhet të zëre vendin e parë në Shqipëri për sipërfaqe pyjore në territorin e saj. Duke filluar që nga kurora mbi qytet me malin e Dhoksit dhe duke përfunduar deri në kufi me Dibërën, Klosin dhe Librazhdin thuajse është

e gjitha pyje.

Nuk i përmenda këta thjeshtë për të thënë se sa gjelbërim kemi, por për të vënë në dukje se Bulqiza mund të jetë një atraksion turistik vërtet shumë i madh.

Por si është situata tashmë në këtë sektor. Ata janë dëmtuar si kudo tjetër në Shqipëri. Masive në Tërnovë, Prat, Ballenjë etj., janë prerë dhe dëmtuar. Por, detyra jonë nuk është që të rrimë dhe të bëjmë sehir se çfarë është bërë, por të mendojmë dhe hartojmë plane dhe strategji se ç'duhet të bëjmë. Një pjesë e tyre kanë qenë pyje komunal dhe padyshim që janë asete të Bashkisë së Re, por besoj që edhe ata parqe që kanë statusin parqe kombëtare do të kalojnë në administrim të bashkisë.

Detyra e parë është që të ruajmë këto pyje që nuk janë dëmtuar, duke mos lejuar vazhdimin e prerjeve të tyre, por edhe duke qenë të kujdesshim në dhënien e lejeve të shfrytëzimit të tyre. Edhe në rastet kur nuk do të jetë në kompetencën tonë dhënia e lejeve të shfrytëzimit ne do të ngremë zërin tonë fort për rastet e tentativave abuzive dhe në dëm të pyjeve.

Dhe së dyti do të jetë hartimi dhe implementimi i projekteve për kthimin e pyjeve të dëmtuara në identitetin e tyre të mëparshëm. Sigurisht, që është një proces i vështirë dhe i gjatë, por duhet të fillojmë ne që ta vazhdojmë të tjerët dhe t'ua lëmë brezave, pasi pylli do qindra vite të marrë formë.

- Çfarë hapash do ndërmerri për pjesëmarrjen minoriteteve të etnive të ndryshme në vendimmarrjet e Bashkisë Bulqizë?

Melaim Damzi: Bulqiza nuk ka minoritete dhe as etnitete të ndryshme në këtë qytet. Sigurisht që është një qytet industrial dhe në krijimin e tij ka pasur ndikim edhe të ardhurit kryesisht nga rrethi i Dibërës, por këta kanë mbi 50 vjet që jetojnë së bashku me komunitetin autokton ose bulqizak, siç quhet dhe nuk ka më dallime mes tyre. Edhe komuniteti rom dhe egjiptian në Bulqizë është në një numër të kufizuar dhe për pasojë kanë qenë dhe do të jenë të integruar.

- Cilat janë rrugët lidhëse me fshatrat që ju gjykoni se kanë nevojë më imediate për t'u ndërtuar apo rikonstruktuar? Brenda çfarë afatesh synoni t'i ndërtoni këto rrugë?

Melaim Damzi: Bashkia e Re tashmë do të ketë në juridiksion të saj edhe zonat rurale që deri dje menaxhoheshin nga Komunitat. Fatmirësisht, që në një pjesë prej tyre është investuar, falë kjo edhe punës së Kryetarëve aktual të Komunave. P.sh. Gjorjica ka të shtruar rrugën lidhëse me aksin nacional, po kështu edhe Zerqani.

Por akoma ka shumë nevojë për ndërhyrje në infrastrukturë. Bulqiza i ka fshatrat dhe njësitë të shpërndara në të gjithë territorin dhe thuajse të gjitha në terren malor dhe të vështirë. Do të përmendja këto: Njësinë administrative Krastë, e cila në pothuajse të gjithë rrugën nga rruga nacionale deri në qytet me një gjatësi 17 km që kërkon ndërhyrje urgjente gjë që do ta bëjmë që në vitin e parë në bashkëpunim me qeverinë qendrore. Janë fshatrat e zonës së Zogjes në Komunën Shupenzë që kanë një nevojë emergjente për 5 km rrugë dhe do të jetë prioritet i vitit të parë të punës. Nuk do të lëmë jashtë vëmendjes zonën e Gollobordës me Njësitë administrative Ostren dhe Trebisht. Do të vëmë si prioritet të vitit të parë rrugën nga rruga nacionale Ura Cerencit Librazhd deri në qendër të Ostrenit të Madh.

Sigurisht, që brenda mandatit të parë do të planifikojmë që një pjesë e tyre të ristrukturohen dhe të shtrohen me asfalt.

Më shumë informacione mbi veprimtarinë elektorale të kandidatit **MELAIM DAMZI** mund të ndiqni faqen në FB:
<https://www.facebook.com/pages/Melaim-DAMZI-per-Bulqizen/363937993799448?fref=ts>

INTERVISTË / **BASIR ÇUPA**,
kandidat i PD për bashkinë Klos.

zgjedhjet

Cili mendoni se është problemi më i madh i Bashkisë së Klosit dhe çfarë hapash do të ndërmerri për ta zgjidhur këtë problem gjatë mandatit tuaj?

Basir Çupa: Mendoj se problemi më i madh i Bashkisë Klos është Plani i Përgjithshëm Rregullues dhe zbatimi i tij konkret, i shtrirë në kohë sipas mundësive reale, hap pas hapi deri në realizimin e plotë të tij. Me këtë është e lidhur pazgjidhshmërisht ngritja me ritme sa më të shpejta e infrastrukturës së plotë rrugore që do të lidhë me qendrën e bashkisë me çdo fshat e çdo lagje fshati.

Për ta zgjidhur këtë problem do të ndërmarim me përgjegjësi të plotë hapat e nevojshëm me afate kohore të studiuar mirë, si më poshtë:

Së pari, për të realizuar këtë objektiv që mbart shumë përgjegjësi e kërkon angazhim e përkushtim serioz, duhet një administratë efiçente, e aftë dhe po aq e përgjegjshme. Për këtë administrata si në qendër edhe në njësitë e veçanta do të formatohet e tillë që të jetë e sigurtë dhe e vendosur, jo vetëm për të hartuar saktë planin rregullues, por mbi të gjitha për të marrë këto përgjegjësi. Pra do të vendosen kudo njerëz të aftë e plotësisht të përgjegjshëm.

Së dyti, Plani i Përgjithshëm Rregullues do të hartohet duke thithur mendimin intelektual, i bazuar tërësisht në nevojat komunitare dhe do të jetë i studiuar shumë mirë e me përgjegjësi të plotë.

Së treti, përshkallëzimi i hapave deri në realizimin e plotë, do të bëhet në përputhje me mundësitë reale.

Së katërti, nuk mund të ketë as plan rregullues as realizim të tij, pa krijuar infrastrukturën e nevojshme që do të mundësojë realizimin e tij. Për këtë, problem më i ngutshëm është lidhja sa më optimale e çdo njësie, e çdo fshati dhe lagjeje me qendrën e bashkisë. Vetë pozicioni ku është qendra, është i artë, pra është vërtet qendër në raport me distancat në gjithë territorin ku shtrihet kjo bashki. Kjo na vë para detyrimit për të ndërtuar rrugë të reja të nevojshme për të mundësuar këtë lidhje të artë. E kam treguar edhe më parë se ura e re që do të ndërtohet në vendin ku është pasarella te ish Pazarit i Urës, do të mundësojë që njësi Xibërr të harmonizohet në distancë me njësitë e tjera në lidhje me qendrën e bashkisë, duke ndërtuar rrugën e re automobilistike që do të përshkojë itinerarin nga kjo urë, nëpër lagjen Ballosh të Fshatit drejt Qafë-Shkallësë e Xibërrit. Po ashtu lidhja e fshatrave të Gurrës me Urën e Shulbatrës, e fshatrave të zonës së Kurdarisë me Suçin etj., pra me një projekt të menduar mirë të lidhet harmonikisht çdo skaj i territorit të kësaj bashkie me qendrën e saj.

Gjithsesi, në kuadrin e Njësise se Re të krijuar, Bashkia Klos ka një numër të madh problemesh, por më kryesoret veçojmë: hartimi i Planit Urban (Planit të Përgjithshëm Rregullues), infrastruktura rrugore që lidh Qendrën me Komunën Xibërr, infrastruktura rrugore e lagjeve të secilit fshat, infrastruktura e sistemit të vaditjes, sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm, mungesa e tregut industrial dhe të mishit, terrenet sportive në shkollë, mungesa e sitemit të IT në Bashki, krijimi i zyrës me një ndalesë pranë hollit të Bashkisë, mungesa e pallatit të kulturës në qytet, mungesa e lulishtes në qytet, mungesa e një baxhoje, mungesa e depozitave frigoriferike, mungesa e zyrës multifunkionale për moshën e tretë, mungesa e një qendre pritjeje për trajtimin e problemeve me natyrë sociale, mungesa e terreneve sportive në çdo shkollë, krijimi i qendrës Rinore.

- Cilat janë ndërhyrjet që ju planifikoni të ndërmerri brenda vitit të parë të mandatit tuaj për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, godina arsimore apo shëndetësore në bashkinë e Klosit?

Basir Çupa: Në dy vitet e para: do të shtroj me çakull mali të gjitha rrugët e fshatrave

Brenda dy viteve do të shtrohen të gjitha rrugët lidhëse me çakull dhe asfalt



Punë dhe
Dinjitet

Basir Çupa
për Klosin

Partia
Demokratike

të Bashkisë së Re, do të asfaltoj rrugën nga Qafë Shkalleja në qendër të Komunës Xibërr, do të bëj ndërhyrje në të gjithë kanalet vaditëse ekzistuese, do të riparoj çdo ujësjellës ekzistues, do të planifikoj dhe mbaroj projekte në fushën e infrastrukturës rrugore, kanaleve vaditëse, ujësjellësve, do të mbaroj Planin e Përgjithshëm Rregullues të Bashkisë Klos.

Sapo të marr mandatin, do të bashkëpunoj me qeverinë në qendër për të planifikuar me përgjegjshmëri e më tej realizuar në kohë përqendrimin dhe rajonalizimin e sistemit arsimor, për të mundësuar funksionimin sa më efektiv të procesit mësimor-edukativ në gjithë territorin e bashkisë.

- A keni një listë kriteresh për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të njësive administrative të bashkisë Klos dhe cilat janë ato?

Basir Çupa: Përvoja ime si drejtues në disa dikasterë të fushave të ndryshme do të më lehtësojë në punën time për të patur një strukturë shumë efiçente në shërbim të komunitetit tim. Unë nuk kam bërë dhe nuk do të bëj ndonjë listë për emërim dhe shkarkim punonjësish. Emërimi dhe shkarkimi i punonjësve do të jetë i bazuar vetëm në ligjin "Për Statusin e Njësive Civil" dhe "Kodit të Punës". Struktura do të shikohet dhe rivlerësohet vetëm në bazë të dy kriterëve të mësipërme dhe tërësisht në funksion të synimit të pastër për të patur një administratë sa më të përgjegjshme dhe sa më efiçente në shërbim të komunitetit.

- Cilat mekanizma do të ndërtoni në mënyrë që të siguronit pjesëmarrjen dhe konsultimin me qytetarët në procesin e vendimmarrjes së bashkisë? (Për hartimin e buxhetit, planit urbanistik, ndërhyrjet në infrastrukturë etj.)

Basir Çupa: Së pari: Në strukturën e re do të emëroj një zyrë me emërtesën Zyra e

Programim Zhvillimit me dy ose tre punonjës. Kjo zyrë do të hartojë prioritetet e Njësise së Re duke mirëpërcaktuar funksionimin e saj si zyrë në konsultimin paraprak të çdo prioriteti me lagjen ku është projekti dhe çdo aktor të interesave në zonë, si mësues, mjekë, ekonomistë, fermerë etj. Pra, zyra do të ketë një model rregullorëje për hartimin dhe përfundimin e çdo projekti.

Së dyti: përta përta për hartimin të buxhetit, ai do të përgatitet në formën e draftit rreth 4 muaj më parë nga njësi përgjegjëse për hartimin e saj ku marrin pjesë të gjithë përgjegjësit e zyrave dhe më pas do të zhvilloj tre takime publike, një të shkolla me mësuesit, një takim të Qendra Shëndetësore Klos me mjekët, një takim në bashki me të gjithë specialistët dhe përfaqësuesit e profesioneve të tjera të biznesit të madh e të vogël.

- Çfarë masash do të ndërmerri për të siguruar transportin e nxënësve në shkollë nga fshatrat e Klosit brenda vitit të parë të mandatit tuaj?

Basir Çupa: Në vitin e parë për të gjithë nxënësit që vazhdojnë arsimin e mesëm të ulët e të lartë (pra dy nivelet e arsimit të mesëm, kl VI-XII) e që kanë distancën mbi 5 km nga banesa do të miratoj një fond të veçantë për secilin prej tyre. (Mundësia e dytë do të jetë përjashtimi nga taksat vendore i mjeteve të transportit të nxënësve, për tu ardhur në ndihmë nxënësve).

- Çfarë masash do të ndërmerri për të nxitur zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë në zonën e Bashkisë Klos?

Basir Çupa: Në strukturën e Bashkisë do të jenë Zyrat e Bujqësisë dhe Veterinarisë, të cilat

Identifikimi i pronave, është domosdoshmëri për të realizuar miradministrimin e të gjitha resurseve në funksion të zhvillimit ekonomik në bashki dhe rritjes së mirëqenies së komunitetit në tërësi. Vetëm kështu do të merren përgjegjësitë e duhura për administrimin e pasurive në trevën tonë.

do të japin konsulentë për fushat e ndryshme në të gjithë fshatrat e bashkisë së re. Do të realizoj mirëmbajtje të gjithë kanaleve vaditëse ekzistuese. Do të bëj pagesën e energjisë elektrike të pompave vaditëse për të gjitha pompat ekzistuese ose mirëmbajtjen e tyre. Do të hartoj projektet e zbatimit për kanale të reja vaditëse.

Më kryesorja, do të bashkëpunoj me qeverinë dhe veçanërisht me hipotekën, në mënyrë që çdo fermer të marrë certifikatën e pronësisë për tokën që i takon. Mendoj se identifikimi i pronave, është domosdoshmëri për të realizuar miradministrimin e të gjitha resurseve në funksion të zhvillimit ekonomik në bashki dhe rritjes së mirëqenies së komunitetit në tërësi. Vetëm kështu do të merren përgjegjësitë e duhura për administrimin e pasurive në trevën tonë.

Më shumë informacione mbi veprimtarinë elektorale të kandidatit **BASIR ÇUPA** mund të ndiqni faqen në FB:

<https://www.facebook.com/pages/Basir-Cupa-Per-Klosin/1580992522186727?ref=ts>

- Cili mendoni se është problemi më i madh i Bashkisë së Klosit dhe çfarë hapash do të ndërmerri për ta zgjidhur këtë problem gjatë mandatit tuaj?

Valbona Kola: Problemet që ka aktualisht bashkia Klos janë të shumta dhe për nga rëndësia dhe specifikat që ato kanë nuk mund të bëj një renditje të saktë të tyre.

Në gjykimin tim, nga informacionet që disponoj, nga verifikimet e bëra nga unë dhe stafi im në të gjithë territorin e bashkisë dhe nga takimet e bashkëbisedimi me qytetarët, mendoj se problemet më të mëdha që rëndojnë në jetën e qytetareve janë papunësia, infrastruktura rrugore, furnizimi me ujë të pijshëm dhe rrjeti vaditës, të cilat të gjithë sëbashku kanë çuar në një problem të vetëm të madh që është niveli i ulët ekonomik-social i banorëve të bashkisë.

Si banore e hershme, si intelektualë dhe si punonjëse që kam shërbyer për 25 vjet në këtë komunitet, së bashku me stafin tim, në të cilin bëjnë pjesë shumë intelektualë me njohuri të posaçme në drejtime të ndryshme profesionale, në bashkëpunim me grupet e interesit dhe qytetarët e mi, kam hartuar programin qeverisës të bashkisë me afate e detyra konkrete, të cilat do ti zbatoj me korrektësi, me të vetmin mision që është përmirësimi i jetës ekonomik-socialë të banorëve të bashkisë Klos.

Programi jonë konsiston në nxitjen e punësimit duke u përqendruar kryesisht në stimulimin e biznesit privat të të gjitha kategorive (biznesi i vogël, mesëm dhe i madh), luftën ndaj konkurrencës së paligjshme, thithjen e investimeve nga qeveria qendrore dhe donatorë seriozë të brendshëm dhe të huaj, investime të cilat do të përdoren për infrastrukturë rrugore, godina arsimore dhe shëndetësore, ujësjellës dhe rrjete vaditëse e kulluese, subvencionimin e fermerëve, të cilëve do t'u sigurohet dhe tregu për prodhimet e tyre bujqësore e blegtorale, administrimin korrekt të burimeve minerare ku të ardhurat e përfutuara do të vihen në shërbim të qytetarëve dhe investimet në fushën e turizmit që natyra ia ka dhuruar kësaj bashkie.

- Cilat janë ndërhyrjet që ju planifikoni të ndërmerri brenda vitit të parë të mandatit tuaj për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, godina arsimore apo shëndetësore në bashkinë e Klosit? (Kërkohej një listë sa më konkrete e objekteve që synohen të riparohen).

Valbona Kola: E kam parë nga afër infrastrukturën rrugore, godinat arsimore dhe shëndetësore në të gjithë territorin e bashkisë dhe me keqardhje them se situata është në një gjendje të mjerueshme. Duke u nisur nga kjo gjendje, deklaroj me përgjegjësi se brenda vitit të parë të mandatit është e domosdoshme dhe do të ndërhyj patjetër në rikonstruksionin e rrugës Qafë Shkozë - Guri i Bardhë, rikonstruksionin e rrugës nga vendi i quajtur QafëUk - Shkallë - Xibër Murrize - Xibër Hane dhe Ketë, ndërtimin me çakull të rrugës nga Ura e Degës për në fshatrat Misher dhe Ftua, përfundimin e rrugës Klos - Cerujë, e cila është lënë pa përfunduar dhe jashtë çdo standardi, rikonstruksionin e rrugës së fshatit Gurrë e Vogël dhe përfundimin deri në fund të fshatit të rrugës Suç-Kurdari.

Do të ndërhyj për rikonstruksionin e godinave arsimore të fshatrave dhe godinave shëndetësore, të kanalit vaditës Kete - Xibërhane, Guri i bardhe - Xibërmurrize, Guri bardhë - Shkallë, ku synohet që krahas ujit vaditës të menaxhohet dhe uji i pijshëm.

Gjithashtu, rikonstruksionin e rrugës Xibërmurrize-Xibërhane-Ketë, qendrës shëndetësore i Xibër Qendër, shkollës fillore Shkallë, financimi i përfundimit të ujësjellësit të Kurdarisë që shërben për pesë fshatra, rikonstruksionin e rrugës qendër Kurdari - Patin rreth 5 km, asfaltimi i rrugës qendër Kurdari - Skënderaj.

Rikonstruksionin e kanalit vaditës Luse-Rezervuar-Skënderaj, rrugës Kurqelaj-Kap-Sheshi i Suçit-Shkorse-Halilaj, përfundimi i asfaltimit të rrugës deri në qendër të Gurrës së Vogël 2.3 km, rikonstruksionin e kanalit vaditës nga liqeni i Koçit deri Barruku, ujësjellësit Brënda fshatit Rripe, ndërtimi i urës së betonit në vend të asaj pasarelë në fshatin Dom, rikonstruksionin e rrugës nga Ura e Domit deri tek Pjetri, asfaltimi i rrugës Rripe-Gurrë e vogël 3.5 km, rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit në Gurrën e Madhe, rikonstruksionin e rrugës në lagjen Celam dhe lagjes Can në Gurrë të vogël.

Qytetari do të jetë i pari në të gjitha proceset e vendimmarrjes së bashkisë



Rikonstruksionin e kanalit vaditës Celam - Canaj, rrugës Dom - Zallë-Allaj, ujësjellësit të Shulbatrës, rrugës Gurrë e Vogël-Misher Unjate, ambulancës në Dom, kanalit vaditës Xhabez-Fullqet, rrugës Unazë Kroj i Madh-Dardhë-Kroj i Madh në Fullqet, rrugës Çollak -Shira ne Fullqet, rrethimi i shkollës 9-vjeçare Cerujë, asfaltimi i rrugës Pleshë - Cerujë, reabilitimi i kanalit vaditës Pleshë.

Rikonstruksionin e kanalit vaditës Cerujë, rrugëve brenda lagjeve në Pleshë, rrugës Cerujë - Kukatin-Pleshë, rrugës Cerujë -Patin -Bersh deri në rrugën nacionale, ujësjellësit Bershi, shkollës fillore në Bershi, kanalit vaditës në fshatin Fshat, shkollës së Planit-Bardhë, rrugëve brënda fshatit Dars, rrugës Klos-Bel-Unjate, rrugëve brenda fshatit Patin, rrugëve të fshatit Klos-Katund si dhe i rrugës që lidh rrugën nacionale me rrugën Ballosh në Fshat.

Nuk do të ndodhë më kurrë në asnjë rast ajo çfarë ka ndodhur deri më sot që për një objekt të investohet disa herë pasi projektet do të zbatohen me korrektësi dhe investimet e kryera do të bëhen brenda çdo standardi.

-A keni një listë kriteresh për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të njësive administrative të bashkisë Klos dhe cilat janë ato?

Valbona Kola: Lista e kriterëve për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të njësive administrative të bashkisë Klos do të jetë shumë e qartë dhe e prerë:

Kriteri kryesor në bindjen time është vlerësimi i qytetarëve për shërbimin që do ju ofrojnë administratorët. Mua qytetari me ka dhënë besimin për t'i shërbyer atij dhe nuk mund të ndodhë ndryshe që administratorët e njësive administrative të bëjnë të kundërtën. Qytetarët e bashkisë Klos kanë shumë probleme të të gjitha natyrave, kështu që ato kërkojnë dhe e meritojnë që ne si drejtues vendor të jemi në shërbim të tyre 24 orë për të vetmin mision, përmirësimin e jetës ekonomik-socialë të tyre.

Nuk ekziston në bindjen time në idetë dhe vizionin tim në asnjë çast kriteri politik për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të njësive administrative. Unë jam kryetare bashkie për të gjithë komunitetin dhe do tu shërbej atyre pa dallim bindjesh politike, fetare apo krahinore.

Emërimi dhe shkarkimi i administratorëve të njësive vendore si dhe i punonjësve të administratës do të bëhet mbi kriteret e meritokracisë, profesionalizmit, përkushtimit dhe ndershmërisë.

Më sipër me pyetet se cili mendoj që është problemi më i madh i bashkisë Klos dhe unë paraqita disa prej tyre. Që të jem e sinqertë e them me bindje se problemi më i madh si pasojë e të cilit kanë ardhur të gjitha problemet e tjera të shumta është mosfunksionimi deri më tani mbi baza ligjore, profesionale, me përkushtim dhe ndershmëri i administratës ak-

tuale të bashkisë Klos dhe tre Komunitat që i janë bashkëngjitur sipas ndarjes së re administrative. Ashtu siç jam e ndërgjegjshme që në këtë administratë ka një kontigjent punonjësish të ndershëm, profesionistë, korrekt e të përkushtuar në ushtrimin e detyrave funksionale, me keqardhje them se drejtuesit aktualë dhe lidhjet klienteliste të tyre në administratë nuk kanë patur asnjë lidhje me zgjidhjen e problemeve të qytetareve, përkundrazi kanë vjedhur taksat dhe djersën e tyre, kanë shpërdoruar ndihmën ekonomike, e cila u takonte familjeve në nevojë duke e ndarë atë sipas lidhjeve nepotike dhe militantiste.

Pasojat e mosfunksionimit të drejtuesve aktualë dhe administratës së tyre e ndjen, e shikon dhe e prek çdo qytetar i bashkisë Klos.

-Cilat mekanizma do të ndërtoni në mënyrë që të siguroni pjesëmarrjen dhe konsultimin me qytetarët në procesin e vendimmarrjes së bashkisë? (Për hartimin e buxhetit, planit urbanistik, ndërhyrjet në infrastrukturë etj.)

Valbona Kola: E kam përmendur dhe më sipër se në qendër të vëmendjes time dhe të administratës që do të drejtoj do të jetë qytetari, zëri i tij, shqetësimi dhe problemi i tij e si rrjedhojë qytetari do të jetë i pari në të gjitha proceset e vendimmarrjes së bashkisë.

Këshilli bashkiak do të jetë një partner i fuqishëm gjatë ushtrimit të detyrës time si kryetare bashkie. Këshillit do ti sugjeroj dhe kërkoj bashkëpunimin e tij që në procesin e vendimmarrjeve në përgjithësi dhe për hartimin e buxhetit, planit urbanistik dhe ndërhyrjet në infrastrukturë, mbledhjet të jenë të hapura, ku qytetarët të marrin pjesë e të japin mendimet e tyre.

Do të kërkohej mendimi dhe bashkëpunimi me OJQ dhe grupet e interesit, nga ekspertë të fushave të ndryshme sipas tematikave të procesit vendimmarrës. Çdo vendim do të jetë transparent për qytetarët dhe e thënë ndryshe çdo vendimmarrje do të jetë investim për përmirësimin e jetës së qytetareve duke u përqendruar në vendet dhe drejtimet që ato e kanë më emergjente dhe më të domosdoshme.

- Ç'farë masash do të ndërmerri për të siguruar transportin e nxënësve në shkollë nga fshatrat e Klosit brenda vitit të parë të mandatit tuaj?

Valbona Kola: E kam përmendur dhe më sipër se në qendër të vëmendjes time dhe të administratës që do të drejtoj do të jetë qytetari, zëri i tij, shqetësimi dhe problemi i tij e si rrjedhojë qytetari do të jetë i pari në të gjitha proceset e vendimmarrjes së bashkisë.

Këshilli bashkiak do të jetë një partner i fuqishëm gjatë ushtrimit të detyrës time si kryetare bashkie. Këshillit do ti sugjeroj dhe kërkoj bashkëpunimin e tij që në procesin e vendimmarrjeve në përgjithësi dhe për harti-

min e buxhetit, planit urbanistik dhe ndërhyrjet në infrastrukturë, mbledhjet të jenë të hapura, ku qytetarët të marrin pjesë e të japin mendimet e tyre. Do të kërkohej mendimi dhe bashkëpunimi me OJQ dhe grupet e interesit, nga ekspertë të fushave të ndryshme sipas tematikave të procesit vendimmarrës. Çdo vendim do të jetë transparent për qytetarët dhe e thënë ndryshe çdo vendimmarrje do të jetë investim për përmirësimin e jetës së qytetareve duke u përqendruar në vendet dhe drejtimet që ato e kanë më emergjente dhe më të domosdoshme.

- Ç'farë masash do të ndërmerri për të nxitur zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë në zonën e Bashkisë Klos?

Valbona Kola: Për fatin e mirë të qytetareve të bashkisë Klos natyra dhe zoti i kanë dhuruar kësaj treve një larmishmëri resurcesh ku përfshihen burimet minerare, bujqësore, blegtorale, hidrike, pyjore dhe turistike. Një pjesë e mirë e sipërfaqes së kësaj bashkie është zonë fushore që përbëhet nga lugina e Matit dhe me kullota që variojnë nga 240 metra ne 600 metra mbi nivelin e detit.

Degët kryesore të ekonomisë së bashkisë janë bujqësia, ku klima e favorshme lejon kultivimin e të gjitha bimëve e drufrutoreve, blegtoria dhe shërbimet duke mos lenë pas dhe burimet minerare të kromit të përqendruara në masivin lindor krom mbajtës.

Për të nxitur zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë në bashkinë Klos objektivat e mia si kryetare bashkie do të përqendrohen në këto drejtime kryesore: Menaxhimin e tokave bujqësore, stimulimin e fermerëve duke u krijuar lehtësira nëpërmjet subvencionimit për zhvillimin e aktivitetit të tyre, ndërtimin e rrjeteve vaditëse e kulluese në të gjitha fshatrat e bashkisë, pasi mungesa e tyre deri më tani ka qenë një ndër shkaqet kryesore që ka ndikuar seriozisht në rritjen e kostos dhe uljen e prodhimit të fermerëve, garantimin e tregut të produkteve bujqësore dhe frutikulture duke hyrë garant për kompensimin e prodhimit të mbetur stok për arsye të mungesës së tregut, nxitjen dhe sensibilizimin e fermerëve për sigurimin e aktivitetit të tyre prodhues, me qëllim përfitimin e dëmshpërblimit të prodhimit të dëmtuar nga shkaqet natyrore apo arsye të tjera që nuk varen nga ato, sigurimin e tregut për prodhimet blegtorale duke ndërtuar minifabrika për përpunimin e të gjitha këtyre prodhimeve, përmirësimin e infrastrukturës rrugore që u shërben fermerëve për zhvillimin e aktivitetit të tyre bujqësor e blegtoral.

Më shumë informacione mbi veprimtarinë elektorale të kandidatës **VALBONA KOLA** mund të ndiqni faqen në FB:

<https://www.facebook.com/pages/Valbona-Kola-per-Bashkine-KLOS/1597674073841334?fref=ts>

Ta kthejmë Dibërën në drejtimin e duhur

- Cili mendoni se është problem më i madh i Bashkisë Dibër dhe çfarë hapash do të ndërmerri për ta zgjidhur këtë problem brenda vitit të parë të mandatit tuaj.

Shukri Xhelili: Rrethi i Dibrës ka problematika nga më të ndryshmet dhe që janë krejtësisht evidente nga qytetarët. Pothuajse kudo dhe në çdo gjë dallohet qartë dora e shkatërrimit ose më mirë të themi dora e arnimit të gjërave sa për të kaluar radhën.

Në zallamahirë e problemeve të krijuara nga keqadministrimi i deritanishëm i qeverisjes lokale nga të zgjedhurit e PD do të veçoja katër probleme kryesore që për mendimin tim kërkojnë ndërhyrje urgjente brenda vitit të parë të mandatit 4 vjeçar:

a) Furnizimi me ujë 24 orë në 24 i qytetit të Peshkopisë dhe në veçanti i të gjitha qendrave shëndetësore dhe shkollave të qytetit.

b) Ndërhyrje të menjëhershme në të 42 shkollat 9 vjeçare dhe të mesme të Bashkisë së Dibrës në drejtim të rehabilitimit të të gjitha tualeteve me ujë të rrjedhshëm dhe krijimin e kushteve të duhura higjieno-sanitare nëpër shkolla dhe kopshte pasi ne nuk mund të lejojmë shkollimin e brezit të ri në kushte të tilla mizerabël si një përgjegjësi direkte e pushtetit vendor.

c) Ndërhyrje të menjëhershme për të ndaluar katastrofën mjedisore dhe urbane në të gjithë njësitet e reja administrative pasi ky është shkatërrimi më i madh që po i bëhet Dibrës.

d) Marrja nën mbrojtje të menjëhershme nga bashkia e re e të gjitha aseteve kulturore dhe historike që ka Dibra për të ndaluar shkatërrimin e kujtesës historike dhe kulturore.

Ndërsa lidhur me problematikën e gjerë që ka Dibra unë kam një program të detajuar të zhvillimit rajonal dhe të integruar të bashkisë së re, të cilin po e diskutojmë me qytetarët gjatë këtyre ditëve të fushatës elektorale dhe që pas 21 qershorit do ta vëmë në zbatim me mbështetjen e qeverisë qendrore dhe personalisht të Kryeministrit Rama.

- Cilat janë ndërhyrjet që ju planifikoni të ndërmerri brenda vitit të parë të mandatit tuaj për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, godina arsimore apo shëndetësore në bashkinë e Dibrës. (Listë sa më konkrete e objekteve që synohen të riparohen)

Shukri Xhelili: Brenda vitit të parë të mandatit do të transformojmë tërësisht pamjen e qytetit të Peshkopisë nëpërmjet projektit tashmë të filluar të Qeverisë Rama për "Rilindjen Urbanë të Qyteteve" për të cilën kam marrë garanci personale nga ana e kryeministrit dhe ky projekt transformimi është gati dhe në ditët në vazhdim do ta prezantojmë përpara opinionit qytetar dibranë. Duke ndryshuar imazhin e qytetit në drejtim të traditës dhe modernës ne mendojmë në radhë të parë të kthejmë çdo dibranë atë copë të humbur nga qyteti i dikurshëm që për fatin tonë të keq u shkatërrua në këto 12 vjet nga Kryetari i Bashkisë në ikje z. Krosi.

Pjesë e kësaj rilindje urbane në godinën e saj historike do të jetë edhe gjimnazi i famshëm i Peshkopisë si pjesë e krenarisë së dhjetëra gjeneratave që sot drejtojnë me sukses në të gjitha fushat e jetës shoqërore brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ndërkohe që brenda vitit të parë të mandatit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit do të pajisim të gjitha shkollat e mesme dhe 9-vjeçare me bazën e nevojshme didaktike dhe mësimore dhe nuk do të ketë me shkolla çatitë e të cilave çfarë pikon jashtë e fusin brenda.

- A keni një listë kriteresh për emërimin apo shkarkimin e administratorëve të njësive administrative të bashkisë Dibër dhe cilat janë ato?

Shukri Xhelili: Lidhur me qëndrimin tim ndaj administratës vendore dhe kryesisht, të administratorëve sociale, jam i hapur dhe bindshëm në zbatim të ligjit 152/2013 "Për statusin e nëpunësit civil" në zbatim të të cilit, administratat e organeve të qeverisjes vendore, janë nëpunës të shërbimit civil.

Ajo që me duhet të them qartazi në lidhje me këtë është se projekti im lidhur me nëpunësit e administratës është: "Një administratë profesionale në shërbim të qytetarit". Të gjithë admin-



istratorët sociale, do të jenë persona të cilët të kenë formimin e duhur ligjor dhe profesional, në shërbim të publikut, të gatshëm të ofrojnë zgjidhje të problemeve të cilat kanë të bëjnë me të përditshmen dhe perspektivën e qytetarëve dibranë, nga qyteti deri në zonat më të thella.

- Cilat mekanizma do të ndërtoni në mënyrë që të siguroni pjesëmarrjen edhe konsultimin me qytetarët në procesin e vendimmarrjes së Bashkisë? (hartimi i buxhetit, plani urbanistik, ndërhyrjet në infrastrukture, etj.)

Shukri Xhelili: Një qeverisje lokale është e suksesshme nëse funksionon si duhet dy shtylla të rëndësishme: komunitet- bashki- qeveri qendrore dhe komunikim - transparencë - bashkëpunim, duke i dhënë rolin e duhur komunitetit të qytetarëve, shoqërisë civile, këshillit bashkiak, administratës së bashkisë por edhe bashkëpunimit me qeverinë qendrore. Këtë do ta bëjmë duke miratuar si fillim një strategji rajonale të zhvillimit të bashkisë së Dibrës për tu dhënë mundësinë qytetarëve të dinë se ku do të shpenzohet çdo qindarkë e taksave të tyre.

- Cilat janë hapat që do të ndiqni në mbrojtjen dhe rigjallërimin e pyjeve dhe turizmit malor në Bashkinë e Dibrës gjatë mandatit tuaj?

Shukri Xhelili: Deri në korrik 2017 të gjitha pyjet do kalojnë në pronësi të bashkisë Dibër. Ne bazë të ligjit për pyjet duhet që për çdo 2500 ha pyje do të punësohet një specialist pyjesh. Dibra ka rreth 80 mijë ha pyje, ka parkun e Lurës, parkun natyror Korab-Koritnik, shumë monumente të natyrës si dhe një faunë të pasur. Të gjitha këto përbëjnë një atraksion shumë të madh për turizmin dhe agro-turizmin.

Bashkia do të bëjë të mundur që fermerët të marrin në ruajtje dhe përdorim një pjesë të mirë të pyjeve të ulëta dhe ti shfrytëzojnë për të gjeneruar të ardhura. Gjithashtu, bashkia e re plotëson kushtet për të aplikuar me projekte për të përfutur nga fondet IPA dhe Cros-Border për përmirësimin e pyjeve dhe rritjen e turizmit.

Bashkia do të bashkëpunojë me shoqatat dhe organizatat e zonës dhe të huaja për promovimin e turizmit dhe vlerave të shumta që ofron zona. Gjithashtu, do të nxisë krijimin e shtigjeve, zonave për ecjen me biçikleta e për të gjithë apasionuarit e sporteve malore.

- Cili është plani juaj për menaxhimin e burimeve termale dhe zhvillimin e turizmit shëndetësor?

Shukri Xhelili: Lidhur me menaxhimin e burimeve termale gjëja e parë që do të bëjmë do të jetë transparenca në administrimin e të ardhurave që ky aset natyror i ka dhënë Bashkisë së Dibrës, pasi sot ky kompleks nga një pasuri që do të duhej të ishte motor i zhvillimit ekonomik dhe i turizmit shëndetësor rajonal, por dhe më gjerë, është kthyer në gropën e zezë të korrupsionit bashkiak, ku kanë zhytur duart i madh e i vogël për 12 vite me radhë.

Plani jonë është krejt i thjeshtë: Kthimi i këtij kompleksi në një qendër kurative dhe e turizmit shëndetësor elitare duke i ri-investuar 100 % të ardhurat e krijuara nga ky kompleks

Bashkia do të shoh edhe mundësinë e krijimit të një fondi garancie për fermerët që kërkojnë të investojnë në bujqësi që tu bëjë të mundur atyre të aplikojnë dhe përfitojnë kredi nga bankat për mbjellje të reja apo investime në blegtori.

në transformimin rrënjësor të kushteve të duhura akomoduese për të ofruar një shërbim sa më cilësor klientëve jabanxhinj, por edhe banorëve të Dibrës, duke e harmonizuar këtë edhe me turizmin familjar, tashmë të krijuar nga banoret e zonës, të cilëve do tu krijohen të gjitha lehtësitat e duhura për shërbimet në këmbim të nxitjes së punësimit sezonal në bashkëpunim me zyrën e punës pranë bashkisë.

Pika e fundit, por më kryesorja, do të jetë adoptimi i një modeli menaxhimi i një standardi që sot ofrohet për komplekse të tilla simotra në rajon dhe në Europë.

- Cilat janë hapat që do të ndërmerri për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë në Bashkinë e Dibrës.

Shukri Xhelili: Pavarësisht emërimit juridik Bashki, Bashkia e Re Dibër më shumë se 70 % të banorëve, mbi 90 % të territorit të saj shtrihet në zonë rurale. Bashkia e Re do të ketë në përbërje të saj 14 Njësi Administrative ish Komuna tërësisht në zona rurale. Nisur nga sa më sipër, zhvillimi i zonave rurale, kryesisht nëpërmjet zhvillimit të bujqësisë, do të jetë ndër prioritetet bazë të punës sime si Kryetar Bashkie. Si do ta realizojmë këtë:

Se pari, pavarësisht ekzistencës së strukturave shtetërore si Drejtoritë e Bujqësisë apo Bordet e Kullimit ne do të krijojmë një Departament të Zhvillimit Bujqësor dhe Rurale në Bashki, i cili do të ketë si detyrë konstatimin e problemeve dhe nevojave dhe hartimin mbi këtë bazë të strategjisë dhe projekteve të zhvillimit bujqësor dhe rural.

Strategjia e Bashkisë së Re do të jetë të mbështesë fermerët në iniciativat e tyre për shtimin e sipërfaqeve të pemëve frutore, të shtimit të numrit të krerëve në blegtori, kryesisht të bagëtive të imta.

Pozita gjeografike dhe klimatike e Bashkisë Dibër është e tillë që sektorët që kanë nevojë për mbështetje dhe zhvillim të mëtejshëm janë Pemëtaria dhe Blegtoria. Aktualisht, me gjithë iniciativat individuale të fermerëve për mbjelljen e pemëve frutore si dhe shtimin e numrit të krerëve të të imtave në blegtori, jemi larg kapaciteteve natyrore në këto 2 sektor.

Dibra para viteve 90 prodhonte rreth 40 mijë ton fruta ndërsa sot jemi në limitet e 5 mijë deri në 6 mijë ton.

Por a do të ishte e plotë mbështetja vetëm duke mbështetur sektorin e prodhimit? Padyshim që jo. Nëse nuk kemi një strategji të qartë

për mbështetjen e tregtimit dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale nuk kemi bërë asgjë por vetëm kemi futur më keq në vështirësi fermerët.

Para disa vitesh, Bashkia Peshkopi ndërtoi një treg për produktet bujqësore dhe blegtorale, treg i cili nuk funksionoi asnjë ditë për shkak të pozicionit të gabuar të ndërtimit, por edhe mungesës të pushtetit lokal. Ai tashmë është kthyer në objekt në shërbim të shërbimit zjarrfikës.

Bashkia Dibër që në vitin e parë të punës do të hartoj një projekt për ndërtimin e një tregu të ri për tregtimin e frutave dhe produkteve blegtorale, i cili të mos shërbejë thjesht si një vend për shitjen me pakicë, por edhe si një vend reklamimi dhe promovimi të prodhimeve dibrane, gjë që do të çoj edhe në lidhje të kontratave për shitje me shumicë dhe të garantuar të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

Bashkia e re do të jetë një partnere e fuqishme në thithjen e projekteve dhe donatorëve të huaj që duan të investojnë direkt apo të mbështesin bujqësinë në Dibër. Aktualisht Dibra është pjesë e një projekti Danez-Gjerman për zhvillimin e zonave të pazhvilluara, SARED me një fond prej 6.5 milion euro për 6 qarqe dhe ne do të mbështesim fermerët në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Bujqësisë që fermerët dibranë të thithin sa më shumë nga këto fonde, të cilat kanë si destinacion zhvillimin e pemëtarisë dhe të blegtorisë.

Sektori i blegtorisë kërkon mbështetje kryesive në përpunimin dhe tregtimin e produkteve të tij. Edhe në këtë sektor do të krijojmë mundësinë e sjelljes së projekteve nga donator vendas dhe të huaj për krijimin e linjave të përpunimit të qumështit dhe të mishit.

Indirekt këto projekte do të çojnë në shtimin e kapaciteteve prodhuese nga vetë fermerët, pasi sipas modeleve të BE do jenë këta investitor që do të investojnë në përpunim dhe tregtim të produkteve që do të mbështesin fermerët në rritjen e prodhimit të tyre.

Një problem madhor që ka sot bujqësia në Dibër është ujitja e tokave. Të gjithë janë dëshmitar të shkatërrimit të sistemit të ujitjes pas viteve 90. Fusha të tëra tashmë janë pa ujë megjithëse Dibra shquhet për burime ujore. Në këtë fushë në bashkëpunim edhe me qeverinë por edhe me donator të huaj do të bëjmë të mundur që të shtojmë kapacitetet ujitëse, duke rindërtuar veprat e dëmtuara por edhe ndërtimin e veprave të reja si rezervuare, kanale vaditëse e të tjera.

Bashkia do të shoh edhe mundësinë e krijimit të një fondi garancie për fermerët që kërkojnë të investojnë në bujqësi që tu bëjë të mundur atyre të aplikojnë dhe përfitojnë kredi nga bankat për mbjellje të reja apo investime në blegtori.

Më shumë informacione mbi veprimtarinë elektorale të kandidatit **SHUKRI XHELILI** mund të ndiqni faqen në FB:



<https://www.facebook.com/ShukriXhelili.official/timeline>

Bashkërisht ta dërgojmë Dibërën atje ku e meriton

- Cili mendoni se është problemi më i madh i Bashkisë së Dibrës dhe çfarë hapash do të ndërmerri për ta zgjidhur këtë problem gjatë mandatit tuaj?

Ilir Krosi: Një ndër problemet madhore në nivel Qarku, përfshirë dhe Bashkinë Peshkopi, është niveli i ulët ekonomik dhe papunësia e madhe. Nëse do tju referohemi statistikave, vetëm 40 % e popullsisë është në nivelin mesatar, ndërsa pjesa tjetër janë nën këtë nivel.

Mungesa e investimeve të Qeverisë në Dibër, (duke përfshirë këtu edhe 6 komunat e majta), e ka përkeqësuar situatën e përgjithshme ekonomike dhe tkurrjen e vendeve të punës.

Problemi më i madh i Bashkisë Dibër do të jetë administrimi i territorit nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe duke qenë se Dibra ka një shtrirje mjaft të madhe gjeografike dhe territor mjaft të vështirë.

Objektivi themelor, parësor, me të cilin do fillojmë që ditën e parë të punës në Bashkinë e Dibrës do të jetë shfrytëzimi i resurseve ekonomike të kësaj zone. Dihet që sektori kryesor i punësimit (vetëpunësimit) është bujqësia e për këtë arsye është parë si me shumë rëndësi mbështetja e bujqësisë për të rritur prodhimin e zonës duke siguruar tregun e produktit, zhvillimin dhe promovimin e turizmit dhe vlerave të tij nëpërmjet krijimit të infrastrukturës bashkëkohore për në Parkun e Lurës, në Liqenet e Kacnisë, Bjeshkëve të Hynoskës e Gramës, Vargmalin e Deshatit dhe Korabit. Një objektivi tjetër i mandatit të ardhshëm është stimulimi ekonomik i bizneseve nëpërmjet uljes së taksave në minimum për aq sa na lejon ligji.

Furnizimi me Ujë të pijshëm të çdo qytetari të Dibrës në qytet e në fshat është prioriteti ynë i radhës. Kjo duke filluar nga fshatrat e Maqellarës e deri në Reç.

Por një projekt tjetër me rëndësi është edhe zgjidhja dhe mbështetja e problemit të vaditjes nga Maqellara në Reç.

- Cilat janë ndërhyrjet që ju planifikoni të ndërmerri brenda vitit të parë të mandatit tuaj për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, godina arsimore apo shëndetësore në bashkinë e Dibrës?

Ilir Krosi: Projektet infrastrukturore zënë një vend të rëndësishëm në platformën elektorale të Bashkisë Dibër. Ata janë parë si projekte vitalizuese të ekonomisë bujqësore por edhe të ekonomisë në përgjithësi. Nëse do ti referohemi infrastrukturës rrugore janë parë si me shumë rëndësi projekte si: Sistemim asfaltim i rrugës Kastriot-Arras-Lurë, Muhurr-Selishtë, Bllice-Zalldardhë-Zall Reç, Llixha-Bellovë-Cerjan-Zagrad-Rabdisht, Grezhdan-Herebel, Erebarë-Dovolani, Vakuf-Kandër-Kishavec, Limjan-Volezë-Vranjt, Cërren-Tejsë, Katund i Ri-Lishan i Poshtëm, Kthimi i Bulevardit "Elez Isufi" në pedonale bashkëkohore, ndërtimi i Unazës së qytetit Peshkopisë. Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza për qytetin e Peshkopisë dhe komunave përreth, si dhe ndërtimi i Kanalizimeve të ujërave të zeza për fshatra të të gjitha komunave (ku ato mungojnë, në fakt ekzistojnë në shumë pak fshatra).

Investimet në infrastrukturën arsimore janë një pikë e rëndësishme e punës në mandatin e ardhshëm. Ndërtimi i një shkollë 9 vjeçare në lagjen Llixha, rikonstruksioni i shkollave ekzistuese të amortizuara, rikonstruksioni i çerdheve të qytetit, ndërtimi i Gjimnazit të ri tek ish-ndërmarrja e mirëmbajtjes së rrugëve, rikonstruksioni i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, janë investime që do të realizohen në mandatin e ardhshëm.

Për të garantuar financimin e këtyre prioritetëve, së pari do të hartojmë me shpejtësi projekt preventiv për secilin prioritet, (në rastet kur këto projekte mungojnë), duke angazhuar që në muajin e parë të mandatit specialistët më të mirë, inxhinierë, arkitektë dhe studio projektimi të licencuara që kanë aftësi dhe kualifikim për hartimin e projekteve cilësore për rrugë, ujësjellësa, kanalizime të ujërave të zeza, kanale dhe vepra vaditëse, projekte mjedisore, turistike etj.



Punë dhe Dinjitet

Ilir Krosi
për Dibërën

Partia Demokratike

Në qendër të platformës tonë për mandatin e ardhshëm do të jetë qytetari dhe vetëm qytetari. Ne kemi punuar edhe në mandatin e kaluar nën moton "të parët qytetarët".

Modeli i përdorur në mandatet e kaluara në bashkinë Peshkopi, ai i konsultimit me Komisionet Këshillimore Qytetare, do të vazhdojë të përsoset.

- A keni një listë kriteresh për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të njëjësve administrativë të bashkisë Dibër dhe cilat janë ato?

Ilir Krosi: Kjo përbën një çështje me shumë rëndësi për të arritur në një konsolidim të organizimit të njësisë vendore të re, në këtë mënyrë kriteret për zgjedhjen e administratorit do të bazohen mbi eksperiencën që ka, aftësitë teknike, menaxhuese, mbi të gjitha integriteti dhe vlerat që transmeton tek komuniteti të cilit do i ofrohet shërbimi.

- Cilat mekanizma do të ndërtoni në mënyrë që të siguronit pjesëmarrjen dhe konsultimin me qytetarët në procesin e vendimmarrjes së bashkisë? (Për hartimin e buxhetit, planit urbanistik, ndërhyrjet në infrastrukturë etj.)

Ilir Krosi: Në qendër të platformës tonë për mandatin e ardhshëm do të jetë qytetari dhe vetëm qytetari. Ne kemi punuar edhe në mandatin e kaluar nën moton "të parët qytetarët". Modeli i përdorur në mandatet e kaluara në bashkinë Peshkopi, ai i konsultimit me Komisionet Këshillimore Qytetare, do të vazhdojë të përsoset. Çdo projekt dhe punë e Bashkisë së re do të synojë të përmirësojë jetën e dibranëve. Aktualisht bashkia ka finalizuar me sukses planin urbanistik të qytetit, gjë e cila është realizuar në konsultim me grupet e interesit dhe qytetarët. Kjo praktikë e mirë do të vazhdojë të përdoret edhe në hartimin e mastër planit urbanistik për bashkinë e re të Dibrës dhe për hartimin e planeve të detajuara vendore për ish komunat etj.

Një element mjaft i rëndësishëm i përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, do të jetë buxhetimi me pjesëmarrje, konsultimi me bizneset dhe me qytetarët i paketës fiskale.

Elementi më i rëndësishëm është zbatimi i njërit nga prioritetet që kemi paraqitur në platformën elektorale, të cilën po jua bëjmë të ditur "Qeverisja elektronike" hapja e zyrës me një ndalesë, e cila përbën çelësin e ofrimit të shërbimeve optimale nga bashkia e madhe, meqenëse ky "instrument" lidh direkt qytetarin me zyrtarin e bashkisë, i cili ka për detyrë të ofrojë një shërbim të caktuar sipas rastit. Ky sistem elektronik do të ketë ndërlikime me të gjitha njësitë vendore që i përfshihen bashkisë sonë, dhe ne tashmë kemi kapacitete të trajnuara pikërisht për këtë zyrë shërbimi.

Rol të veçantë do të kenë mbledhjet e hapura të këshillit bashkiak, komisionet qytetare të cilat do të konsolidohen më tej në bashkinë e madhe, aktiviteti periodik i "Dyerve të hapura në bashki" është gjithashtu modeli ynë.

- Cilat janë hapat që do të ndiqni në mbrojtjen dhe rigjallërimin e pyjeve dhe turizmit malor në Bashkinë e Dibrës gjatë mandatit tuaj?

Ilir Krosi: Turizmi dhe rigjallërimi i pyjeve janë parë si një pikë me mjaft rëndësi për të investuar në mandatin e ardhshëm. Projektet konkrete të këtij sektori janë: Parku rekreativ i Luginës së Shërimit, promovimi i vlerave kulturore dhe historike të Dibrës, mbështetja e eventeve lokale dhe rajonale që i japin zhvillim rritjes së turistëve në zonë, evidentimi i vlerave dhe aseteve të trashëgimisë kulturore dibrane, mbështetja e artizanatit si stimulues i turizmit dhe ekonomisë.

Projekte që kanë në fokus rigjallërimin e pyjeve janë: Pyllëzime me llojin Akacies në Komunat Kastriot, Tomin, Maqellarë, Melan dhe Slllovë, dhënia në përdorim për komunitetin lidhur me pyjet, Hartimi i planit për menaxhimin e qëndrueshëm dhe ndalimin e prerjeve pa kriter të pyjeve dhe kullotave.

- Cili është plani juaj për mirëmenaxhimin e burimeve tërimalë dhe zhvillimin e turizmit shëndetësor?

Ilir Krosi: Përmirësimi i kushteve të shërbimit brenda mjedisve të Llixhave, ndërtimi

i parkut rekreativ të Llixhave në funksion të shëndetit të pushuesve, përmirësimi i sistemit të menaxhimit të tyre, ngritja e një qendre ditore për të gjitha grupmoshat.

- Cilat janë hapat që do të ndërmerri për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë në Bashkinë e Dibrës?

Ilir Krosi: Theksi kryesor i investimeve në fushën e bujqësisë është vendosur tek frutikultura. Synohet që të ndërhyhet nëpërmjet disa projekteve që kanë synim vetëpunësimit e banorëve, por edhe rritjen e të ardhurave familjare dhe ekonomive bujqësore.

Krijimi i zinxhirit të tregut të produkteve të frutikulturës:

1. Nxitja e fermerëve për mbjellje të reja (mbështetja me 4 fidanishte për fermerët) të paktën me 20% të rritjes së sipërfaqes së mbjellë me pemtore;

2. Fuqizimi i sistemit vaditës (Bashkëpunimi me Ministrinë e Bujqësisë, donatorë vendas dhe të huaj dhe me programe të ndryshme në fushën e Bujqësisë);

3. Vënia nën ujë e fushës së Maqellarës;

4. Vënia nën ujë e fushës së Kastriotit;

5. Agropërpunimi (Nxitja dhe mbështetja e bizneseve lidhur me grumbullimin, magazinimin dhe përpunimin në dy qendra kryesore: Kastriot dhe Melan);

4. Krijimi i markës rajonale (Made in Dibra);

5. Hartim plani, studimi për rritjen e prodhimit në frutikulturën tradicionale në përputhje me nevojat e tregut.

6. Mbështetja për blegtorinë: mbështetja për fermerët blegtoral lidhur me rritjen e numrit të bagëtive dhe tufave të reja (të krijohen të paktën 15 tufa të reja); nxitja dhe mbështetja e sektorit të përpunimit të produkteve blegtorale; nxitja për ndërtimin e baxhove Melan, Maqellarë, Kastriot dhe Kala e Dodës (kurse menaxhimi financiar/subvencion për fermat e vogla); marketingu i produkteve blegtorale (Made in Dibra).

Me shume informacione mbi veprimtarine elektorale të kandidatit **ILIR KROSI** mund të ndiqni faqen në FB:

<https://www.facebook.com/pages/Ilir-KROSI/118050834940291?sk=timeline>

Grupi i Dibrës prezantohet në mënyrë dinjitoze në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës

Era dhe defektet teknike zbehën suksesin

Për shtatë ditë me radhë, nga data 10-17 maj 2015, në Gjirokastrë u mbajt edicioni i 10-të i Festivalit Folklorik Kombëtar.

Në këtë edicion, Grupi i Dibrës konkurroi në natën e dytë, ku artistë popullore nga Mati, Bulqiza e Dibra përformuan në skenë traditat më të mira folklorike.

Të parët që u ngjitën në skenë ishte grupi i Bulqizës, me "Dasmën bulqizake", ku ra në sy kostumet popullore shumë të veçanta dhe origjinale. Dasma ishte e harmonizuar me elementët kyç: përgatitjen e dasmës, ardhjen e krushqeve, këngën, vallen, nisjen dhe mbërritjen e nuses. Grupi i Bulqizës solli në festival ritet origjinale të një dasme tradicionale, pothuajse të harruar, që dikur zgjaste nga e mërkura deri të dielën.

Grupi i Burrelit e nisi prezantimin në Gjirokastrë me "Këngë të këndueme" nga grupi i valleve të grave të Gurit të Bardhë. Më pas vajzat e Macukullit sollën një valle të shoqëruar me fyell, lodër, çifteli e lahutë. Një valle dyshe burrash theu ritmin në këtë prezantim, ndërsa shkëlqyen me performancën e tyre grupi i instrumentistëve matjanë me një melodi orkestrale. Bilbili i orkestrales matjane tingëlloi bukur në Festivalin e Gjirokastrës, shoqëruar nga çiftelia dhe kori orkestral. Orkestrala e Matit ishte një ndërthurje harmonike mes korit të çiftelive dhe tingujve të bilbilit.

Grupi i Dibrës u paraqit me "Ritin e përgatitjes së dasmës", "Valle Burrash", Këngën për Sul Elezin", kënduar nga Myfterim Kupa dhe Sherif Dervishi, "Zogu i çičes" kënduar nga Eralda Jashari, "Për liri e për flamur" kënduar nga Qerim Sula.

Grupi Folklorik i Dibrës, Bulqizës e Matit bëri një paraqitje dinjitoze, megjithëse kjo duket se nuk u vlerësua shumë nga juria, e cila nderoi me çmimin e karrierës këngëtarët Myfterim Kupa dhe Qerim Sula, ndërsa Ansambliin Mati e nderoi me çmimin si Orkestrina më e mirë e Veriut.



POST-FESTIVALI

Për Dibrën nuk duket se ka shkuar gjithçka siç duhet në Gjirokastrë. Jo vetëm për shkak të helmimit nga ushqimi, por edhe për shkak se u duk se Grupi i Dibrës nuk mori vlerësimin e duhur. Së pari, pjesëmarrja e Dibrës në rang qarku, nuk bëri përfaqësimin e duhur. Kjo edhe për shkak se disa zona, tradicionalisht të lidhura me folklorin dhe traditën e Dibrës u përfaqësuan në rrethe të tjera. P.sh, gajdja, instrument që është përdorur vazhdimisht në zonën e Klenjës,

u përfaqësua në festival nga Elbasani, që nuk ka asnjë lidhje me këtë instrument.

"Dibra ka 70 lloje dhe variante kostumesh, dhe duhet të kesh 70 vetë për t'i paraqitur të gjitha kostumet", thotë Përparim Tomçini, kompozitor. Ai shpreh keqardhje që Dibra nuk u vlerësua për paraqitjen e kostumeve, pasi ishte një nga qarqet më të kompletuara. Gjithashtu, Tomçini thotë se një vlerësim duhej edhe për dy lahutarët e vegjël të Matit, të cilën jo vetëm që nuk u evidentuan gjatë prezantimit, por edhe u lanë në hije, qoftë nga media, qoftë nga juria.

Myfterim Kupa dhe Qerim Sula marrin çmimin e Karrierës. Ansambli i Matit vlerësohet me çmimin si Orkestrina më e Mirë e Veriut.

Përparim Tomçini thotë se është një vlerë për festivalin prania e një 104 vjeçari, por vlera më e madhe është prania në festival e dy fëmijëve me lahutë, të cilët shpresojmë se do ta ruajnë traditën.

Në vitet në vazhdim do të jetë shumë e vështirë transmetimi i vlerave folklorike, pasi tani nuk po kryhen më ritet e tradicionale të dasmave, gëzimeve, etj. Futja e elementëve kompjuterikë në muzikë, ka humbur efektet e gjalla të folklorit. Çiftelia dëgjohej shumë rrallë në dasmat dibrane dhe shumë shpejt ajo do të jetë një tingull i harruar.

Përparim Tomçini thotë se edhe tekstet e prezantuara kanë qenë ndër më të mirat e Dibrës. "Materialet letrare kanë qenë shumë të bukura. Kënga e kënduar nga Qerim Sula ishte shumë e bukur. Por, ndërsa ajo u duartrokoi shumë gjatë provave paraditë, në prezantimin zyrtar nuk u dëgjua. Kënga kishte elemente polifonikë dhe për fat të keq zëri i burrave, që mbanin ison, nuk u përcua të spektatori, pasi nuk punonin mikrofonat"

Festivali Folklorik Kombëtar është zhvilluar për herë të parë në vitin 1968 në Gjirokastrë dhe nga 10 edicione, vetëm njëri është zhvilluar në qytetin e Beratit në vitin 1995.

Grupi Folklorik i Dibrës ka marrë pjesë në të gjithë edicionet e Festivalit dhe është nderuar edhe me çmime. Dibra është nderuar me çmimin e Lauratit të Festivalit në vitin 1978, ndërsa në vitin 1983 ka marrë çmimin e dytë dhe pesë vite më vonë, në vitin 1988 me çmim të tretë. Gjatë dhjetë edicioneve janë nderuar edhe me çmime e medalje të ndryshme artistë të veçantë.

Artemisa Repa, sopranoja dibrane me përmasa botërore



nozze di Figaro" dhe "Don Giovanni".

"Cosi fan tutte" mund të përkthehet "Kështu bëjnë të gjitha (gratë)" dhe është përdorur vazhdimisht në kuptimin që "Gratë janë si kjo".

ARTEMISA REPA, SOPRANOJA DIBRANE E SKENAVE BOTËRORE

Sopranoja Artemisa Repa aktualisht jeton në Bejrut. Ajo me parë ka qenë edhe në Brazil, ku ka shkëlqyer në disa shfaqje operistike atje. Është diplomuar në vitin 2002 me notë maksimale pranë Akademisë së Arteve të Tiranës dhe është specializuar në vitin 2006 pranë Conservatorio di Musica "S. Cecilia" në Romë, ku është klasifikuar e para në mes e mëse njëqind këngëtarëve nga kombësi ndryshme.

Fituese e konkurseve të shumta ndërkombëtare, mes të cilëve vendin e dytë në festivalin Ndërkombëtar "Marie Kraja" në dhjetor 2004, vendin e parë në konkursin ndërkombëtar G. Rosini ne Bad Vilbaden në Gjermani në vitin 2003, vendin e tretë në konkursin ndërkombëtar "Enriko Karuzo" (Milano 2004), "Zandonai", (Riva del Garda, Itali, 2003) dhe ka qenë në dhjetëshen më të mirë në konkursin "Leila Gensher" (Stamboll, Turqi, 2008).

Ka ndjekur masterclass-e ne kanto me Mirella Freni, Raina Kabaivanska, Katia Ricciarelli, Mietta Sighelle, Giovanna Canetti, Marinella Meli dhe Elisabetta Di Stefano.

Ka marrë pjesë si soliste në koncerte të shumta në Itali dhe vende të tjera në salla të famshme si Auditorio Santa Cecilia del Parco della Musica a Roma (2004) apo në Kishen e Shen Irenes në Stamboll (2007) -dhe ka interpretuar role të ndryshme në opera, mes të cilave Serpina ne La serva padrona të Pergolesi (2001), Carolina ne Il matrimonio segreto te Cimarosa (2001), Lucy ne Il telefono te Menotti (2003), Giulia ne La scala di seta te Rossini (2003), Giulietta ne Capuleti e Montecchi te Bellini, në Teatrin e Operes se Stambollit (mars 2008), koncert në Festivalin e XXI Ndërkombëtar në Civita, Itali (Gusht 2010), koncert me muzikë Barok shoqëruar nga Clavincembol nga i mirënjohuri Nicolau Figueredo, Sao Paulo, Brazil (2011), recital në PERU me rastin e Pavarësisë së Peruse (Maj 2013), "Messe di Gloria" Brazil (2012) dhe Beirut (2013,2014), etj.

Korresp. Rr.A.

kjo është se "si Ata bëjnë të gjitha".

Muzika e Mozart mbetet hyjnore e gjallë, fluide, me një trishtim të padukshëm ...

Këngëtarët i realizuan shumë mirë detyrat e tyre në *Bel Canto*, recitativet, aria, duet dhe tercetet, me përkushtim dhe zell.

Salla 400 vendshe e *Emile Bustani Auditorium Hotel el-Bustan*, ishte e mbushur plot dhe spektatorët duartrokoi gjatë përfundimit e kësaj opera-bufa në dy akte.

"Loja aktoreske, saktësia në interpretim, zëri i veçantë dhe melodioz, eksperiencia operistike e Sopranos Artemisa Repa në Rolin e Fiordiligiit, plotësoi kënaqësinë e spektatorëve dhe ishte përvojë për traditën e operës në Liban", u shprehën dirigjenti dhe drejtori artistik Toufik Maatouk dhe ai Italian Alberto Maniaci.

Orkestrës Rinore e Mesdheut (Palermo), interpretoi me kompetencë dhe nivel të lartë artistik. Kritika muzikore në Beirut e vlerësoi të suksesshme realizimin e kësaj opera premiere.

COSI' FAN TUTTE - PAK HISTORI

Opera "Cosi' Fan Tutte" është shfaqur për herë të parë në Vjenë në janar 1790-ës. Ajo u ndalua për disa muaj, për shkak të vdekjes së Perandorit Jozefi II. Në qershor 1790 u rishfaq përsëri dhe prej asaj kohe është interpretuar në skenat më të famshme operistike të botës.

Ka dyshime se kjo u la e papërfunduar nga Moxarit dhe libratin final e shkroi Lorenzo Da Ponte, autori edhe i dy libreteve të tjera "Le



22 fitore, një barazim dhe një humbje, janë shifrat më të bukura që Korabi kish njohur dhe arritur në gjithë historinë e tij

Rikthimi i madh i Korabit



BRIKEN DOÇI: 1 gol, qendërbrojtës stabil

ERBLIN LAÇI, treneri i ekipit

INDRIT DOÇI: veteran i ekipit

KLEVIS KACNIA: 3 gola, organizatori i ekipit

ALGER BRAHASANI: 3 gola, talenti dibran

XHULIO TORBA: e ardhmja e portës së Korabit

ALDO SHKALLA: shumë luftarak

ERIND SELA: mesfushor

ERIKSON AGA: gardian i portës

ARDIAN KALOSHI: sulmues

SHPËTIM TOSKA, zv.traineri i ekipit

BESFOR LACI: 2 gola, vendimtar i fitoreve në fazën e parë

KLODIAN MELANI: 4 gola, blerja më e suksesshme

FILIPO MUCAJ: 4 gola, mesfushor me perspektivë

ERLISJON BARDHI: 1 gol, mbrojtës me përvojë

ARTUR ALIMANI, mjeku i ekipit

RIGERS KARAJ: 4 gola, shtylla e ekipit

MERLIND TOSKA: sulmues, 4 gola, Toska junior

FABJON IBRA: mesfushor

ERIOD MERDINI: 8 gola, sulmues kryesor

OLSIAN LAMAJ: 1 gol, shpejtësia e ekipit

Foto: © Fehmi Lleshi

Nga **DEFRIM METHASANI**

Si rrallë herë në historinë e futbollit shqiptar, Korabi këtë sezon është bërë protagonist, madje duke ardhur deri në një finale për të diskutuar edhe titullin kampion në kategorinë e dytë me Gramshin. E ndërsa në Peshkopi ndeshjen me Albpetrolin e ktheu në festë, sepse shënoi emrin në listën e skuadrave të kategorisë së parë, në stadiumin kombëtar "Qemal Stafa" në Tiranë, pasditen e 23 majit, s'mundi dot të prekte atë trofe aq të lakmuar prej mijëra dibranëve që treguan qytetari dhe mbështetjen e ekipit e zemrës edhe pse humbi 3-1. Por kupa ishte një dëshirë për të shtuar kënaqësinë, sepse objektivi madhor ishte arritur.

22 fitore, një barazim dhe një humbje, janë shifrat më të bukura që Korabi kish njohur dhe arritur në gjithë historinë e tij. Një skuadër që na mbajti në emocion gjatë një viti. Nga java në javë rritej dëshira për të ndjekur dhe mbështetur Korabin, këtë ekip të mbështetur nga bashkia e qytetit, si donatore kryesore, presidenti kurajoz Fehmi Mëziu, drejtori i klubit Sokol Muho dhe sportdashësit e zjarrtë dibranë, që ishin faktor ndihmues, jo vetëm në numër dhe sasi, por edhe në cilësinë e kësaj mbështetjeje. Natyrisht, roli i futbollistëve dhe trajnerëve, Erblin Laçi, Shpëtim Toska të ndihmuar edhe nga Telman Përleka që punoi me grupin e futbollistëve të Tiranës, ishte një rol përcaktues në këtë mision, sa të madh, aq edhe të vështirë, një mision historik që ngriti në një stad jo vetëm emrin sportiv të Korabit, por edhe vetë Dibrën dhe lervave të saj.



FEMI MËZIU, Presidenti i Ekipit



TELMAN PËRLEKA, trajneri i grupit në Tiranë



SOKOL MUHO, Drejtor i Klubit "Korabi"



FEHMI LLESHI, fotoreporter i ekipit. Shumë foto të tij janë online në rrjetet sociale

Një shënim i tillë s'mund të lej jashtë vëmendjes, donator të tjerë, dashamirës që ndihmuan sadopak, madje edhe djemtë e Dibrës në SHBA, si zoti Agolli, Zuna, apo në Tiranë, si zoti Laçi e mjaft të tjerë. Korabi tshmë është një realitet i ri, është në një elitë futbollit, e cila sjell kënaqësi, por edhe përgjegjësi.

Korabi tashmë duhet ta respektoj këtë rikthim të emrit dhe nderit të tij. Një kompeticion i tillë, s'mund të vlersohet njëlloj si e shkuara e kategorisë së dytë, por me pikësynime dhe objektiva të tjerë, me financim dhe kualitete të tjera. Korabi është i të gjithëve dhe të gjithë kemi sytë nga ai, por që të shohim Korabin e ëndërrës, duhet që jo vetëm sytë t'i kemi nga fusha ditët e diela, por edhe mendjen, zemrën dhe mundësitë e një mbështetje financiare, duke vendosur të gjithë nga një gurë ne murin e ri dhe të madh të kategorisë tjetër, asaj të së parës.

Kukësi dhe Tërbuni, janë dy modele në që duhen ndjekur, jo pse i kemi afër gjeografikisht, por për shembullin që sollën duke u ngjitur në superiore e duke kapur edhe Europën.

Rikthimi i madh kërkon mbështetjen dhe vëmendjen e madhe, jo vetëm të një njeriu, apo disa të tillëve, por të një qyteti, të shumë dashamirësve dhe institucioneve që e duan jo vetëm futbollin, por edhe emrin e Korabit dhe Dibrës...

"Korabi i tregoi Shqipërisë se çdo të thotë qytetari"

Nga **SASHENKA NDREKA**

"85 vite histori, 52 vite pritje për ëndërrën" ishte kjo një ndër banderolat e vëna në stadium që tërhoqi më shumë vëmendjen e njerëzve që vetëfotografoshin pranë saj. Plot 52 vite pritje për ëndërrën dhe fati zgjodhi të na e sillte në realizimin, të na bënte ne dëshmitarë. Shumë skeptikë, pesë ndeshjet e para të fituara radhazi, apo dhe më shumë, ia linin fatit apo rastësisë, por me kalimin e javëve dhe pikëve që vetëm shtoheshin, së bashku me golat, ndryshuan mendim dhe mbushën shkallët e stadiumeve për krahu tifozërisë së zjarrtë që ka parë ndonjëherë futbollit dibran.

Historia e stadiumit u shkruajt në stadiumin "Qemal Stafa", i cili ka parë ndeshje më të mëdha e më të rëndësishme se ajo e datës 23 maj që vuri përballë Korabit Gramshin, dhe pavarësisht rezultatit të pamerituar, tifozëria dibrane nuk e humbi në asnjë moment kontrollin dhe qetësinë që e karakterizon, pavarësisht provokimeve të herë pas herëshme nga tifozëria kundërshtarë apo dhe vetë lojtarët. Protagonisti kryesor dhe normalisht atij që i atribuohet pjesa më e madhe e këtij suksesi është trajneri i kësaj skuadre, Erblin Laçi!

"Mua më duket sikur po jetoj një ëndërr nga e cila s'dua të zgjohem më kurrë! Më duket aq e pabesueshme që realizova një ëndërr fëmijërie, jo vetëm timen apo bashkëmoshatarëve të mi, por dhe prindërve apo dhe

brezave më të rinj", tha treneri i ekipit Erblin Laçi për gazetën.

"Ju ma atribuua mua fitoren, ndërsa unë dua ta ndaj së pari me lojtarët, të cilët kanë dhënë shpirtin në fushë, së dyti me kolegët e mi, zëvendëstrajnerët Shpëtim Toska dhe Telman Përleka, të cilët me eksperiencat e tyre shumëvjeçare, kanë qenë udhërrëfyes për mua. Dua të falënderoj gjithashtu bashkinë e qytetit dhe të gjithë donatorët, të cilët na kanë ndihmuar financiarisht dhe që pa ndihmën e tyre ndoshta nuk do të ishim këtu ku kemi arritur sot. Jo më kot e lash për në fund, tifozërinë dibrane, për ti dhënë një super falënderim, pasi të gjithë si një trup i vetëm kanë luajtur rol kyç në mbështetjen morale të lojtarëve, në të gjitha ndeshjet e luajtura, pavarësisht rezultatit, tha treneri i Korabit.

Për momentin ekipi është në një periudhë pushimi dhe suksesi pasi të gjithë mediat sportive kanë shkruar për to. E gjithë Shqipëria ka mësuar për Korabin dhe suksesin që korri, sikundër njiheshim më parë vetëm për dënimet apo sjelljet e pahijshme që tregonim në fushë. Madje për trenerin e ekipit, kjo është fitorja e madhe e arritur.

"Ekipi ynë ka qenë i keqedukuar. Dënimet që kemi marrë ndër vite kanë shkuar në ekstremitet, ndërsa gjithë kampionatin e tanishën e mbyllëm vetëm me një karton të kuq! Për mua kjo është arritja, fitorja dhe krenaria më e madhe. Ne i treguam Shqipërisë çdo të thotë qytetari."

Korabi është i të gjithëve dhe të gjithë kemi sytë nga ai, por që të shohim Korabin e ëndërrës, duhet që jo vetëm sytë t'i kemi nga fusha ditët e diela, por edhe mendjen, zemrën dhe mundësitë e një mbështetje financiare, duke vendosur të gjithë nga një gurë ne murin e ri dhe të madh të kategorisë tjetër, asaj të së parës.



Zabit Merdini, tifoz i Korabit me qeleshe i Korabit

Në stadiumin "Korabi", tifoz i më interesant, por edhe më i moshuar është Zabit Merdini. 84 vjeçari nga Sohodolli ndjek të gjitha takimet e skuadres së tij të zemrës, sepse së pari është tifoz i zjarrtë në vite, por ka edhe një arsye më shumë. Prej vitesh, nipi i tij, Oli Merdini, luan për ngjyrat e Korabit dhe është golshënuesi më i mirë me 8 gola. Shpesh herë kur ka shënuar, Oli ka nxituar drejt gjyshit dhe ia ka dedikuar golin e tij. Asgjë nuk e ndal të shkojë në stadium plakun me qeleshe, që krijon një respekt si tifoz i më tipik në atë qytet, me kësulën e bardhë si dëborë e maleve të Dibrës.

Si nisi dhe cila është perspektiva e biznesit të mollëve në Dibër?
Nga debatet politike të realiteti i punës në terren. Një histori sukcesi e fermerit Vehip Salkurti

Biznesmeni që ringjall shpresat e fermerëve

Nga MIRAN Tafa

NJË VIZITË NË FABRIKËN E RE

Midis fshatrave Tomin e Rashnapojë, pranë rrugës nacionale, e cila përshkon mes për mes Dibërën me fshatrat e saj, të zë syri një ndërtesë dy katëshe rreth 1200 m². Shumë nuk e dinin se çfarë është, po aq ishin kuriozë e pyesnin se çfarë po bëhet këtu. Dikush thoshte: "më duket se e bëjnë për grumbullimin e mollëve". Të gjithë shpresonin të ishin të vërteta ato që thuheshin, derisa në ballinën e kësaj ndërtese u shkruajt "KOP. FRUT DIBËR 2012".

Më të gëzuarit janë prodhuesit e vegjël të mollëve, të cilët shikonin aty një mundësi të mirë për të ardhmen e prodhimeve të tyre, që në shumicën e rasteve deri më tani u ka shkuar dëm, për shkak se nuk ka treg. E gjithë kjo për shkak se nuk konkurrojnë dot dhe si pasojë të mungesës së vazhdueshme të politikave mbrojtëse ndaj tyre prodhimeve të tyre. U desh një vizitë e Kryeministrit Edi Rama, që të besohej se çfarë ishte.

Vehip Salkurti bie dakord t'i bëjmë një vizitë në fabrikën e tij, të cilën e pranon më kënaqësi, megjithëse ditëve të fundit ishte rebeluar nga trajtimi që i bëjnë mediat deklarave të tij në dy kohë të ndryshme. Ndërsa një mik nuk harroi të më porosiste që të ndërhyja të Vehipi që mollët e tij shumë të mira të mund ti shiste aty.

Megjithëse pasdite vonë, vetë Vehipi kishte përveshur mëngët dhe po jepte e merrte duke vaditur lulet dhe pemët dekorative që i kishte mbjellë rreth e rrotull fabrikës.

"Ujin e kam nxjerrë me pus dhe furnizon krejt Dibërën", -thotë ai. Duke ujtur na tregon një ndërtesë ngjitur me të për të ilustruar se kjo ndërtesë ka qenë një gërmadhë, gjithashtu, që në kohën e monizmit, kur përdorej si repart i përpunimit të drurit. "Çfarë binte jashtë hynte brenda. Mbi 45 milionë lekë ka kushtuar vetëm terraca", -thotë Vehipi.

Në mjediset e brendshme të fabrikës të zë syri shumë fotografi rreth veprimtarive dhe vizitave të tij në vende të ndryshme të botës si në Francë, Madagaskar etj. për shkëmbime eksperiencash ose vizita të personaliteteve, ku së fundmi përmendet edhe Ambasadori i ShBA-ve në Tiranë, Donald LU.

Më interesante për tu parë ishin mjediset frigoriferike, katër dhoma të cilat janë të kompjuterizuara për të llogaritur ngopjen me lagështi dhe kontrolluar temperaturat. Një e nga një na tregon pajisjet dhe radhën e punës në linjën e prodhimit.

"Nëse punëtorët bëjnë ndonjë gabim dhe hedhin ujë apo lëndë të tjera me përmbajtje jo të njëjtë me atë të linjës së prodhimit, kjo pajisja këtu ndalon automatikisht punën", -shpjegon ai. Drejt mbylljes së ciklit të prodhimit vjen radha e ambalazhimit, etiketimit, datës së skadimit dhe markës së prodhimit. Punëtorët



nuk do lodhen për të ngjitur produktet në katin e dytë, nëse është nevoja, sepse fabrika ka edhe një ashensor të fuqishëm i parashikuar për pesha të rënda. Çdo gjë është ndërtuar me standarde, në të dyja krahët e fabrikës janë dy porta, njëra e llogaritur për hyrjen e lëndës së parë, tjetra për daljen e produkteve, pa patur nevojë sorollatjen lart e poshtë. Një dhomë super e madhe është vetëm për shishet ambalazhuese. Të paktën 2-3 milionë shishe llogariten të mbushen në vit".

Pas kësaj gjendemi në vendin e montimit të laboratorit për kryerjen e analizave të lëngjeve. Një ekspozitë brenda fabrikës është parashikuar që në fillim të projektit, me qëllim që të interesuarit të kenë mundësinë të njihen që këtu me produktet që prodhon kjo linjë. Një pajisje e veçantë është vendosur për prodhimin e lëngut të qershisë, kumbullës dhe thanës.

"E bëra jo vetëm për vete, por edhe për të tjerët rreth meje", -thotë Salkurti, i cili nuk e fsheh që është një besimtar i rregullt, duke cituar edhe një porosi të Profetit Muhamed: "O ju njerëz, mos ndjeheni rehat në shtëpiat tuaja, po qe se komshinjtë nuk janë rehat".

HAPAT E PARA NË BIZNES: NGA LOPËT TË MOLLËT

Vehip Salkurti, 56 vjeç, është një agronom i mesëm në profesion. Ai e ka filluar biznesin në vitin 1998 më mbarështimin e lopëve alpine franceze.

"Tani nuk merrem më me lopë, thotë ai. Ajo ishte një sprovë e imja. M'u dha mundësia të bashkëpunoj më një shoqatë, ADAD, në të cilën tani jam kryetar, e krijuar si bashkëpunim i shtetit francez (Asambleja e Kooperativave të Francës) me individë dibran dhe me këtë rast në vitin 1996 ne krijuam ADAD-in, një

bashkëpunim shumë i shkëlqyer. ADAD-i s'na ka dhënë lekë por asistencë teknike, përvojë e cila bëri që të jemi në këtë nivel".

Vehipi, falë një bashkëpunimi të qeverisë shqiptare me MAD-ën arriti të sjellë fidanë shumë cilësore dhe të shtrenjtë, por që i rimburoi shteti francez dhe shqiptar. Më pas ai filloi t'i largohej blegtorisë dhe iu "qep" frutikulturës, ku sot ka një sipërfaqe të konsiderueshme.

"Në vitin 2001 solla ca fidanë nga Franca ngaqë kisha marrëdhënie me shoqatat franceze dhe ato më sugjeruan këtë kulturë. Unë u tregova i gatshëm në bashkëpunim. Këto fidanë ishin shumë të shtrenjtë dhe cilësore, por unë i pagova me çmimin e tregut, sepse pjesën tjetër të lekëve e mbuloi qeveria shqiptare me atë franceze. Ky ishte një investim i suksesshëm dhe pas asaj dite unë kam ardhur duke e rritur sipërfaqen e mbjellë", thotë Vehipi.

Ai shton se "vetëm në vitin e pestë të prodhimit pemëtorja i mbuloi të gjitha shpenzimet. Gjithashtu, rendimentet kanë qenë europiane si në sasi ashtu edhe në cilësi". Ai thotë se vetëm nga pemëtorja e tij ka arritur të prodhojë 70-80 kv mollë për dynym dhe duke pasur parasysh se ai ka të mbjella 50 dynym tokë, shumë shpejt prodhimi i tij do të jetë mbi 4 mijë kv.

Në fermën e tij Vehipi ka mbjellë rreth 1500 rrënjë dardhë dhe mbi 200 rrënjë qersh.

"Këtë vit kam arritur të prodhoj 1500-2000 kë mollë, ndërsa rendimenti i dardhëve është më i vogël sepse edhe sipërfaqja është e tillë. Por puna me dardhët ka më shumë vështirësi edhe për shkak të një lloj sëmundje që quhet "zjarri bakterial". Pemët që preken nga ky lloj virusi i zëvendësoj. Sa për prodhimin e qershive, nuk i kam me peshë, por me vlerë leku e cila mund të variojë në 6 deri 10 milion lekë në vit", thotë Vehipi.

"Këtë vit kam arritur të prodhoj 1500-2000 kë mollë, ndërsa rendimenti i dardhëve është më i vogël sepse edhe sipërfaqja është e tillë. Por puna me dardhët ka më shumë vështirësi edhe për shkak të një lloj sëmundje që quhet "zjarri bakterial". Pemët që preken nga ky lloj virusi i zëvendësoj. Sa për prodhimin e qershive, nuk i kam me peshë, por me vlerë leku e cila mund të variojë në 6 deri 10 milion lekë në vit", thotë Vehipi.

NË KËRKIM TË TREGUT

Për shitjen e tyre ai ka operuar me tregun lokal dhe me atë të Tiranës, ndërsa e fsheh ambicijen për tu bërë gati për eksport.

"Ajo që do më japë avantazh për në vazhdim për tregun e jashtëm është se unë kam krijuar markën e prodhimeve dibrane. Jam ndoshta i pari në vend që e bëj këtë gjë. Prej tre vitesh vazhdoj në fazën e regjistrimit, i sponsorizuar nga një fondacion polak dhe jam gati në përfundim". Ky markim do të ndihmojë pa masë fermerët e tjerë dibranë, të cilët do të regjistrohen dhe do të bëjnë të njëjtin prodhim me atë të Vehipit, prodhim i cili do të markohet me pullë.

"Unë isha para një jave në Tiranë ku pyeta në treg për çmimin e qershisë, e tregtari më thotë 6 mijë lekë për kg se janë qershë dibre, ndërkohë që në Dibër akoma nuk ishin pjekur. Ndërsa markimi i prodhimeve ndalon abuzimet e tregtarëve në çmim dhe cilësi, mbron prodhuesin dhe konsumatorin", thekson Vehipi.

NEVOJA PËR FINANCIM

"Duke qenë se jam njeri i besueshëm, kërkova një hua në një bankë me vlerë 320 milionë lekë me të drejtë kthimi deri sa të më rimburohet vlera e shpenzimeve", thotë Vehipi, duke iu përgjigjur pyetjeve se si ka mundur ta gjejë financimin.

"Kjo ishte kredi me interesa të ulta. Akoma nuk kam filluar që ta paguaj këtë hua, paguaj një këst shumë të vogël sepse kështu është bërë marrëveshja me bankën dhe kur të më kthehen lekët do e mbyll si kredi. Normalisht kam nevojë për financa, sepse do të fillojë prodhimi i lëngut, për ambalazhin, produktin e ndonjë gjë tjetër. Në këtë lloj investimi të gjitha bankat ofrohen të të japin kredi.



Dibranët i kanë mundësitë të ecin përpara me punën e tyre, por "shtetin" nuk duhet ta kenë nëpër këmbë, por ta kenë krah për t'i dhënë ndihmën ekonomisë së tyre të brishtë. Dhe kështu do të kemi "qindra" Vehipa që do të mund të presin çdo ditë, drejtorë, deputetë, qeveritarë dhe Kryeministra!

Megjithatë në Shqipëri ka një problem sepse qeveria duhet të punojë me bankat, ti detyrojë bankat që të ulin normat e interesit, sidomos për bujqësinë që është sektor i cili u shërben të gjithëve. Vendet e tjera europiane investojnë shumë për bujqësinë. Këto vende 50 përqind të buxhetit e çojnë për bujqësi. Por neve akoma nuk e kemi kuptuar se e ardhmja e Shqipërisë është bujqësia dhe turizmi, asnjë rrugë tjetër. 140 milionë euro jep Maqedonia sot për bujqësinë, Shqipëria vetëm 5 milionë".

GJETJA E INVESTIMEVE, NJË SFIDË PËR TU FITUAR

"Në korrik të vitit 2014 nisi projekti. Ishte një sfidë, sepse afati i përfundimit të investimit ishte 4 muaj. Kur erdhi Ministri i Bujqësisë nuk e besoim se e kam bërë këtë investim kaq shpejt. Pesëdhjetë e sa milionë ka kushtuar vetëm tarraca, në të cilën kam venë panele diellore. Mundësitë për zhvillimin e bujqësisë janë pa fund, mjafton ti kërkojë ato. Për shembull unë sot isha me një seminar për projektin SARET, i mbështetur nga qeveria Daneze dhe Gjermane të cilat kanë në dispozicion gati 13 milion euro për t'u thithur nga fermerët. Ofrojnë që nga pajisjet për zyra, kompjutera, makina të cilat të jenë në funksion të prodhimit, zëtorë, pajisje për energji të rinovueshme etj. Dibra përfiton më shumë se 65-70 përqind sepse është rrethi më i prapambetur. Nëse fermeri dëshiron të bëjë një investim, duhet t'i gjejë vetë burimin e financimit dhe kur mbaron investimin ashtu siç është e shkruar në letra dhe donatorët janë dakord pas kontrollit, 70 përqind të shpenzimeve t'i kompensojnë. Unë në këtë donacion katër projekte i fitoj automatikisht, si pajisjen e frigoriferëve me arka që më kushton 80 mijë euro, blerjen e një furgoni, mjafton që unë të bëj kontratën me fermerët. Kam kërkuar edhe energjinë e rinovueshme, e nëse unë do arrij të furnizoj frigoriferin me atë energji për mua është fitore e madhe".

MOLLËT E KORÇËS NË DIBËR, LËNGU I MOLLËVE NË EUROPË

Lajmet se mollët e Korçës do përpunohen në Dibër nuk janë trillime.

"Ky është një investim që Korça e ka zili, thotë Veipi. Dhe nuk do të jetë e largët dita kur maunet me mollë do të shkarkohen në fabrikën e tij". Gjithashtu, Vehipi thotë se kanë filluar edhe kërkesat nga kompani të huaja, të cilat e duan të gjithë lëngun e mollës, mjafton që unë do ti vë etiketën e saj, me një mbishkrim të vogël, përveç etiketës sime. Ata janë të interesuar sepse lëngu natyral ka bërë shumë jehonë.

"Ajo që është me të vërtetë risi në marrëdhëniet e punës në vazhdim është lidhja e kontratave me fermerët, thekson Salkurti. Fermerët prodhues të mollëve do të jenë të detyruar të përdorin vetëm ato pesticide që do iu jap unë, sepse në fund unë bëj analizat e frutit, e nëse janë përdorur helme të tjera që prishin cilësinë e lëngut, unë e ndërpres kontratën. Këtë e bëj për të qenë i garantuar në cilësi, sepse edhe unë do e çoj lëngun për analiza në laboratorin e Barit, Itali, i cili është laborator i Komunitetit Europian. Në këtë laborator kontrollohet cilësia që lëngu të mos jetë i ndotur. Pra unë i kërkoj të gjitha këto sepse dua të jem i besueshëm në treg".

Kapaciteti prodhues i fabrikës së tij është 1.5 ton lëng në orë dhe të paktën 2-3 milionë shishe llogariten të mbushen në vit. Në këtë linjë përpunohen të gjithë llojet e frutave si qersh, kumbulla, thana, karrota, boronicë etj.

FABRIKA, NJË MUNDËSI PUNËSIMI NË RRJETIN ZINXHIR

Vehipi thotë se ai vetë ka të punësuar dy kategori punëtorësh, të përhershëm dhe sezonal. Këta të fundit në periudhat e krasitjes, rrallimit, vjeljes dhe magazinimit. Ndërsa në linjën e prodhimit mund të punojnë 5-6 punëtor, pasi

...Fermerët prodhues të mollëve do të jenë të detyruar të përdorin vetëm ato pesticide që do iu jap unë, sepse në fund unë bëj analizat e frutit e nëse janë përdorur helme të tjera që prishin cilësinë e lëngut, unë e ndërpres kontratën. Këtë e bëj për të qenë i garantuar në cilësi, sepse edhe unë do e çoj lëngun për analiza në laboratorin e Barit, Itali, i cili është laborator i Komunitetit Europian. Në këtë laborator kontrollohet cilësia që lëngu të mos jetë i ndotur. Pra unë i kërkoj të gjitha këto sepse dua të jem i besueshëm në treg".

teknologjia është e përparuar. Numri punëtorëve në fermën e tij mund të arrijë 60-70, por me shtimin e sipërfaqeve të mbjella, mund të rritet edhe numri i të punësuarve.

"Por numri më i madh i të punësuarve do të jetë në procesin e prodhimit, numër i cili shkon deri në 1500, thotë ai. Në këtë numër llogariten të punësuarit në familjet fermere, me të cilat unë do të lidh kontrata. Pra, fermerët njëkohësisht punësohen duke qenë të motivuar se tregun e kanë të sigurtë".

VIZITA E KRYEMINISTRIT, DY ANË TË NJË MEDALJE

Vehipi nuk e fsheh zhgënjimin që ka marrë nga mediat për trajtimin e këtij rasti. "Ai është Kryeministri i të majtëve dhe të djathtëve, i fermerëve dhe i gjithëkujt tjetër. Është detyrë e në, dibranëve, që t'i mirëpresim miqtë kushdo qofshin ato. Inskenimi që i bënë mediat ishte e pamoralshme, shumë e pamoralshme, sepse kanë nxjerrë videon që kam folur te PD-ja dhe takimin me Ramën këtu. Ramës i thashë: "Berisha ia pat borxh Dibrës Rugën e Arbrit". Historia e rrugës së Dibrës i intereson gjithë kombit, jo vetëm mua. Rruga e Arbrit iu intereson sepse afron tregjet, ofron mundësi për shitjen e frutave, zarzavateve dhe bulmetrave sepse e gjithë "lufta" është për të kapur tregun e Tiranës. Pra Rruga e Arbrit është rrugë për hallexhiun. Unë e falënderoj Ramën se më dha investimin". Por, Vehipi, pavarësisht shijes së keqe të interpretimit të vizitës, ndjehet i kënaqur, pasi ajo pati një ndikim të promovimit e biznesit të tij.

"Shumë njerëz, pas ardhjes së Kryeministrit, më kanë telefonuar, më kanë kërkuar lëng dhe më janë ofruar në kontrata. Nga Gjermania më kanë kërkuar sasi të mëdha lëngu".

NDIHMJA QEVERTARE - JETIKE PËR MBIJETESËN FRUTIKULTURËS

"Shteti e ka filluar ndihmesën, sepse ka hapur disa kredi pa interes, e unë jam një ndër to që kanë marrë që kam bërë frigoriferin", thotë Salkurti. Ai shton se duhet një bashkëpunim ndërmjet institucioneve qeveritare, bankave dhe fermerëve me qëllim rritjen e kapaciteteve. Qeveria mund të vendosë një fond garancie për bujqësinë, duke nxitur kështu bankat të ofrohen më shumë drejt sektorit bujqësor. Shteti ka mundësi të ndihmojë fermerët duke iu paguar atyre detyrimet e prapambetura ndaj bankave. Shteti duhet të ngrejë Bankën Bujqësore që të mbështesë fermerët me kredi me interesa të ulëta dhe me afat të gjatë. Nëse shteti ngre një bankë bujqësore si konkurrente të këtyre të tjerave atëherë bujqësia lulëzon. Ngritja e kësaj banke ka impakt të jashtëzakonshëm në zhvillimin e bujqësisë. Kjo gjë rrit prodhimin kombëtar, rrit punësimin dhe të ardhurat", përfundon bisedën Vehip Salkurti



Shënim

Për ata që se njohin Vehipin!

Këto ditë qarkulluan dy video me në qendër Vehip Salkurtin: Njëra që priste Kryeministrin në fabrikën e tij moderne dhe tjetra që fliste në Konventën e PD për fshatin. Dhe, duke shikuar këto dy video, mediat e Tiranës "zbuluan" "skupin" e këtyre zgjedhjeve.

Por, kush është Vehip Salkurti?

Ai është një fermer nga Dibra, shumë punëtor, që zgjohet në orën 4 të mëngjesit dhe e mbyll punën në 10 të darkës, që ka bërë pemetore model me fruta, të gjitha me investimet e tij, ka përdorur varietetet dhe teknologji nga më të rejtat dhe ka ruajtur edhe varietetin autokton.

Vehipi është një organizator dhe bashkëpunues model, i cili ka organizuar grupet e fermerëve të Dibrës në Shoqata dhe ka bashkëpunuar shumë ngushtë me shoqatat e fermerëve të Francës, Italisë, Spanjës, Maqedonisë dhe një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Universitetit Bujqësor dhe shoqatave të huaja dhe vendase.

Vehipi është me shpirt të madh sipërmarrje dhe njeri shumë aktiv. Të pamundurën e bën të mundur me punë, ku tokat e kuqe e djerrina i ka kthyer në bahçe të lulëzuara. Ka ndërtuar i pari pikën frigoriferike, ndërtoi i pari punishten e vogël të përpunimit të frutave, që merr pjesë në çdo panair të prodhimeve bujqësore në nivel lokal dhe kombëtarë, që ka hapur i pari markën e prodhimit "Mollë Dibrë", që është i pari që bën një investim gjigant prej 1 milion Euro në fabrikën e lëngjeve të frutave, nga të cilat 500 mijë Euro janë investimi i tij dhe 500 mijë Euro është mbështetje nga programet e EU për bujqësinë në Shqipëri. Ai ka vendosur një teknologji franceze shumë bashkëkohore dhe më e madhja në Ballkan, ku do prodhohet lëng frutash me destinacion eksportin.

Vehipi është një besimtar që praktikon virtetet dhe praktikat më të mira të një islami të mirë, për paqe, mirësi, punë, miqësi, përkushtim, obligim ndaj Zotit dhe njerëzve. Ai ka kontribuar në shumë vepra komunitare dhe në ndërtimin e xhamisë së fshatit të tij.

Vehipi është demokrat dhe me PD, që ka besuar dhe kontribuar që demokracia të instalohet në Shqipëri, pasi ka besuar në ekonominë e tregut, në pluralizëm, në lejimin e besimit në zot, në shtetin e së drejtës, e shumë parime të tjera të demokracisë.

Vehipi është bujar, derën e shtëpisë e mban hapur gjithmonë dhe tryezën e mbush plot, jo vetëm më ushqim por dhe me gaz, hare e mikpritje.

Nuk ka kryeministër, ministër, ambasadorë,

grupe me vizitorë - vendas dhe të huaj - që nuk kanë provuar bujarinë dhe mikpritjen e Vehipit, frutat, ëmbëlsirat dhe gatimet tradicionale që gatuan në këtë familje.

Gazetarët e redaksive të sotme, mbyllur brenda pallatesh pa leje, megjithëse kanë mjaft që nuk kanë marrë rrogat e tyre, duke punuar si skllëvër te bosë të mëdhenj të ndërtimit e politikës, duke shfrytëzuar teknologjinë dhe cinizmin profesional, shfrytëzuan thjeshtësinë, mikpritjen dhe bujarinë e Vehipit, për të dhënë një lajm të stisura dhe të pavërteta.

Vehipi nuk i din këto "marifete" të gazetarëve të sotëm. Vehipi nuk i kupton këto truke. Ai nuk e din që pronarët e këtyre mediave nuk lënë gjë pa bërë që ti pëlqejnë Ramës, Berishës apo Bashës. Ai nuk e di se si në këto "kuzhina" lajmesh përgatiten lajme kundër apo pro njërit e tjetrit, për të marrë një reklamë qeveritare, një tender nga bashkia apo një ftesë në kryeministri për Vitin e Ri.

Vehipi jo vetëm nuk i di këto gjëra, por ai nuk ka kohë dhe mundësi që ti dijë këto gjëra. Sepse kohën e tij e ka për punë, për biznesin, për miqtë. Vehipi vazhdon traditën dibrane ku "pushka e trimit dhe sofrja e bujarit nuk shteron kurrë".

Vehipi e priti kryeministrin Rama, dhe të gjithë ata që e shoqërojnë, dhe me pritjen e tij nderon veten dhe Dibrën. Vehipi nesër do të presë dhe Lulzim Bashën. Ai do t'i presë, sepse është prona e tij, është djersa dhe munda i tij, është sipërmarrja e tij, është bujaria e tij që pret dhe përcjell. Gazetarët do vazhdojnë të shkruajnë sërisht. Por përpara se të shkruanin sulmet për Vehipin, do bënin mirë të mendonin edhe anën tjetër: në qoftë se Vehipi nuk ishte, çfarë do të vizitonte Kryeministri? Po burokratëve të vegjël lokalë që mburre para kryeministrit me punën e Vehipit, çfarë mendojnë?

Qeveritë do të ndërrohen vazhdimisht në këtë vend. Gjithashtu edhe burokratët e vegjël të zyrave të provincës. Para se ata t'i bllokojnë me policë tatimore e doganierë investimet e fermerëve vendas, duhet të mendojnë të gjejnë mundësi ndihme shtetërore për Vehipin dhe shumë të tjerë si ai.

Sepse dibranët i kanë mundësitë të ecin përpara me punën e tyre, por "shtetin" nuk duhet ta kenë nëpër këmbë, por ta kenë krah për t'i dhënë ndihmën ekonomisë së tyre të brishtë. Dhe kështu do të kemi "qindra" Vehipa që do të mund të presin çdo ditë, drejtorë, deputetë, qeveritarë dhe Kryeministra!

BESNIK ALKU

Kualifikimi i nxënësve në shkollën profesionale, krijon mundësi dhe perspektiva të sigurta punësimi. Ky është slogani për të tërhequr sa më shumë nxënës drejt arsimit profesional.

Shkollë dhe art: Një mundësi e mirë për të rinjtë

Nga MIRAN TAFI

Shkolla e Mesme Profesionale "Nazmi Rushiti" zhvillon gjatë muajit maj aktivitete për promovimin e programeve mësimore që kjo shkollë ofron. Në kuadër të promovimit të shkollës, në mjediset e Qendrës Kulturore të Fëmijëve u vu në skenë komedia "Pallati 176" nga mësues dhe nxënës. Këto të fundit janë konsideruar partnerë të mirfilltë në këtë realizim. Puna e dorës së tyre ishte kudo, në çdo skaj të shfaqjes. Profesionalizmi dhe origjinaliteti e shoqëruan nga fillimi në mbarim shfaqjen. Duke filluar nga përzgjedhja e personave të përshtatshëm për të luajtur rolet, rolë të luajtur nga aktorë të cilët kanë lënë gjurmë në jetën teatrale shqiptare e që nuk është e lehtë t'i dublosh.

Ajo që e bën profesionale këtë veprimtari nuk ishte vetëm aktrimi, por edhe puna e stafit për ndërtimin e skenës, regjia etj. Punën e regjisorës e bëri mjaft mirë Teuta Qosja, mësuese e letërsisë pranë kësaj shkolle, ndërsa ndërtimi i skenës u mundësua falë punës së studentëve të profilit përpunim druri, nën drejtimin e mësuesit të profilit përkatës, Adriatik Xholi. Jo vetëm kaq, gjithçka ishte realizuar sikur "Pallati 176" të ishte vënë në skenë për herë të parë, çdo element i skenës ishte në vendin e duhur. Realizimi në tërësi ngjalli emocione te publiku dhe krijoi një atmosferë emocionuese. As pjesëmarrja nuk ishte mbrapa, prindër, nxënës, mësues, ish-mësues e deri pensionistë e qytetarë të thjeshtë, të cilët u emocionuan nga realizimi kësaj komedie.

PAK HISTORI

Në vitin 1946 Seksioni i Arsimit me në krye Selim Alliu vendosi të hapë për herë të parë shkollën plotore (tre vite gjimnaz), prej ku do të dilnin mësuesit e parë. Pas dy vjetëve kjo shkollë u ngrit në rangun e një shkolle pedagogjike, duke u njohur zyrtarisht si një shkollë e tilë me drejtor Rexhep Kadzadei, ku gjithsej kishte 17 nxënës. Megjithatë brenda 4 viteve numri i nxënësve gati u pesëfishua. Në vitet '50' kjo shkollë mori karakter kombëtar duke u rradhitur ndër shkollat më të rëndësishme të veriut. Një avantazh që e ka patur gjithmonë ka qenë konvikti në të cilin qëndronin thuajse 90% e studentëve, pasi ato vinin nga zona të thella. Ndër mësuesit dhe drejtuesit që përmenden për punën e palodhur në këtë shkollë janë: Shefik Osmani, Astrit Hoxha, Zenel Sula, Sami Ferizi e Shems Manjani të cilët i dhanë reputacion kësaj shkolle. Nga dyert e kësaj shkolle dilnin mësues me formim të gjithanshëm shkencor e metodik. Në vazhdim përmenden Sotir Tema, Kolë Tahiri, Jorgji Sinjari, Fadil Kaca, Dyrmiş Shehu, Lavdrim Kaba, Nevrez Manjani, Ismail Erebara etj.

Mbyllet në vitin 1977, por nevoja për mësues në Veri, bëri që të hapet përsëri në vitin 1984. Vite të tëra përpjekje të drejtuesëve si: Naxhije Zekja, Mensur Murrja, Afrim Isaku, por edhe të mësuesëve Pëllumb Lala, Naim Alliu, Qani Pertafi, Hamdi Kaci etj, bënë që kjo shkollë të merrte fizionominë e një shkolle pedagogjike të mirfilltë. Si çdo sferë të jetës, edhe arsimit në Dibër u prek nga efektet e tranzicionit demokratik. Në vitin 1994 mungesa e interesit për këtë shkollë çoi në mbylljen e saj. Vetëm katër vjet më vonë u hap përsëri në godinën e ish-shkollës bujqësore.

NGA SHKOLLË PEDAGOGJIKE NË PROFESIONALE

Nevojt ndryshojnë me kalimin e kohës. Masivizimi dhe liberalizimi i



universiteteve, ndryshimi i strukturës ekonomike dhe shoqërore bëri që arsimimi të merrte një orientim të ri, drejt arsimit profesional. Që nga viti 2011 e në vazhdim kjo shkollë është kthyer në shkollë profesionale. Në mënyrë tranzitore nga pedagogjika në profesionale u ndryshua profili i kësaj shkolle.

Si fillim, në vitin shkollor 2004-2005 u hap gjimnazi gjuhësor me dy degë të huaja, anglisht dhe gjermanisht, degë që vazhdon edhe sot në kuadër të organizimit të kësaj shkolle. Po ashtu në këtë vit shkollor u çel edhe dega ekonomike (5 vjeçare), në vitin 2012 u kthye me sistemin 2+2. Në vitin 2009, në kuadër të strategjisë kombëtare për zhvillimin e arsimit profesional, hapet dega e arsimit të kombinuar të përgjithshëm, me profile Mekanike, Elektrike, Përpunim druri (2+1+1) ku për arsye të bazës materiale dhe mungesë specialistësh viti i dytë dhe i tretë kryhet në Shkodër, Tiranë ose Durrës. Në vitin 2009 hapet dega e TIK-ut me sistem 2+2, degë e cila është e kompletuar me bazë materiale dhe staf pedagogjik të kualifikuar.



Për vitin shkollor 2014-2015, Shkolla e Mesme Profesionale "Nazmi Rushiti" Peshkopi ka gjithsej 419 nxënës nga të cilët 238 janë femra. Drejtimi Ekonomik-biznesi, 7 klasa, 157 nxënës (femra 85). Arsimit Teknik i Kombinuar, 5 klasa, 92 nxënës, asnjë femër. Teknologji Informimi dhe Komunikimi, 4 klasa, 90 nxënës (femra 25). Gjimnaz gjuhësor, 3 klasa, 80 nxënës (62 femra). Nxënësit vijin kryesisht nga rrethi Dibër, të shumtë janë që vijnë nga zonat e thella, por edhe nga Bulqiza dhe Burreli.

Që nga 1 janari 2015 kjo shkollë vetëmenaxhohet në buxhet dhe burime kryesore. Ky status i jep mundësinë për një performancë më të mirë në aspektin e mësimdhënies dhe nxënies. Aktualisht kjo shkollë ka një staf mësuesor prej 36 mësuesish, ku katër prej tyre janë të jashtëm, një është instruktor praktikash.

PSE TË RINJTË DUHET TË ZGJEDHIN ARSIMIN E MESËM PROFESIONAL?

Drejtimesit e shkollës shprehen se si avantazh krahasues me gjimnazin, kjo shkollë përveç arsimit të përgjithshëm ofron edhe një zanat. Me ndër-

mjetësimin e shkollës nxënësit mund të zhvillojnë praktikën mësimore në institucione private apo publike (siç është rasti i kontratës me OSHEE-në). Kontrata janë nënshkruar edhe me zyrën e punës, e cila monitoron më tej punësimin e nxënësve. Konvikti konsiderohet një avantazh krahasues gjithashtu, të cilin e kanë të garantuar nxënësit e kësaj shkolle. Po ashtu, ata që plotësojnë kriteret për ndihmë ekonomike përfitojnë bursë studimi.

Projekte të ndryshme gjatë vitit shkollor në kuadër të promovimit të arritjeve profesionale janë realizuar. Përmendim këtu rastin e kompanisë DIAS (DIBËR-IDE-ARRITJE-SUKSES), të cilët morën pjesë në Panairin dhe Konkursin Kombëtar të Shoqërive të Nxënësve në prill 2015, pranë qendrës tregtare TEG, Tiranë ku prezantuan produktet e punuara në dru.

AVANTAZHET QË OFRON ARSIMI PROFESIONAL

Përfshin arsimin e përgjithshëm dhe, për më tepër mundëson dhe një profesion plus. Në përfundim të arsimit dhe formimit profesional je i përgatitur për tregun e punës. Gjithashtu, mund të fillosh aktivitet duke hapur biznes privat si dhe rrit afësitë konkurruese të nxënësve për në tregun europian të punës. Hap dyert e tregut për të ardhmen kur Europa të aplikojë "Kartën Blu" për afrimin sezonal të atyre që përfundojnë AFP-në si dhe të jep mundësinë e sigurimit teknik dhe kulturën e saj.

PROFILET DHE MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Shkolla "Nazmi Rushiti" ofron profilet Ekonomik 2+2 vite, Administrim Biznes 2+2 vite, TIK (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi) 2+2 vite, Shërbim Social Shëndetësor 2+1+1 vite dhe Arsim i Kombinuar Teknik me profilet: mekanike, elektronike dhe përpunim druri 2+1+1 vite. Ata që studiojnë në Teknologji informacioni mund të punojnë si teknik rrjeti, teknik për mbështetjen e përdoruesëve, teknik web, programues dhe dizajnues të faqeve web.

Ata që studiojnë ekonomik kanë mundësi të mëdha të punojnë në tregti, banka, agjensi sigurimesh, tatim-taksa. Studentët e administrimit punësohen si administratorë biznesi apo publik, ndërsa studentët e mekanikes mund të punojnë në makina metalpunuese, konstruksione metalike, studentët e elektronikës në instalim dhe mirëm-

batje të rrjeteve të tensionit të lartë dhe të ulët, instalime elektrike civile dhe industriale, riparim paisjesh shtëpiake, ata që studiojnë Përpunim druri mund të punësohen në prodhime druri, mobileri, tapiceri, ndërsa nxënësit e Shërbim Social Shëndetësor mund të punojnë si administrues, organizues, drejtues të qendrave social-shëndetësore, bizneseve sociale, fondacioneve, shoqatave (OJF).

SFIDA E NXËNËSVE DHE SHKOLLËS

Niveli mesatar i përgjithshëm i nxënësve që vijnë në këtë shkollë është relativisht i ulët. Kështu që kjo shkollë shpesh është konsideruar si alternativë e nxënësve me rezultate të ulëta në ciklin 9-vjeçar. Por edhe brezat e parë të dalë nga kjo shkollë akoma nuk i kanë marrë frytet e punës së tyre, kështu që duhet dhe pak kohë për nxënësit me rezultate të larta në ciklin 9-vjeçar të binden se po bëjnë zgjedhjen e duhur.

Gjithashtu struktura ekonomike e rajonit vitet e fundit nuk ka qenë mbështetëse ndaj sektorit të shërbimeve. Ky sektor ndihmohet shumë nga kjo shkollë me profilet profesionale të saj, pasi Dibra është një anek ekonomik në këtë kuptim. Rruga e Arbërit mendohet ta kthejë këtë zonë në përgjithësi dhe zhvillimin ekonomik të bazuar në shërbime në veçanti në një hapësirë ekonomike mjaft optimale.

Ajo çka i penalizon nxënësit e kësaj shkolle është koeficienti i ulët në provimet e maturës shtetërore për degët e tjera, pasi supozohet se edhe shkollat e larta do i ndjekin në të njëjtin profil. Kështu, nëse përfundon shkollën profesionale dhe të lartën kërkon të zgjedhësh një degë jashtë këtij profili, duhen rezultate më të larta se ç'mund t'i duhet një gjimnazist. Sfidë mbetet mbyllja e ciklit mësimor në këtë shkollë. Për efekt të mungesës së bazës së nevojshme materiale për mësimdhënie dhe stafit të specializuar, nxënësit i përfundojnë dy vitet e fundit në Shkodër, Tiranë ose Durrës. "Në mundësinë më të parë që do na jepet do realizojmë po këtu edhe ciklin e dytë të studimeve", - u shprehën drejtuesit e shkollës.

Mjediset e reja mbeten sfidë pasi është në projekt edhe hapja e degëve të reja si Shërbimi Social Shëndetësor. Literatura profesionale ka nevojë për më shumë libra. Labororet janë gjendje jo optimale (i fizikës dhe kimisë). Pajisjet e informatikës vazhdimisht amortizohen dhe duhen zëvendësuar apo riparuar, por kjo kushton.

Poeti invalid Përparim Luca, vlerësohet me çmim të dytë në poezi

Nga ILMI DERVISHI

Në konkursin poetik mes krijuesve të personave me aftësi të kufizuara ose siç tha dr. Moikom Zeqo, "me aftësi ndryshe", organizuar nga Shoqata para dhe tetraplegjikë, Dega Durrës, me kryetare poeten Adevie Hoxha.

Folën dr. Moikom Zeqo, Ibrahim Berjashi, shkrimtarë dhe poetë, drejtori i Tv "Teuta" në Ulqin, Bilal Alia nga qendra ditore "Sirena e Ulqinit" si dhe poetët Bardhyl Agasi, Agim Bajrami, Riza Qato etj. Në jurinë e pavarur dhe të panjohur me njëri-tjetrin nga poetë dhe studiues të letërsisë vlerësuan poezitë me kodet e tyre pa emrin e autorit.

Mes autorëve të njohur si Ligor Shyti autor i disa librave nga Përmeti, Sofie Zguri autore e pesë librave me poezi nga Korça, Venka Capa dhe këngëtar i njohur i serenatave Mihallaq Andrea, autori i disa teskteve të këngëve dhe poezive ishte edhe poezia "Shpirti poetik" me kodin 009 që mban për autor poetin nga Zall Dardha, Përparim Luca, i cili u vlerësua me çmimin e dytë.



Përparim Luca ka qenë aktiv në krijimtari dhe në punë, është ai Përparim që pas shkollës së mesme ngjiti deri në Maje të Madhe duke punuar, ndërsa tani e shohim me paterica, ndonëse me aftësi të kufizuara fizike shpirti i tij është i mbushur me familjen e tij të mrekullueshme, me djalin Aurelin student, i përkushtuar ndaj tij, me miqtë dhe librat. Ai vërtet jeton në fshat në Tartaj, por është përsëri aktiv me shpirtin e mbushur plot me optimizëm dhe poezi. Së shpejti lexuesit e Përparimit do të kenë në dorë librin me poezi.

SHPIRIT POETIK

Shpirti im, gjithmonë i trazuar, me fjalë e me shkronja, mbetet i ngatërruar.

E mora fjalën, ta vë në punë. ajo është kokëfortë e s'bindet nga unë.

Në fushën e betejës, ne të dy, luftëtarë. e Koha me ne, arbitri final.

-Se di ! Se di ! Kush do të jetë fitimtar?

Fjala endacake që më bredh nëpër fletë, apo shpirti im Poetik që Kohën e bën mbret!!!!....

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga BUJAR KAROSHI

Ta nisim me lajme të mira. Korabi u ngjit një kategori më lartë. Dhe njëra nga parullat e shfaqura në stadium ishte "O Korab mos ki frike se ke djemtë në Amerikë". Në fakt, rrofshin djemtë në fushë për lojën, presidenti për mbështetjen dhe Defrimi te TVSh-ja për publicitetin, se djemtë e Amerikës e kanë mendjen te Dibra e Madhe, Dibra e Vogël dhe armiku i brendshëm.

Këndej ka nisur fushata, dhe fushatat si fushatat: shumë fjalë, shumë premtime, pak punë. Në fakt, puna duhet parë, por siç thotë populli, "dita e mirë duket që në mëngjes" dhe mëngjesi si vrenjtur ka nisur, të paktën për katër nga kandidatët.

Këta të fundit, pasi morën vesh se janë kandidatë, kanë dalë në fushatë për të thithur ide për të hartuar programin. Se për të tjerat kanë mbështetjen e Ramës dhe Bashës, sigurisht, jo të futbollistëve të kombëtares.

Dikur thoshim se "bashkimi bën fuqinë", tani kanë ndryshuar kohërat: përçarja të jep pushtet. Ja, p.sh., je demokrat apo socialist, thuaj që do votoj partinë kundërshtare dhe menjëherë të vijnë ofertat: ose cash në dorë, ose post në pushtet lokal, së paku drejtor, sa për të marrë rrogën.

Lokalet e dasmave janë hapur para kohe. Jo për dasma, sigurisht, por për takime elektorale. Dhe si gjithmonë, kryebashkiaku i ardhshëm është ulur në vendin e dhëndrit, ndërsa nusja pritet të vijë me 22 qershor. Mund edhe të mos vijë, sepse varët se si sillen dasmorët.



Llixha në Peshkopi.

©E.Hasani

Rrefimet e Mondit



Nga EDMOND HASANI

Çmenduri

Ndjeva befaz se më ishte rritur mjekra e kjo po më bezdiste! Kisha tre ditë që isha varrosur! Nuk qenka aq keq sa e bëjnë atje lart, thashë më vete dhe me një dorë ngrita kapakun e arkivolit bashke me pllakat e betonit dhe dheun sipër e u habita me forcën time sepse për herë të fundit kisha ngrënë ca qofte me mish kali para se të vdisja nga thika e burrit të dashnores, e cila më kish dëmtuar dhe organin seksual!

U ngrita, hodha sytë rreth e rrotull varrezës dhe bëra tutje nga qiparisat e hyrjes mes shiut! Ngadalë u futa në qytet dhe mendimi i pare ishte të hiqja mjekrën, që gjithmonë kur isha sipër një miken time e frymëzonte për të më thënë: Heminguej!

U ndala tek berberia e parë që hasa! Berberi me një pecetë në dorë seç po shikonte në TV e pa më parë fare më thotë, ulu! Ulem duke pritur shkumën mbi fytyrë! Berberi afrohet me sytë nga TV e megjithëse një krimb i kuq i bie në dorë nga flokët e mia ai i shashitur më thotë: tani është çasti kur Mehmeti ja fut Fatimes!

Pas pak, kisha dalë në rrugë dhe uria me çoi drejt një dyqani mishi ku shitësja me një sy, seç po jepte e merrte me një kokë qeni në dorë!

Fillova të dyshoj nëse isha në ëndërr, nëse nuk kisha vdekur, nëse... kur papritur desh u përplasa me një të njohurin tim, ish burgaxhi politik, që po shëtiste duke qeshur nën një çadër

Disa prej tyre, ca dasmorë nga Gjorica, nxorën edhe një komunikatë - jo lufte, ku paralajmëronin dhëndurët që të mos gënjejnë shumë, sidomos për ujin e pijshëm.

Se në fakt, dhëndurët e kanë tepruar pak: do punojmë 24 orë për popullin, thonë si majtas, si djathtas, si të pavarurit. Por gjumë kur do të flenë, apo do të flejë populli për ta!

Folklori dibran e tundi këtë muaj Gjirokastrën. Kërçyen, kënduan sa u tunden themelet e kalasë. Por ama, pastaj përfunduan në spital nga helmimi. Dhe nuk u kuptua, u erdhi nga ndryshimi i klimës, apo ngaqë gjirokastritët nuk hedhin gjë dhe mund t'u kenë dhënë ndonjë lugë çorbe të prishur.

Një televizion dha një kronikë për një mësues invalid, i cili nga drejtor shkollë transferohet mësues 12 km larg shtëpisë. Jo për gjë, por me sa duket testohet aftësitë për ndonjë rekord Gines.

Kryeministri vizitoi një ferme në Dibër dhe pa me sytë e tij se çfarë bëjnë njerëzit punëtorë me pak ndihmë nga shteti. Dhe mediat iu sulën fermerit të ngratë, gjysma e quajtën tradhtar e gjysma servil. Në fakt, çudia është se kur tradhton Meta, Ndoka dhe Idrizi me shokë, nuk quhen tradhtarë, por aleatë...

Dhe në fund, ky muaj ka qenë muaji i qytetarëve të nderit. Komunat, bashkitë, këshillat e kanë hapur thesin me tituj, sa më e vështirë ka qenë të gjeshe salla për ceremonitë se sa kandidatë për qytetarë nderi. Madje, në vend të katundit kemi zgjedhur Tiranën, që të mos jenë vetëm qytetarë nderi, por kryeqytetar nderi.

Fjalë arabe që qarkullojnë në të folurën e Dibrës

Nga SULEJMAN TOMÇINI

Ashu si në mbarë gjuhën shqipe, edhe në të folurën e Dibrës përdoren shumë fjalë arabe, që kanë hyrë nëpërmjet turqishtes. Disa prej tyre ruajnë kuptimin dhe domethënien e tyre origjinale, ndërsa disa të tjera janë transformuar. Këto transformime mund ta kete bere gjuha turke, nga e cila erdhën tek ne, ose edhe vete gjuha shqipe gjate viteve. Unë nuk e njoh gjuhën turke, që të mund të japë ndonjë mendim të specializuar për përdorimin dhe kuptimin e këtyre fjalëve në këtë gjuhë. Por po mjaftohem duke i rënditur një pjesë të madhe të tyre, se mund të ketë edhe të tjera, duke dhënë kuptimin e tyre në gjuhën arabe. Ndërkohë mund të ketë edhe ndonjë fjalë shqipe që rastësisht ngjason me atë arabe, gjë që mund të sqarohet nga studime të mëtejshme nga specialistët e fushës.

Them se disa prej këtyre fjalëve mund të ishin zëvendësuar me kohë me fjalë të shqipes, disa të tjera tashmë janë rrenjosur dhe janë bërë pjesë e fondit të saj leksikor. Megjithatë, me pakë përpjekje, shumica e tyre mund të zëvendësohen me fjalë shqipe.

* * *

(Vijon nga numri i kaluar)

Kasap - ai që therr-thertor, prej ketu kasap + hane - therrtore
Kashtë - kashtë; bimësi e tharë

Kast - qellim

Katil - vrases

Katran - rrëshirë; bitum nafte

Katrion - lloj bime

Kaull - fjalë, shprehje; thënie; mendim; Prej ketu: A e vemë me kaull? - A lidhemi për fjalë?

Kaza - njësi administrative; provincë;

Kazan - ujëmbledhës; rezervuar

Kebab - mish i pjekur në zjarr

Këmishë - këmishë

Këna - një lloj lulëje që përdoret për të lyer flokët, gishtat etj.

Këst - pjesë

Kibla - 1. ana nga drejtohen muslimanët kur falen; 2. qëllim, synim; objekt

Kijamet - ringjallje; Dita e Kijametit - Dita e ringjalljes

Kimash - copë robe, tekstile

Kimet - 1. vlerë; 2. çmim

Kismet - fat, pjesë

Kllëf - zarf; kapak; mbulesë; lëvozhgë, lëkurë; kopertinë

Kub - (kaab) kub - masë për matjen e volumeve

Kube - kupa e qiellit, kube xhamie, etj.

Kumar - bixhoz.

Kumri - guguçe

Kupë - gotë pa dorezë

Kuprane - rrobë e sipërme deri në mes të trupit

Kuran - lexim; fet. Kurani - libri i shenjtë i muslimanëve

Kurban - theror,

Kusur - (shum.) tepricë; pjesë; njësi; te vogla, te thyera

Kusur - 1. pamjaftueshmëri; paaftësi; pamundësi, dështim; mjek. insuficjens; 2. e metë, neglizhencë; 3. papërsosmëri; jo i përkryer

Kuvet - forcë, fuqi, energji

Lafitur - i marrë

Laik - që ka hije, që shkon; që përshtatet; i denjë

Lanet - mallkim, nëmë

Lazëm - domosdoshmëri, nevojë

Lejlek - zog këmbëgjatë shtegëtar

Lepe - urdhëro

Leqim - por

Lezet - shije. Prej këtu edhe fjala i lezetshëm që do të thotë i shijshëm

Llagap - mbiemer, epitet

Llakllak - thashetheme

Llokme - kafshatë

Madem - mineral

Magazinë - depo mallrash

Magje - pajisje, ku zihet brumi i bukës

Magrib - perëndim

Mahije - thelb, esencë; natyrë, karakt

Mahmur - i dehur, i pirë

Mahsul - prodhim bujqësor

Majmun - babun

Makam - muz. tonalitet, harmoni; tast

Mall - para, pasuri, kapital

Malukat - (makhlukat) krijesa

Mana - (maane) domethënie, kuptim

Mangall - mbajtëse prushi

Maraz - sëmundje

Marhaba - hapësirë, gjërësi. Përdoret si përsëritje në kuptimin me krahë hapur

Marifet - (maarifa) dije, njohje

Mashallah - (me-shee-allah) sa mire! sa bukur!

Mashrik - lindje

Mashtrapë - gotë për pirjen e ujit etj.

Mastare - vizore

Matare - calik uji

Maune - ndihmë

Mavi - ngjyre uji, ujqor

Mazllum - i nëpërkëmbur; viktimë padrejtësie, i shtypur

Mazun - i merzitur, i mvejtur.

Medrese - shkollë

Mëhallë - lagje

Mejdan - shesh

Mekam - çelës nuzikor

Melaçe - ëngjëll

Melhem - (nga fjalë arabe merhem) pomadë per plagë.

Memqym - mundësi

Mera - kullotë

Merham - pomadë

(Vijon numrin e ardhshëm)

Më datën 2 maj 2015, në mjediset e Hotel Tirana Internacional, mes familjarëve, miqve dhe shokëve, u përkujtua Prof. Dr. Nuri Abdiu.

Pas një viti...

Më datën 2 maj 2015, në mjediset e Hotel Tirana Internacional, mes familjarëve, miqve dhe shokëve, u përkujtua Prof. Dr. Nuri Abdiu.

Në këtë përkujtimore, u shfaq dokumentari "Krenar për ty", kushtuar figurës së Prof. Nuri Abdiut, i cili, një vit më parë, më 27 prill 2014, u nda nga kjo jetë. Dokumentari me skenar e regji të gazetarit të televizionit Shqiptar (RTSH) Defrim Methasani la mbresa të pashlyeshme tek të gjithë të pranishmit. Në dokumentar, shumë miq, kolegë dhe familjarë të profesorit, folën për jetën e tij, veprimtarinë shkencore e pedagogjike, duke përjetësuar kështu profesorin e nderuar.

Këshilli Bashkiak i Peshkopisë, në mënyrë unanime i ka dhënë titullin "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) me motivacionin "Për kontribut të shquar në zhillimin e shkencave psikologjike dhe pedagogjike, të çështjeve të arsimit kombëtar si dhe konsolidimin e brezave të rinj me dije e kulturë bashkëkohore, kontribut me të cilin ka nderuar dhe lartësuar emrin e Dibrës".

Po me të njëjtin titull u nderua edhe nga Këshilli i Qarkut Dibrë.

Nga kjo përkujtimore, ku si rrallëherë ishte mbushur salla në Hotel Tirana, po shkëpusim për lexuesit fjalën e Dr. Laurand Bica dhe vajzës së profesorit, Ardita Abdiu.



Foto: © Fehmi Lleshi

Krenar për ty!

Nga **ARDITA NURI ABDIU**

Jam e nderuar që sot do të flas në emër të nënës dhe motrës time; dhe familjes tonë, Jam e nderuar dhe po aq ndjem e prekur në këto momente, që do flas për tim atë, Nuri ABDIU.

Bukuria shpirtërore, pasioni, integriteti, besnikëria, forca e madhe e shpirti të qetë, gjeneroziteti, pozitiviteti, ndershmëria, intelektualizmi, humanizmi dhe modestia njerëzore janë tiparet që konfiguruan profilin e personalitetit të babait tonë.

Dibra, Shkodra, Tirana, Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova njohën mikun, mësonjësin, intelektualin, humanitarin dhe zemrën e madhe të një njeriu aq sa të thjeshtë, por të pasur me virtyte dhe tiparet e një ekselence të rallë: dhe të gjitha këto i kishte për të na ofruar.

Dhe kur një njeri i tillë lë gjurmët e një kolosi si Mësues i Popullit dhe njeriu i punës shkencore, gjithashtu: si familjar, bashkëshort, baba dhe si gjysh është vetëm nder, krenari, privilegj dhe dhuratë e çmuar e jetës e ta kesh "Atë", një Atë të shenjtë për ne.

Çdo njeri nga ju këtu ka pasur një lidhje dhe e ka njohur Nuri Abdiun në rrethana të ndryshme e specifike në jetë. Nuk mund të them që të gjithë ne njohën babain tim në formën, thellësinë dhe masën emocionale që e njohëm ne, si anëtarët e familjes dhe folesë që ai vetë krijoi, dhe aq më tepër si fëmijët e tij.

Në çdo periudhë kohore dhe në gjithë etapat që njeriu kalon në jetë, të kesh një baba të mirë, një shok, një udhërrëfyes, një njeri me vlera dhe karakter është fat; është në të vërtetë një dhuratë e jetës.

Një ndjenjë e tillë ekzistonte që kur ishim fëmijë të vegjël dhe konfirmohej ndërmjet episodeve dhe momenteve nga më të thjeshtat deri te ditët më të rëndësishme në jetën tonë:

- Kur mësuam të ecnim dhe të ishim të

sigurta në hedhjen e hapave të parë vetëm duke parë sytë e qeshur që jepnin kurajën dhe sigurinë "që të mban babi, nëse rrezohesh";

- Kur këndonim këngën e Ema Qazimit "Zemër zjarrta moj" e duke kërcyer në krahët e tij;

- Kur mësuam biçikletën dhe që ekuilibri në biçikletë, si edhe në jetë, lidhej me kushtin që të ecësh para dhe drejt;

- Kur mësuam për herë të parë që gënjeshtro i ka këmbët e shkurtra;

- Kur mësuam se e vetmja rrugë në jetë është rruga e Dijes;

- Kur mësuam që gjuha e bukur Shqipe duhet të shkruhet bukur e të lexohet qartë, nëse duam që njerëzit të na kuptojnë dhe të na dëgjojnë;

- Kur mësuam notin dhe vlerësoheshim me nota mbi aftësinë dhe guximin që tregonim;

- Kur temperamentit i moshës luftonte dhe i kundërvihej ndonjëherë normave dhe rregullave të shoqërisë;

- Kur vajzat (fëmijët) ishin të vetmet prince-sha në jetë, por në shoqëri ishin si gjithë të tjerët;

- Kur mësuam për herë të parë dhe në vazhdim që origjina e familjes dhe rrënjët e saj, janë ato që njeriu është sot;

- Kur dashuria prindërore, vëllazërore e të gjithë rrethit familjar e shoqëror trajtohej si pjesë të jetës sonë, e integruar në jetën tonë të përditshme;

- Kur edhe pse larg, dhe në moshë madhore telefonatat e çdo darke shërbenin si përm-bushja e nevojës shpirtërore për të dëgjuar mendimin e babit për çdo vendim-marrje në jetën tonë;

Kur ike, na le një boshllëk. Telefoni na duket ndryshe, shtëpia shumë e madhe dhe bosh, li-brat janë statik dhe radioja në të njëjtin stacion. Sa herë dhe në sub-konshiençë harrojmë që nuk je më këtu. Papritur, kur telefonoj pres në mënyrë automatike që telefoni të përgjigjet nga ai zë i lumtur që shprehte gëzimin për të dëgjuar zërin dhe që shpërthente: Alo Backo!

Vlerat e babit ishin një shkollë e veçantë për ne. E madhe ishte hapësira dhe ndoshta e pafundme, por ndihemi të diplomuar nga shkolla e vlerave të një prindi të tillë dhe trashëgimisë që injektoi te ne:

- Njeriu që luftoi në jetë dhe e arriti atë, edhe pse vinte nga një familje e thjeshtë, por e madhe në vlera të kultivuara dhe të trashëguara në breza;

- Njeriu që mbijetoi sisteme shkollimi dhe punësimi, ku sfida ishte e përditshme, ku karakteri, forca e shpirti dhe intelektualia, shoqëruar nga diplomacia popullore ishin baza për arritje;

- Njeriu që shokët e fëmijërisë, të rinisë, të pleqërisë, kolegët, ish-studentet dhe studentët që pati pranë deri ditën e fundit nuk i humbi asnjëherë;

- Dibrani që ishte sa krenar për gjenezën e tij (fshatin, qytetin dhe rrethin nga vinte). Njeriu që edhe për qytetin ku ai u "rrit" në vlera qytetare e shkencore, aq sa Shkodrën e quante si vendlindjen e tij të dytë;

- Bashkëshorti që pati fatin të kishte një grua si mami, por që fati nuk qëndron i vetëm nëse dy shtyllat nuk janë të forta: të kalosh gjysmë shekulli në jetë familjare sot është një sfidë, për prindërit e mi ishte një vlerë dhe virtyt i përbashkët e i tyre, një dashuri "binjake";

Jam krenare, si unë dhe motra ime, që sot e kësaj dite dhe deri në ditën tona të fundit të jetës sonë do themi: Jemi bijat e Nuri Abdiut. Fëmijët tanë do të jenë krenarë e do të shohin gjithmonë lart në qiell bashke me ne, që gjyshi është lart dhe është prap me ne. Jemi me fat që një pasuri shpirtërore, me vlera dhe kujtime që kanë lënë shenja në jetën tonë, janë trashëgimia e vetme dhe delikatesa që la një At i tillë.

Për një gjë jemi të lumtura dhe themi që: babi dhuroi aq shumë në jetë sa dashuria, mirënjohja dhe dhuratat e jetës që u munduam ti bënim në çdo etapë të jetës së tij (si ne, familja, mbesat dhe gjithë shoqëria) e bënë të largohej me zemrën plot dhe si një burrë i lumtur që jetoi jetën, ashtu siç e dëshironte dhe për të cilën investuan të gjithë.

■ Në çdo periudhë kohore dhe në gjithë etapat që njeriu kalon në jetë, të kesh një baba të mirë, një shok, një udhërrëfyes, një njeri me vlera dhe karakter është fat; është në të vërtetë një dhuratë e jetës.

■ Jam krenare, si unë dhe motra ime, që sot e kësaj dite dhe deri në ditën tona të fundit të jetës sonë do themi: Jemi bijat e Nuri Abdiut.

■ Jemi me fat që një pasuri shpirtërore, me vlera dhe kujtime që kanë lënë shenja në jetën tonë, janë trashëgimia e vetme dhe delikatesa që la një At i tillë.

Nga Dr. LAURANT BICA

Për mikun tim të shtrenjtë, Nuri Abdiu, fjalët nuk shterojnë kurrë se ato burojnë nga zemra. Ai mbetet i gjallë në kujtesën time. Atë gjithmonë kam për ta sjellë ndërmend me respekt e dashuri si një:

- **Pedagog të përkushtuar.** Në karrierën e vet akademike ai mori titullin "Profesor Doktor", ndërsa si vlerësim në aspektin shtetëror ai u bë "Mësues i Popullit", fryt i punës së tij të palodhur në fushën e arsimit. Nxori nga duart e veta me mijëra studentë, të cilët u inkuadruan në armatën e mësuesve, brenda e jashtë Shqipërisë në trojet etnike.

- **Drejtues i aftë, veprimtar shoqëror i shquar, organizator i zot.** Asnjëherë s'e kish menduar kur përfundoi Institutin Pedagogjik pranë Universitetit "Lomonosov" të Moskës, në ish Bashkimin Sovjetik, se një ditë edhe ai vetë do të punonte në një institut të tillë të lartë në Shqipëri, në Shkodër e do të ishte një nga drejtuesit kryesorë të tij, në mos faktikisht më kryesori. Me kalimin e dekadave, ai institut u shndërrua në Universitetin "Luigj Gurakuqi". Në vitin 2002 vizitoi bashkë me të shoqen, Fitneten, Institutin Pedagogjik në Moskë, ku kish ndjekur për 4 vjet studimet e larta. Studentët e pedagogët kolegë, me të cilët punoi në Shkodër e kujtojnë edhe sot me respekt.

- **Psikologu shkencëtar,** i njohur ndërkom-bëtarisht jo vetëm brenda Shqipërisë e në trojet etnike, por edhe në Ballkan, Europë e më gjerë.

- **Në fushën e tekstologjisë,** bashkautor për 7 tekste të psikologjisë të nivelit universitar e pasuniversitar, midis tyre e një manual i psikologjisë së personalitetit.

- **Personalitet i psikologjisë,** Prof. Dr. Nuri Abdiu ka qenë nënkryetar i Shoqatës së Psikologëve Shqiptarë, anëtar i redaksisë së revistës "European Psychology" me qendër në Hamburg. Ai ka qenë pjesëmarrës në Kongresin e VI të Psikologjisë në Romë. Kumtesat e tij janë dëgjuar nga Stokholmi në Suedi deri në Montreal të Kanadasë. Figura e tij lartësohet me dinjitet në krah të personaliteteve, të tilla si Bedri Dedja, Hamit Begua, Pajazit Nushi, Musa Kraja etj.

- **Një nga themeluesit e mendimit psikologjik shqiptar.** Në veprën e tij "Mbi historinë e mendimit psikologjik shqiptar", që e mbrojti si disertacion të doktoratës, ai zë një vend të nderuar në historinë e këtij mendimi. Në veprën tjetër "Psikologjia e Hasan Tahsin" ai dha një ndihmesë të mëtejshme, duke u ngjitur në lartësi të re, sidomos në studimin e mendimit shqiptar të Rilindjes sonë Kombëtare.

- **Diplomat i viteve 50-të.** Në fillim të viteve '50-të të shekullit '20-të për një vit Nuri Abdiu punoi si referent konsullor në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Ndërsa nga fundi i viteve '50-të, kur ishte me studime në ish – Bashkimin Sovjetik, ai punoi pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të këtij vendi si përkthyes në shoqërim të delegacioneve që vinin nga Shqipëria si në Moskë, Leningrad etj. Gjithashtu, mbante lidhje të ngushta me ambasadorë shqiptarë në Moskë.

- **Atdhetari vizionar.** Për gati një dekadë Prof. Dr. Nuri Abdiu dha mësim në Universitetin e Tetovës, si dhe në Prishtinë etj., si lektor i Psikologjisë, duke përgatitur kuadro edhe në trojet etnike.

- **Kryetari i Shoqatës së Lidhjes së Intelektualëve Dibranë.** Në krye të saj ai organizoi sesione shkencore për Dibrën e dibranët, duke i bërë të njohur gjithandë.

- **Figurë proteike.** Tërë jetën e tij 85 vjeçare ai ka ecur duke qenë në krye, pra ose i pari, ose ndër të parët. Kështu në shkollë, në studimet e larta në punë, në veprimtarinë mësimore e shkencore e në tërë jetën e tij, ai ka qenë në pararojë gjithmonë. Kish stofin e një akademiku e dituraku, e një përhapësi të dijeve shkencore e enciklopedike, me të rejtat më të fundit...

NJERIU, HUMANIST

Tërë jetën është dhe mbeti deri në fund një njeri me NJ-ë të madhe. Tipari kryesor i tij ishte humanizmi. Nga kontaktet personale me të më kanë mbetur në kujtesë.

- **Mirësia e tij.** Sapo kisha ardhur nga emigracioni dhe për po kërkoja punë edhe në Universitetin UFO. Ai pa më njohur, u interesua me dokumentet e mia, që të filloja sa më parë,

E rëndësishme është se botohet "Kolana e veprave të Prof. Dr. Nuri Abdiut", i cili ka bërë një punë pionieri sidomos në fushën e Psikologjisë me vlera për të sotmen, por sidomos për të ardhmen.

Profili i një personaliteti



Foto: © Fehmi Lleshi

Fisnikëria Prof Nuri Abdiut shprehej në mendimet e veprimet e tij, manifestohej në sjelljen e tij, i buronte, si të thuash nga shpirti, nga geni. Ai kudo që të ish e me këdo që të bisedonte të impononte respekt.

si pedagog i jashtëm. Në fakt "njiheshim" prej 40 vjetësh. Në një artikull shkencor timin për Hasan Tahsinin, midis të tjerave, i kushtoja një paragraf të tërë punës studimore të profesor Abdiut. Këtë gjë e çmonte shumë se ishte nderuar para kolegëve. Ndërsa unë e konsideroja një "mbarësi", që një studiues serioz si Nuri Abdiu merrej me Hoxha Tahsimin. Ishte fat për ne dhe fat për këtë rilindas, në krahasim me të tjerët që janë marrë me hulumtime në këtë drejtim.

- **Thjeshtësia e tij.** Në pashëniën e librit "Psikologjia e Hasan Tahsin" të profesor, Nuriut unë flisja realisht për të e punën e tij. Ai nuk donte. Ai më kërkoi ta redaktoja, se kishte hall se mos dukej si tepri se flisja mirë për të. Në fakt unë nuk bëja gjë tjetër, veçse pohoja të vërtetat e jetës së tij.

- **U ndodhej njerëzve në vështirësi.** I thashë njëherë se mund ta sillte rasti të jepja "Psikologji". Më dha librat për Historinë e Psikologjisë, madje edhe leksionet e tij të shkruara me atë kaligrafinë e tij të bukur, t'i kisha në qoftë se do ta jepja si lëndë. Dhe ajo ditë erdhi sot. Po jap dy lëndë psikologjie dhe e kujtoj sa herë jap mësim. Edhe një ndodhi tjetër. Kërkoja një libër të një profesori shqiptar të Shkupit, Sejfedin Sulejmanit, për Historinë e Filozofisë Shqiptare në Bibliotekën Kombëtare. Me gjithë përpjekjet e mia s'ma jepnin se ishte i ndaluar, rezervat, bile në arkivin e bibliotekës. Pa ditur gjë, Profesor Nuriu, në një vizitë që bëra në shtëpinë e tij, ma dha si dhuratë, ashtu thjesht këtë libër...

- **Ishte i komunikueshëm me njerëzit,** e kish këtë aftësi, bile dinte të dëgjonte këdo pa dallim.

- **Fisnikëria e tij.** Ajo shprehej në mendimet

e veprimet e tij, manifestohej në sjelljen e tij, i buronte, si të thuash nga shpirti, nga geni. Ai kudo që të ish e me këdo që të bisedonte të impononte respekt. Në një nga sesionet e shumta shkencore që organizonte profesori, mbajta një kumtesë për "Fisnikërinë dibrane". Gjatë hartimit të saj kisha parasysh, më dilte përpara profesori i nderuar Nuri Abdiu, i cili ishte një mishërim tipik i saj.

PËRJETËSIMI I JETËS E VEPRËS

Tani që profesorin Nuri Abdiu nuk e kemi midis nesh, duhet të përjetësojmë figurën e tij që ai me një mënyrë ose një tjetër të jetë prapë midis nesh.

- Dokumentarin e bërë me dashuri e profesionalizëm nga gazetari i Televizionit Shqiptar, Defrim Methasani unë do ta konsideroja vetëm një hap të parë. Mësuesi i Popullit Nuri Abdiu e meriton të përjetësohet në një bust. Emri i tij t'u jepet shkollave, rrugëve apo shesheve etj., sidomos në Peshkopi, Shkodër e Tiranë, ku ai punoi e veprroi, ku kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij. Në këtë drejtim përgjegjësi tash e tutje ka Shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë, të cilën profesor Nuriu e themeloi bashkë me të tjerë dhe e kryesoi deri ditën që u nda nga kjo jetë.

- Kjo Shoqatë duhet të propozojë dekorimin e tij nga Presidenca post mortum me: "Nderi i Kombit", "Mjeshtër i Madh" apo "Naim Frashëri i Artë" dhe të përpiqet për realizimin e tyre, diçka që i ndjeri Prof. Dr. Nuri Abdiu e ka merituar prej kohe.

- Më tej krijimi i Çmimit të përvitshëm, "Nuri Abdiu", nga Shoqata e Intelektualëve Dibranë për fusha të ndryshme nga Psikologji-Pedagogjia e deri tek Letërsia apo vepra më e mirë për Dibrën apo nga krijuesit dibranë.

- Shënime shkencore herë pas here për Prof. Dr. Nuri Abdiu, ashtu siç organizoi ai sa që gjallë për figurat e Dibrës. Këto do të bëjnë që një personalitet si Prof. Dr. Nuri Abdiu të bëhet i njohur e kujtimi i tij të ruhet duhet gjatë, jo vetëm tek brezi ynë, por dhe me brezat që do të vijjnë.

- Së fundi, e rëndësishme është se botohet "Kolana e veprave të Prof. Dr. Nuri Abdiut", i cili ka bërë një punë pionieri sidomos në fushën e Psikologjisë me vlera për të sotmen, por sidomos për të ardhmen. Se sa e rëndësishme është dalja e saj në dritë e plotë, po ju përmend një rast. Një pedagog mbronte një

disertacion për gradë shkencore në Oksford, Angli. Drejtuesit e temës i kërkuan që të pasqyronte veç të tjerash edhe ndihmesën shqiptare në lëmin e Psikologjisë. Ai duke mos ditur gjë për këtë, rastësisht më tha mua: "S'di ç'të bëj, jam në pozitë të vështirë për pjesën shqiptare". "Fare kollaj, - i thashë. - Kemi njëshin për këtë problem dhe e njoha me Profesor Nuriun, i cili e ndihmoi bujarisht me studimet e tij". S'di ç'u bë më tej, por pedagogu në fjalë drejton sot Departamentin e Psikologjisë në një nga universitetet tanë në Shqipëri...

Sipas meje duhet të shohin dritën e botimit veç të veprave të botuara nga Shtëpia botuese "UFO Press", si: 1) "Mbi historinë e Mendimit Psikologjik Shqiptar", 2) "Psikologjia e Hasan Tahsin", 3) "Bibliografia e Punimeve Shqiptare në fushën e Psikologjisë" edhe 7 vepra të tjera, pra gjithsej kolona e plotë me 10 vepra.

Vepra e 4, Artikuj shkencorë për rilindësit (rreth dhjetë prej tyre) si: Hasan Tahsin, Pashko Vasa, Pjetër Bogdani etj., (Ndihmesa e tyre në planin psikologjik). Vepra 5, Artikuj shkencorë për mendimin psikologjik shqiptar, kushtuar disa personaliteteve të periudhës së Pavarësisë me në krye Aleksandër Xhursanin.

Vepra 6, Artikuj e studime shkencore mbi psikologjinë në tërësi.

Vepra 7, Disertacioni i mbrojtur në ish Bashkimin Sovjetik, kur kreu studimet në fushën e psikologjisë.

Vepra 8, Të tjera jashtë fushës së psikologjisë, si në lëmin e pedagogjisë, artikuj shkencorë, gazetareskë, kumtesa në sesione shkencore të ndryshme, studime e artikuj për Dibrën e Dibranët e materiale të tjera, që ruhen në arkivin familjar apo të botuara në shtypin e përditshëm e periodik.

Vepra 9, Bibliografi e punimeve të Nuri Abdiut e mbi të ç'kanë shkruar të tjerët si dhe artikujt e shkruar për figurën e tij dhe kujtime për të.

Vepra 10, Monografi për Prof. Dr. Nuri Abdiu, të cilën e ka ndërtuar prej kohësh.

Kur u nda prej nesh Profesor Nuriu, në shenjë respekti për vdekjen e tij s'që problem për mua të bëja një shkrim për të. Por jo, m'u deshën rreth dy muaj t'i limoj, t'i latoj e t'i gdhend fjalët e të bëj një shkrim meritore për këtë burrë, fisnik të Dibrës, Shkodrës, Tiranës e mbarë Shqipërisë e Shqiptarisë.

Mendoj se duke qenë "Mësues i Popullit" organizime të tilla si kjo për një vjetorin të bëhen nga organe të tilla shkencore, si Ministria e Arsimit apo e Kulturës në të ardhmen...

Zall-Dardha nderon birin e saj, Selim Pirën

Nga DHIMITËR SHTËMBARI

Më 23 maj 2015 në Klubin "Veterani" të kryeqytetit u organizua një veprimtari e një lloji të veçantë: mysafirë të ardhur nga Peshkopia dhe nga komuna e Zall - Dardhës të rrethit të Dibrës vinin këtu për të dekoruar 89 vjeçarën e nderuar, birin e respektuar të Dardhës, veteranin e palodhur të LANÇ, Selim Pira.

Në sallën e këtij klubi erdhën për të marrë pjesë në gëzimin që do t'i dhurohej Selimit pjesëtarë të familjes, veteranë e invalidë të LANÇ dhe pasardhës të tyre, ish oficerë në pension e të liruar, shokë e miq, si dhe të ftuar të tjerë.

Ndodheshin, gjithashtu, kryetari i Komitetit Kombëtar të Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Popullit Shqiptar, Rustem Peçi, kryekëshilltari pranë Kryesisë së këtij Komiteti - Kundëradmiral Ziqiri Mero, ish komandanti i Flotës Luftarake Detare, Skënder Doçi dhe të tjerë.

Ceremonia ishte konceptuar si një veprimtari kulturore. Fabulisti i mirënjohur, Kastriot Hadëri, krijoi dhe mbajti deri në fund të kësaj ceremonie një atmosferë të ngritur entuziazmi falë edhe vargjeve të goditura humoristike, me të cilat "çukiste" dhe ftonte folës të ndryshëm që t'i bëheshin pjesëmarrës aktivë kësaj ceremonie vërtet mbresëlënëse.

Fëmijës i duhen dy apo tre vjet që të mësojë të flasë, thotë një i mençur, ndërsa i rrituri duhet të mësojë tërë jetën për të vendosur se kur duhet folur. E pamë një gjë të tillë edhe gjatë kësaj ceremonie vërtet mbresëlënëse.

"Nderimi që po i bëhet sot Selim Pirës, tha Hilmi Cani, kryetari i komitetit të veteranëve të LANÇ të rrethit të Dibrës, është ndërkohë vlerësim e nderim edhe për tërë veteranët e tjerë të Luftës të rrethit të Dibrës. Selim Pira është një figurë e pastër, e skalitur gjatë luftës për çlirim, gjatë periudhës së pasçlirimit, por edhe gjatë tërë periudhës së pasdaljes në pension".

"Nderi që po i bëhet sot shokut tonë, Selim Pira, - tha Skënder Doçi, - është një shpërblim i merituar moral që i bëhet këtij ish kuadri të devotshëm të Ushtrisë sonë".

Liljana Naçi, mbesa e Heroit të Popullit, Mihal Duri, u shpreh se Selim Pira, edhe pse i moshuar, vazhdon të kontribuojë si të jetë i ri. Ai na e sjell lavdinë e së djeshmes jo thjesht me fjalë, jo vetëm me veprime atdhetare, por edhe me libra të botuara, si dhe me gjithçka tjetër.

"E njoh që në ditë e para të pasçlirimit, iu drejtua të pranishmëve Sevo Tarifa. - E njoh sikundër është tani: të qartë në mendime, të shkathhtë në veprime dhe fisnik në qëndrime. Komuna e Zall - Dardhës po nderon një bir të



mrekullueshëm të saj, duke kryer kështu një veprim vërtet atdhetar. Zonja Donika Hyseni, duke folur në emër të Prefekturës së rrethit të Dibrës, tha se "kur na erdhi dokumenti për miratim në Prefekturë, nuk menduam dy herë. Menjëherë vendosëm firmën dhe vulën në dokument. Figura të tilla, si e kjo e Selim Pirës i bëjnë nder jo vetëm fshatit e komunës, por edhe tërë rrethit të Dibrës e më gjerë.

Në vazhdim e mori fjalën kryetari i Komitetit Kombëtar të Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Popullit Shqiptar, shoku Rustem Peçi. Sa mirë do të qe sikur ta kishim pas mësuar që në fillim motivacionin e stimulit moral që do t'i dorëzohet shokut Selim, - u shpreh shoku Rustem, - sepse kështu do të mund të ndërtonim një fjalë më të goditur përshëndetëse! Sigurisht, ishte një humor që vuri disi në siklet drejtuesin e veprimtarisë, por që edhe ky i fundit e kaloi po me humor, duke thënë, se, në mungesë të kritikës letrare, një ndërhyrje e tillë merr vlera për t'u çmuar. Në vazhdim, shoku

Më lejoni të falënderoj, në radhë të parë komitetin e veteranëve të LANÇ të rrethit të Dibrës për propozimin që i keni bërë komunës së Zall - Dardhës, anëtarët e këshillit të komunës së Zall - Dardhës, që e vlerësuar figurën time, Prefekturën Dibër për vlerësimin si dhe të gjithë pjesëmarrësit e nderuar, që erdhët për të më shtuar gëzimin në këtë ditë të shënuar për mua", tha në përshëndetjen e tij, Selim Pira

Rustem vuri në dukje se "Selimi ka zgjedhur për të ecur në rrugën e ndershme, vetëm drejt dhe kurdoherë lart", tha Rustem Peçi. Le të jetë ky stimul një tjetër vlerësim i merituar që i bëhet këtij veterani të respektuar".

Kryetari i komunës së Zall - Dardhës i dorëzoi Selim Pirës titullin "Nderi i Komunës së Zall - Dardhës". Pak më pas, kryetari i këshillit të komunës tha se "Selim Pira e ka nderuar komunën tonë. Nderi shkon te nderi. Kështu vazhdoftë tërë jetën!"

"Më lejoni të falënderoj, në radhë të parë komitetin e veteranëve të LANÇ të rrethit të Dibrës për propozimin që i keni bërë komunës së Zall - Dardhës, anëtarët e këshillit të komunës së Zall - Dardhës, që e vlerësuar figurën time, Prefekturën Dibër për vlerësimin si dhe të gjithë pjesëmarrësit e nderuar, që erdhët për të më shtuar gëzimin në këtë ditë të shënuar për mua", tha në përshëndetjen e tij, Selim Pira. "Sa të kem frymë, nuk do të pushoj së kontribuuari në shërbim të popullit e të Atdheut".

Xhelil Imeraj

"Nderi i kulturës dibrane"

Më 8 maj, në qytetin e Peshkopisë, u zhvillua ceremonia e dorëzimit të titullit "Nderi i Kulturës Dibrane", kompozitorit, muzikantit, mësuesi dhe drejtuesi i muzikës, Xhelil Imeraj.



Xhelil Imeraj është i njohur jo vetëm si kompozitor, por dhe si drejtues kulture, organizues i veprimtarive kulturore në Dibër, Bulqizë dhe në Tiranë. Në sallën e shfaqjeve të qendra Kulturore Peshkopi, kjo veprimtari u kthye në një spektakël artistik. Të pranishëm ishin qytetarë të shumtë, kolegë, artdashës dhe artist dibran. I pranishëm ishte dhe deputeti i zonës z. Sherefedin Shehu, kandidati për kryetar bashkie z. Shukri Xhelili e tjerë. Në emër të Këshillit Bashkiak, titullin e dorëzoi kryetari i bashkisë Peshkopi z, Ilir Krosi. Mes përshëndetjeve dhe urimeve më të bukura e të larmishme e bënë këngëtarët Qerim Sula, Sherif Dervishi, Myfterim Kupa, Agim Skarra etj.

Hysen Dervishi

"Nderi i kulturës dibrane"



Bashkia e qytetit Peshkopi në bashkëpunim me Qendrën Kulturore dhe me familjen Dervishi organizuan në sallën "Teuta" të hotel Tirana, ceremoninë e dhënies së titullit "Nderi i Kulturës Dibrane" z, Hysen Dervishi.

Hysen Dervishi regjisor, interpretuesi, krijuesi dhe drejtues i institucioneve kulturore veçanërisht në qytetin e Bulqizës.

Moderatori dhe gazetari Defrim Methasani këtë ceremoni e ktheu në një spektakël me shume emocione e vlera. Pas shfaqjes së dokumentarit për jetën e veprimtarinë e Hysenit u këndua këngë për Lam Bruçin, burrin trim e patriot të kësaj zone kënduar nga Dritan Jashari. U fol shumë për Hysenin, muzikanti Kol Susaj, studiuesi Mevlud Buci, artistja e merituar Lirie Rasha, e cila këndoi një potpuri këngësh dibrane.

Kryetari i Bashkisë Peshkopi z. Ilir Krosi i dha titullin "Nderi i Kulturës Dibrane" z. Hysen Dervishi.

I.Dervishi

Përkujtohet 120 vjetori i lindjes së Haki Stërmillit

Nga ISLAM SHAROFI

Me rastin e 120 vjetorit të lindjes së Haki Stërmillit, 7 maj 1895, në Tiranë u organizua një veprimtari shkencore. Veprimtaria u organizua nga shoqata Bashkësia Dibrane, me mbështetjen e AIITC-së dhe nën kujdesin e prof. dr. Arian Kadiu.

Në programin e aktivitetit të simpoziumit morën pjesë akademikë, profesorë dhe dibranë antarë të kësaj shoqate.

Në fjalën e tij prof. dr. Arian Kadiu foli për jetën e veprën e Stërmillit, e cila është shumë dimensionale. Ai nënvizoi se romani "Sikur t'isha djalë" është një vepër shumë e çmuar për letërsinë shqiptare që ka 60 vjet që lexohet me shumë dëshirë nga lexuesit e moshave të ndryshme. Madje ai e quajti "best-seller" sepse vepra është shumë e kërkuar dhe pati shumë botime, deri në ditë e sotme. Gjë e cila tregon përveç stilit tërheqës, por edhe për rëndësinë e tematikës që paraqet.

Në mënyrë të veçantë idetë që ka në bazën e vet romani, kanë të bëjnë me atë lëvizje të fuqishme shoqërore, që u ngrit në vitet '30, të shekullit të kaluar, për emancipimin e gruas shqiptare. Në vitet '30, në vitet '50 dhe deri në dhjetëvjeçarën e parë të shek XXI, romani ka njohur mbi 17 ribotime në Tiranë, Prishtinë,



Shkup etj. duke shënuar një rekord në historinë e letrave shqipe. Romani vë gishtin në plagën më të dhimbshme sociale shqiptare se përshkruan tragjizmin e jetës së femrës shqiptare, ku luhej me fatin e saj, ç'ka e shohim të shfaqet përditë edhe sot.

Në simpoziumin e organizuar në mjedisin e Muzeut Historik Kombëtar u paraqitën prof. dr. Gjovalin Shkurtaj, akademik, me temën "Karakteristikat dalluese të romanit "Kalorësit e Skënderbeut", Doc. Beqir Shehu me temën "Karakteristikat e dramave dhe problematika e tyre" si dhe Xhezair Abazi, kritik letrar, me një vështrim tërësor të jetës dhe veprës së Haki Stërmillit. Xhezair Abazi ka shkruar edhe një monografi për Haki Stërmillin, e cila së shpejti do të shohë dritën e botimit.

Në kumtesat e mbajtura u fol për jetën dhe veprën e H. Stërmillit, i cili u rrit dhe u formua në Dibër të Madhe, Manastir dhe Tiranë, si një idealist, si demokrat dhe luftëtar i lirisë dhe i çështjes kombëtare dhe të drejtave njerëzore.

Përveç kumtesave u ndoqën me interes diskutimet e Skënder Sala, ish aktor, këngëtar, regjizor në Pallatin e Kulturës "Haki Stërmilli" në qytetin e Peshkopisë, Faik Xhani, gazetar, Ilir Krosi, kryetar i bashkisë Peshkopi dhe Adivije Alibali - Sharofi, artiste e njohur e skenës dhe ekranit.

Vlerë e shtuar në letërsinë tonë bashkëkohore

Nga MEVLUD BUCI

Pas leximit e rileximit të librit poetik "Pa moshë" i poetit të talentuar Hamdi Hysuka i Matit e ndjeva veten sikur jam midis një livadhi gjelbërishumë me plot lule e me aroma të këndshme.

Për realitet e aspak për nostalgji mu duk dhe sikur isha në një galeri të stërthellë me plot minerale të çmuara e të shëndetshme. Ndërkohë ndjeva në shpirt e zemër të gdhend pak fjalë, të shpreh atë çka diktojnë vargjet e thjeshta, por të madhërishtme, vargjet e shkruara nga një pendë e ngjyer në udhët e jetës e të dijes, nga një pendë që me plot të drejtë mund të quhet "sitë" e mëndafshhtë e kohës, rrezatim i jetës dhe i vlerave njerëzore. E them me zemër në dorë, si i thonë, se lexuesi li sotëm, kur poezitë vërshojnë shumë, si në libra dhe në faqet e shtypit bashkëkohor, gjen rrallë poezi të bukura, të thella, të shkurtëra e mjeshtrorë sa këto të librit "Pa moshë" i poetit Hamdi Hysuka.

Poeti virtuoz dhe studjuesi i nderuar çam, Namik Selmani, bën vërtetë një analizë gjurmëlënëse, mjeshtrorë, por pa dashur t'i futem në hak (veçse ta përgëzoj) mendoj se ia vlen që me dhjetra penda si Namiku në vijimësi të shkruajnë dhe kanë çfarë të shkruajnë për librin poetik "Pa moshë".

-Hamdiu, -shkruan mes të tjerash studjuesi Selmani, -udhëton me poezinë. Është nga ata poetë klasikë e modern që e kupton se, pas një udhëtimit do të ketë një poezi, një cikël. Atë e shohim në këtë vëllim tek këndon me zërin e tij kaq të qartë, të ngrohtë... (faqe 6)

Vargje që janë pasqyrë e dritës, pasqyrë e shpirtit, rrezatim i jetës. Krijime që të ngjallin emocion, që të vënë në meditim, që të thërrasin, të trokasin në mendje e zemër, sikur të rinojnë, sikur të japin forcë, mall, dashuri dhe mprehtësi për të fshikulluar dukuritë negative të jetës.

-Libri "Pa moshë", -vijon shkrimtari Namik Selmani, -e ka një objekt të qartë. Ai është një risi për autorin, po dhe për poezinë në trojet shqipe (faqe 8)

Në fillim autori Hysuka ka gdhendur poezinë hymn "Ti je jeta", në tri strofë (baraz me një triologji) ku jepet ecja, meditimi me vetveten, me zhvillimin, me vrullin e jetës, shprehen plot nocione filozofike, sikur rrezaton dritë shpirti, dritë jete:

*Do të rrotullohet toka
mbi kurriz me të vërteta,
jeta ime për ty folka
pa përmend se ti je jeta... "Ti je jeta", strofa 3, faqe 10*

Poeti Hysuka jeton me kohën, i thërret kohës, bën diagnozën e njeriut, të "udhëkryqit", të atyre që i ruajnë vlerat, që nuk harrojnë, si i thonë:


*Kokës me grushta iu vërsula,
majtas as djathtas nuk më ecet,
nga vetja të keqen e shkula,
po udhëkryqi ende mbetet... "Udhëkryq", strofa 2, faqe 11*

Poeti Hamdi Hysuka të veçantë ka aludimin poetik, mprehtësinë psikologjike dhe thellësinë filozofike të vargut. Herë-herë vargjet ngjajnë me sentenca të thella, të cilat të vënë në mendim, të tërheqin si me magnet për t'i rilexuar, për tu kuptuar "mananë" se ku rreh autori mjeshtror. Vërtetë kur rilexoj vargje si ato të poezisë "Fijet e jetës tjerr", faqe 13, poeti më ngjan me një okulist të rrallë, që shikon realisht thellësitë e bebes së syrit. Poeti ngjan vërtetë me një zgalem nëpër dallgë deti:

*Jeta ime dhe e tjetrit
u trazua, u bë dimër
kudo frone lanë mbretërit,
prapa tyre erdhën princër.*

*Zbrita shkallët e regjimit,
derën ma përplasi shteti,
në kërkim të moderimit
udhëtoj si dallgë deti... "Fijet e jetës tjerr", strofa 2 dhe 3, faqe 13*

Te vargjet e librit "Pa moshë" rrezaton jeta, pasqyrohen dukuri, vese, virtyte, jepet në plotësi shëmtira e kohës. Kjo duket qartazi e bukur te poezia "Antinjerez":



*Kush lakmon Olimpin me Zeus
portën e Ferrit e ka të mjaftë,
dielli më nuk ftohet në minus
dhe as mesdita nuk bëhet natë... Strofa 4,
faqe 14*

Janë vërtetë të shkruara me frymëzim e plot mesazhe jete poezitë "Nuk më ze merak", "S'e kam të lehtë", "Si të bëj", "Është e keqe", "Mars '97" etj. Autori apostrofon me jetën, shfaqet vëzhgues real, mendimtar dhe kritik, bën qartazi vërtetësinë, atë ç'ka koha, ç'ka jeta:

*Ata të ikurit ikën,
të ardhurit nuk kanë ardhur,
duro jetë dhe pak vjet,
më shumë nuk ke pse pret... "Duro o jetë",
faqe 20.*

Lodra, -thotë populli, -bie për atë që ka veshë. Poeti Hysuka është një firmëtar i kohës, firmëtar i demokracisë së vërtetë, jo i ngjyrave e karrierave të pamerituara, një realist dhe kronikan i kohës së re që i thërret kohës, u thërret njerëzve që të rëndin nga mirësia, nga e vërteta, sepse nuk kanë çfarë presin më për ta gëzuar jetën.

Poeti Hysuka e shikon kohën dhe jetën në sy, është konkret, i qartë, human, guximtar dhe i saktë:

*Por s'ka ardhur koha e mjalit,
dimrat vijin me përmbytje,
udhëve drejt pa fund të hapit
ecim përmbi pikëpyetje... "Nuk ka ardhur",
strofa 6, faqe 22.*

Të ngjall plot emocion, ide, urrejtje dhe neveri çnjëzore poezia e goditur "Hyrja në parti", ku poeti në strofën e dytë shkruan:

*Fytyrën mbuloj,
sytë iu mjegulluan,
nuk dha shenja jete,
u kthye në askush... Strofa 2, faqe 27*

Poezi me plot ide, kontraste, peisazhe ku jepen gjurmë jete, gjurmë shpirti e fisnikërie. Autori edhe kritikon me art, demaskon hapur, saktësisht, ku nëpërmjet stigmatizimit dhe sarkazmës fshikullon ekstremizmin njerëzor, i cili është ligësi në kohën tonë:

*Emër pa mbiemër,
mbiemër pa emër,
frut i pa pjekur,
as i gjallë, as i vdekur... "Militanti", faqe 29.*

Libri poetik "Pa moshë" ka në bosht edhe satirën therëse. Autori Hysuka nëpërmjet vargjeve të thjeshta e plot ide, nëpërmjet stilit të tij original, duke pasqyruar me mjeshtri atë ç'ka koha e jeta në realitetin tonë, demaskon ata që marrin votbesimin dhe nuk e kthejnë kokën pas, nuk u skuqet fytyra:

*Te gjendja civile e kohës
gjallë je, aspak i vdekur
vite prapë i shton moshës,
për njeri je "vizë" e hequr. "Kjo nuk është
metamorfozë", strofa 4, faqe 30*

Në poezitë "Aksident", "Para Aristotelit", "Historia nuk bën gjumë", "Ftesë historie",

"Zemërim ujqor", "Ndale rrugën e kurbetit" etj, shpërfaqen dukuri jetësore, ide, të cilat pasqyrojnë gjurmët, mendimet, historinë, ndalimin e dhimbjes, shmangien nga udhët e kurbetit... Nëpërmjet retorikës së gjetur autori Hysuka shpreh dhimbjen, përmallimin, rrezatimin e shpirtit njerëzor:

*Dy djem i humbën në kurbet,
nëna mbet fare pa djalë,
deti detit pse s'i flet,
përse dallga nuk çon fjalë?*

*Vera iku dhe prapë erdhi,
lule shprese nuk ka çelur,
lotët krua nëna derdhi,
qyqë mali, oh, ka mbetur... "Ndale rrugën
e kurbetit", strofa 1 dhe 2, faqe 38*

Poeti Hysuka përshkruan me lirizëm të hollë e nota filozofike Parisin:

*Qytet i barrikadave të komunarëve,
qytet kozmopolit ku më tremb çmimi,
vendlindja e sa e sa mendimtarëve,
prehër arti modern, pellg komercializmi...
"Ëndërr e hershme", strofa 3, faqe 37.*

Vargu i poetit të këtij libri të çmuar e të rrallë në llojin e tij, sikur thërret në ndërgjegjen njerëzore, sikur bën pa mëdyshje më rrezatues të dukurive të jetës, të shpirtit dhe të vetë kohës që jetojmë. Autori bën mjaft bukur diagnozën e politikës, i jep "okën" që i takon, e "portretizon" filozofikisht, realist:

*Çorganizim i organizuar,
çorientim i organizuar,
vetmashttrim me dashje,
përgjegjësi e privilegjuar. "Politika", faqe 39.*

Poeti Hamdi Hysuka është si të thuash sita e mëndafshhtë e politikës. Përmbajnë plot mesazhe për jetën, plot ide vargjet e poezive "Jetëshkurtër", "Deputetëve blerës", "Mitingashi", "Mallkim", "Plagë":

*Nëse blini mandat tjetër,
ta fitoni, mos qoftë thënë
koha juaj është e vjetër,
të çvlerësuar keni qënë... "Deputetëve
blerës", strofa 2, faqe 41.*

Njerëzit fluracë të kohës, ata që u bëjnë flad, si i thonë, politikanëve, llafallogëve tipizohen me saktësi, ku poeti mjeshtror u përcakton edhe fundin e tyre:

*Ndryshe koha, ndryshe ti
tjetër fjala, puna tjetër
mbledhe veten o njeri
sepse mbetesh dhe pa emër... "Mitingashi",
faqe 42.*

Poezitet e librit "Pa moshë" sikur u ngjajnë stinëve të vitit, sepse në "to gjen larmi ngjyrash, ku portretizohet jeta, traditat, vendet historike, figurat e ndritura, portreti i lypësit, Kosova, gjakova, Voloreka, kënga labe, vendlindja e shtrenjtë (Shëlliu i Matit) e plot të tjera. Me tërë bukuritë të shfaqet njeriu, vlera, shpirti misionar e vizionar, jeta, pesha e fjalës dhe vlerat e saj, ku poeti Hamdi Hysuka na i jep të çdo poezi, veçanërisht te ajo me titull "Pa moshë", nga ku me të drejtë merr titullin vetë librin. Në secilin varg ndjen peshën e të qenit njeri, peshën e dijes e të përballimit të jetës, bukurinë dhe madhësinë e lirisë:

*Si krejt të tjerët jam i lirë,
nuk më bllokton aspak karriera,
midis jush o njerëz të mirë
hyj e dal si vetë pranvera... "Pa moshë",
strofa 2, faqe 63.*

E them me zemër në dorë se nuk do të mjaftonin as dhjetra recensa, apo analiza për të pasqyruar sa e si duhet vlerat, bukuritë, mjeshtrinë poetike e stilistike, thellësitë e vargjeve, mesazhet e fisnikërisë, idetë frymëzuese të librit "Pa moshë", vargje që ngjajnë me flladet e kurorës, vargje gjithë blerim shpirti, dallgë dhe prushe malli, vargje të thjeshta me tone të thella filozofike, me lirizëm që buron nga pena e poetit virtuoz Hamdi Hysuka. Libër që pasqyron kohën, traditat, brezat, figurat, libër që godet në shenjë, që lartëson vlera pa dallime ngjyrash, një libër pasqyrë e dritës së shpirtit, monument i jetës dhe brezave të kombit.

Është sa e përmallshme aq dhe monumentale, sa e dashur aq dhe e dhimbshme e krenare poezia (baladë) "S'të flet buza, vargu flet",

të cilën poeti Hysuka ia kushton viganit të poezisë, poetit dhe ushtarakut Hysni Milloshi:

*Më kot pres ashtu pa zë,
nga Tirana nuk vjen më,*

*S'të flet buza, vargu flet
ushtarak edhe poet.*

*Dhe pse ndarja që disfatë
ti sërish je jetëgjatë... (faqe 65)*

Plot elementë të së thjeshtës, të së madhërishtme, të së bukurës e heroikes, plot vlera e rrezatime jete shfaqen në vargjet e poezive të librit "Pa moshë". Poezi të shkurtëra, por me vlera e ide të mëdha, me plot figuracion e mesazhe, të cilat dritësojnë kohën, shpirtin, ngjarjet, traditat, figurat dhe jetën. Secila poezi përmban ngarkesë emocionale, dliresi e frymëzim, secila të bën të meditosh, të vështrosh larg, të ndjesh në shpirt e në zemër vrullin dhe ngjarjet e jetës. Mjaft bukur janë gdhendur edhe vargjet e poezive "Artisti i merituar", kushtuar të talentuarit Ymer Neli nga Macukulli, "Kodi i jetës" kushtuar piktorit Shkëlqim Hysa etj, poezitë plot përmallim "Shoqëri", "Kujtesë", "Vdekja e babait", "Nënës sime".

Në librin poetik "Pa moshë" çdo lexues gjen vetveten si dhe ka si në pëllëmbë të dorës, kohën, enigmat e jetës, bukurinë e shpirtit njerëzor, vëzhgon e vjel vlerat e virtyteve, zbulon dhe urren mediokritetin e veseve, të cilat sot struken nën petkun qeveritar, parlamentar, të politikës e mitingashëve shterpë e të pa bosht njerëzorë. Vargjet skalitin bukur dhe pejsazhe, nxënë dhe shokë, udhëtar, reklamat, grevën e urisë, relike (Ju flet Tirana) apo retorika "kush tha"? Këto janë tituj stigmatizues, të thjeshtë, me vargje plot ide, të cilat jo vetëm të emocionojnë, por dhe të bëjnë të meditosh, të duash apo të urresh, të çojnë tek ajo që ka nevojë më shumë se kurrë shoqëria jonë, te dashuria njerëzore, te fisnikëria dhe mirësia.

* * *

Është domethënëse fakti se libri "Pa moshë" është pa mëdyshje një triologji dashurie njerëzore, monument shpirtëror që na flet me dritën e zotësive, me shpirtin prej intelektualit, arkitekti i vargjeve, të cilat burojnë nga dashuria për diturinë, vendlindjen, prindërit, shokët, trevën matjane, kombëtare e më gjërë.

Te pjesa e tretë "Trëndafil e trëndafilë" sikur librit "Pa moshë" i vihet kurora, i vihet "çatia", sikur i rrezatojnë më fort petalet e dashurisë, petalet e zemrës. Aspak për hiperbolë, por për vërtetësi, poeti Hamdi Hysuka më bukur se rrallëkush përshkruan poetikisht, filozofikisht dashurinë, vërtetë një "Henrik Hajne" i Matit, i kohës dhe i kombit tonë:

*Dashuria është stinë e përjetshme,
nuk ngjajnë me lulet e prillit lulet e saj,
lulet e zemrës nuk janë të përkohshme,
ato a'ka vjeshtë t'i zverdhi,
s'ka dimër t'i thajë... "Dashuria", strofa 2,
faqe 85.*

Me plot vlagë e zjarre dashurie janë edhe poezitë "Të më japësh zjarr", "Dhurata", "Takimi i së djelës", "Çaste lufte", "Më zuri lemza", "Zhdrejtësi", "Asaj që dua", "Pa ty", "Dasëm në fshat", "Mora ngjyren e pranverës", "Ndarje s'ka", "Koha ecën", "Prandaj erdha", "Larg teje", "Mendja ma thotë", "Mesazh", "Urdhër malli" etj. Te secila poezi sikur çelin trëndafilë, glon përmallim, dritësimi i shpirtit. Poeti Hamdi Hysuka, si i thonë, nuk flet me zogj, gjoja në emër të modernizmit. Ai është modern, lirik, mjeshtror i përshkrimit poetik nëpërmjet vargjeve të thjeshta që përbëjnë filozofi, ide, shkulte dashurie, të cilat frymëzojnë dhe e bëjnë të mendojë e të krenohet në shpirt, të ndjejë peshën e kohës lexuesi i çdo moshe. Këtë triologji mjeshtrorë poetike e mbyll poezia "Monolog", faqe 106.

Libri "Pa moshë" i poetit matjan e kombëtar, Hamdi Hysuka, është një vlerë e shtuar në letërsinë tonë bashkëkohore, një model i ri poetiko-filozofik, një buqetë dashurie për brezat, libër i çmuar për rrezatimin e jetës, "diagnozën" e kohës, një libër që pasqyron vlerat e shpirtit e të dashurisë njerëzore. Urime Hamdi Hysuka i Matit e i Arbërisë! Penda dritë në dritën e kohërave të brezëve!

DIBRA IME


Prej s'largu
Prej s'largu ndër vite
Të kundroj me mall
Të kujtoj me zjarr
Prej s'largu
Trokun e djepave dëgjoj
Krismat e pushkëve numëroj
Prej s'largu
Mundin e ngjitjes përcjell
Shkëlqimi e fitoreve tua në balle e ndjej
Sot e mot jam biri yt
Sot e përgjithmonë je amaneti im
Prej s'largu e prej s'brendshmi
Të ndjej Dibra ime

VENDLINDJA IME

Atje mes malesh
Ku retë dimërojnë nëpër stane
E bagëditë blegërinë nëpër bregore
Atje ku krojet gurgullojnë si gjaku
Ku gurët dhe pemët flasin me njerëzit
E njerëzit
ata që këndojnë me vetëtimat
Atje tej ku malli më çon kaluar
Ku shkoj për të mos i thënë kurrë lamtumirë
Atje ku më presin krahëhapur
Njerëzit trualli kujtimet dhe fëmijëria
Atje ku përmalle si askund tjetër në botë
Kthehem me torba malli dhe iki me lot në sy
Atje është vendlindja ime
Atje ka themelet tharmi dhe thinjat e mija
Atje jam zot dhe njeri burrë dhe fëmijë
Atje takohem me të shkuarën e përmallëm
Takohem me fëmijërinë dhe qesh
Atje dhe askund tjetër mbi këtë tokë
jam gjithçka në çdo gjë

NËNËS

Nënë, shenjtërim në emër e në shpirtë
Në zë e në zemër kushtrim etern, je ti
Në sy e në vështrim
Më e magjishmja rreze, prej teje gurron
Brenda vetes botën krejt e ke
Tik-taku i orës dhe zemrës sime, ti je
Krejtçka dëshiroj me gjith shpirtë, je ti
Ishe ti, andaj jam unë, bijat e mia,
Dashuritë e dashurive të mija
Gjaku, mishi dhe vërshimi i jetës në mua, je ti
Nuk njeh moshë ky emër e kjo shenjtëri
Nuk njeh tjetër si prehëri i nënës, jo tjetër mrekulli
Në mish e në shpirt
Në sfidë e në triumf
Në dhimbje e në trishtim
Është prekja e saj
Tafti i magjisë së nënës Zot dhe zotërim
Ka shkëlqimin e diellit
Dritimin jetëdhënës
Breroren e shenjtërim
Krejtçka shndrit është si buzëqeshja e saj
Zemra, oh zemra e nënës
Në gjithçka ajo troket
Po gjithsekund atë e ndjej
Në melodinë e gjetheve që vjeshta rrëzon nga pemët
Mallin e saj e kundroj
Në shkumëzimin e valëve që takohen me bregun
Janë hapat të përmadhshëm
Pritjeve të mija rendin me ngulm
Te avionët që ulen e zogjt që fluturojnë
Bekimin e nënës dëgjoj ndërsa kungon
Në frymën që marr e ajrin që më përkëdhel
Është prekja e saj e ledhatimet si fllad.
Në harenë, gazmendin e begatinë e të sotmes
Po, ajo është ëngjëlli mbrojtës
Ajo është me zemrën dhe dashurinë e nënës
Edhe të ju bijat e mia
Vajzat, drita e syve të mi
Askurrë nuk jemi të vetëm në Robinsonët e fatit
Ne Maratonmakët e fitoreve
Ne Odisetë e ngadhnjimeve drejt Itakave
Në çdo Golgotë e Olimp
Ajo është krejtçka dëshirojmë të kemi
Kurrë s'është vetmi edhe pse është mall
S'është braktisje kurrë edhe pse e kemi larg
Endim në jetë me mundim Penelopash
të pafund pëlhurën e dashurisë
Por jo kurrë aq sa për të mbështjellë
Odiseadën tënde ngadhnyese nënë
Dashurisë e jetës
Qiej të pamatë pushtuam në fluturimet tona
Por kurrë nuk e zotëruam përmasën e pafundësisë



Halil Teodori
"DASHURIA DHEMB"

Botimet ADA
ISBN: 978-9928-193-66-7
Çmimi: 500 lekë



Halil Teodori sapo ka nxjerrë vëllimin poetik "Dashuria dhemb", të botuar nga Shtëpia Botuese "ADA", nën redakimin e poetit Demir Gjergji.

Nga ky vëllim poetik po shkëpusim disa poezi, tematika e të cilave kryesisht është nga vendlindja.

Në numrat e ardhshëm do t'ju përcjellim edhe mendime të kritikës mbi botimet e Halil Teodorit, veçmas poezinë.

Përjetësisht mbetëm fëmijë në prehrin tënd
E ëndrrat tona balona
Fluturaket që na i endë më durim e pasion
Thuaj, një luftë që nuk shkuam
Një arenë ku nuk u përleshëm
Një sfidë që nuk trimfuam, nuk kish
Malli dhe dhëmbja për ty nënë
Çdo ditë pak e nga pak na bluan
Çdo moment na tret grim e nga një grimë
Në emër të Unit tim
Të qënjes që shtatohet në dëshira dhe mundësi
Në emër të jetës
Në emër të trashëgimisë dhe gjakut
Me vdekjen u përleshë dhëmb për dhëmb
Jetën e ngrite me thonj e me djersë
Ditën ma ndrite me diell e me zemër Nënë.
Të djeshmen në rrudhat që të qendisin portretin
Kundroj sot kureshtar
e krenohem me hirin tënd hyjnor
naltësohem në dëborën e thinjave tua.
Të tashmën time shoh në sytë e tu
E shkëlqimi i të nesërmes
më përllan shtegun përnga ardhmëria
në çdo qelizë të kësaj permendoreje suksesi
gurron limfa e amanetit tënd, nënë.
Ti ishe me mua kur unë bëra hapin tim të parë.
Atëherë e sot je me mua
Në çdo hap e ëndërradhë me
më të larin emër dhe mission, nënë
Nënë ti mbush ditet e mija me drite ylberi,
Me ngjyra të hareshme
Ma vizaton panoramën e të përditshmes
Me qiej gazmendi më mbulon mbrëmjet
E natën me yje ma stolis
Ti ikën dhe vjen
magjiplotë si një bekim.
Në gjithçka që shoh e prek
Je ti më i ëmbli shëmbëllim
Më i bekuari kungim, nënë
Ndërsa në mua ndjej burrin tekta kalitet
E bora nga majat më zbret në tëmtha
Hapin me kutin e kohës mat
Një gufim më sëmbon nga brenda
Një kushtrim më çel syth në ball
E bëzaj me sa zë ka brenda
Faleminderit për të gjitha nënë
Është borxh që shlyer duhet
Është një amanet,
që të ardhmen tonë skalit
një zë që i duhet dhënë zemër,
një shpirt që i duhet dhënë krahë
copëz qielli që kërkon fluturime,
është lule që tek rrezet e diellit
kërkon krahë fluturash e dëshirash
Është mirënjohje e skalitur në gjithçka timen
E birin tënd që përpara rend si vërshim
Është motivi i njeriut të lartësuar në virtyt
Forca që thyen çdo dimension
Që shpërbën çdo distancë ndarjeje
Energji që bashkon zemra dhe ëndrra Nënë,
Sot ulem në gjunj para teje
Si para të vetmit besim
Puth duart e tua dhe i bekoj ata
Si më të lartin shenjtërim
Lutem dhe përlutem me ty e për ty
O engjulli im

DASHURIA

Flakë e shpuzë gjoksi yt ku kokën mbështes
Lotë e vragë vështrimi yt që më pret
Gjak e zjarr kurmi yt që shpërthen
Marrëzisht dalldisur prej teje
Dashuruar dëshirave të mija,
dashuria ime
Dashurija është dhimje
Dhimbe që dhemb thellë në shpirtë
Nuk ka të tashme pa ty
Të shkruar në fletë të verdha kujtimesh
S'ka pa melankolinë tënde
Të nesërme në sirtarët e dëshirave
Nuk ka pa pasionin e dashurisë tënde
Në mungesën tëndë
Në vetminë e trishtë të të gjitha vetmive
Dashuria është e drejta për të dëshiruar
Për tu dashuruar deri në dhimbje
Për tu ndjerë në çdo qelizë
Në çdo frymëmarrje për tu...
Porsi një frymëmarrje kreshtat
sprova për ta ndjerë tërësinë tënde
për të dëgjuar pëshpërimat e zemrës
për të ndier ritmin e vërshimit të gjakut
Çel sythet siç çel lulet natyra
Bashkë me lulet shpërthen ngjyrat
Me dritën, ndrit e përplotesh me hire
Nëpër shikime vezullin si nata me yje
Gjurmëve tuaja zambakë të bardhë çelin
Natë e ditë lëshohesh hareshëm lëndinave
Si mëzat e harbuar të ëndrrave të dlira
Papushim rend në rrugën tënde të pafundme
Kur dimri kaplon mbi qiellin tënd
E prej pemëve ikin gjethët
Dhe picak dalin foletë e braktisura të zogjve
Është dhëmbja ajo që pikon nën këtë strehë
Është grija që ngjyros këtë pamje
Kanë ftohtë zjarret dhe zemrat
Gjaku dhe limfa stuhishëm vërshojnë
Është stina e trishtë e vetmisë
Bashkë me kujtimet
Krejt Maratonmakët e kohërave
Rendin me lirika Petrarkash e sëmbime Laurash
Në rrugëtimin diell-tokë të dashurisë
Kësisoj është ajo, rruga që bën dashurija,
rrugë qellore e shtrur me yje vezullitës është
Ecim pareshtur në këtë rrugëtim
Në këtë përshkim pafund e anë
E s'ndalim askurrë, as si trup e as si shpirtë
Vetëm i bindemi këtij pasioni jete
Hyjnorja Dashuri
Engjëllorja dëshirë e zemrave tona qiellore
Tokësorja ndjenjë e përjetimeve eterne
Unë jam ti e ti je tek unë,
Tek unë je në gjithçka që shoh dhe ndjej
E para thërmijë e ekzistencës
Dhe e fundmja grimcë e jetës
Emrin tënd do të ketë sot e në përjetësi
Dashuri

Kryeqyteti shqiptar Tirana, përjetoj në një prej ditëve të fundmajit, emocionin që krijon një ceremoni vlerësimi. Komuna Kastriot Dibër, kish zgjedhur dy prej emrave të nderuar sportiv të kësaj treve, të dekoroheshin me titullin më të lartë “Qytetar Nderi”, konkretisht për futbollistin e talentuar Qazim Laçi, që luan për ngjyrat e Olimpiakos në Greqi dhe ekipet tona përfaqësuese, por edhe kampionin e botës në fuqi për veteranët, Veli Drizin.

Veprimtaria e ideuar dhe drejtuar nga gazetari sportiv Defrim Methasani, mblodhi në mjediset e Bar Restorant “Pëllumbat e Paqes”, dhjetra personalitete të sportit, këshillin komunal të komunës Kastriot, gazetarë dhe familjarë të sportistëve. Fillimisht është transmetuar një minidokumentar dedikuar mesfushorit të Olimpiakos dhe skuadrave tona kombëtare të moshave, Qazim Laçi. Përmes pamjeve filmike u njoh më nga afër vlera e një talenti shqiptar, i cili ka 8 vjet që luan për klubin më të madh në Greqi.

Kanë folur për vlerat e tij edhe dy menaxherët e ardhur nga Athina, Niko Kaicidhis dhe Vangjel Çavo si dhe Dilaver Laçi dhe babai i tij Emini, ndërsa ka dorëzuar më pas titullin e nderit, kryetari i komunës Kastriot, zoti Hamza Leshi.

Përmes emocioneve të sallës, kryekomunari ka treguar se votimi për dy njerëzit e shquar të sportit ishte unanim dhe ka qenë vërtet kënaqësi që i jepej një mundësi e tillë për ti nderuar figura të tilla të spikatura në sport.

Futbollisti Qazim Laçi, i dekoruar me titullin më të lartë “Qytetar Nderi”, ka pohuar se ishte një ditë historike dhe një mundësi për të qenë me shqiptarë dhe me dibran edhe atje ku jeton.

Me ekran vijë pamjet e kampionit të botës për veteranët në sportin e mundjes, Veli Drizi, i cili ashtu si edhe në rini, konkurron edhe sot me shumë dinjitet. Më pas kanë përshëndetur dhe vlerësuar komunën dhe këtë mjeshtër të tapetit, presidenti i Federatës së mundjes Martin Biba dhe sekretari i përgjithshëm, Ndrim Spahiu. Gazetarja e RTSH Brikena Kuka është ndalur në mënyren se si Dibra dhe

Kastrioti nderon dy sportistë: Veteranin Drizi dhe të riun, Laçi



Kastrioti promovojnë vlera të tilla dhe se një gjest i kësaj natyre motivon më shumë njerëzit e sportit, të ecin përpara.

Kryetari i keshillit komunal, Hamit Pana, ka dorëzuar titullin e lartë “Qytetar Nderi” për zotin Veli Drizi, titull që e ka lënë pa fjalë kampionin e tapetit.

QAZIM LAÇI

është vetëm 19 vjeç. Prej katër vitesh luan për ekipin më të njohur në Greqi, Olimpiakos, me skuadrat e moshave të 15, 17 dhe 19-vjeçarëve.

Aktualisht, ai ka nënshkruar kontratën me skuadrën e parë të Olimpiakos dhe këtë sezon shihet si risia e kampionatit Helen. Ka dy vjet që emri i Qazim Laçit është lakuar shpesh në ekipet tona përfaqësuese të moshave, duke qenë një nga taletet e futbollit shqiptar. Trajneri De Biazi, në një konferencë për shtyp, ka treguar se emri që do lexoni shumë shpejt në kombëtare është ai i Qazim Laçit, ndaj mos u habitni kur ta dëgjoni.

Qazim Laçi ka lindur në fshatin Brest i Poshtëm në komunën Kastriot dhe në moshën 4 vjeçare ka emigruar bashkë me familjen e tij në Athinë.

Komuna Kastriot Dibër, kish zgjedhur dy prej emrave të nderuar sportiv të kësaj treve, të dekoroheshin me titullin më të lartë “Qytetar Nderi”, konkretisht për futbollistin e talentuar Qazim Laçi, që luan për ngjyrat e Olimpiakos në Greqi dhe ekipet tona përfaqësuese, por edhe kampionin e botës në fuqi për veteranët, Veli Drizin.

VELI DRIZI

Një nga figurat qendrore të mundjes dibrane dhe asaj shqiptare. Ish kampioni dhe fituesi i shumë titujve e medaljeve në sportin burror të mundjes, vazhdon edhe sot me të njëjtin pasion ta ushtroje atë.

Në vitin 2011 u shpall kampion bote në mundjen e lirë në kampionatin botëror, që u mbajt në Tiranë, ndërsa në vitin 2013, ai u rendit nënkampion bote në botërorin e Hungarisë. Ka ushtruar edhe sportin e xhudos dhe njihet si afirmues i këtij sporti dhe trajner e specialist i kësaj gjinie sportive. *“Korresp.Rr.A”*

“Dashin me bojna” dhe Kupën e fiton Bardhyl Karasani

54 sportistë ndeshen në tre kategori. Një veprimtari sportive që vazhdon traditën

Më 21 Maj 2015 u zhvillua në Ostren “Kupa Tradicionale e Mundjes të Gollobordës”, organizuar nga Shoqata Kombëtare e Mundjes Shqiptare dhe Shoqata Sportive “Golloborda”.

Ceremonia e hapjes u zhvillua mjediset e shkollës së mesme, Ostren, mes entuziazmit të banorëve, veteranëve të mundjes dhe mundësve popullore nga gjithë fshatrat e komunave Ostren, Trebisht dhe Stebleve.

Grupi i valleve me veshje të krahinës dhe këngëtar Hajredin Gjeta dhanë një program me valle popullore dhe këngë patriotike.

Një fotoekspozitë me 320 fotografi e hapur në mjediset e shkollës tregonte një historik të mundjes tradicionale në Gollobordë. “Ekspozita fotografike pasqyron mjaft mirë traditën, vlerat dhe kontributin në vite të mundësve Gollobordas dhe më gjerë. Jemi përpjekur të evidentojmë të gjithë mundësit popullore që kanë zhvilluar ndeshje në festa e dasma, mundësit që kanë konkurruar në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare, trajnerët etj., thotë Xhelil Cibaku, sekretari i Shoqatës Kombëtare të Mundjes Shqiptare.

Gjatë fjalës së tij përshëndetëse, Cibaku tha se “mundja popullore, tradicionale e krahinës së Gollobordës ka lindur shekuj më parë, duke u kultivuar në vazhdimësi në rastet e festave popullore dhe dasmave e gëzimeve në të gjithë fshatrat”. Për traditën kombëtare Shqiptare të mundjes tradicionale në Gollobordë flet fakti që ndeshjet e mundjes, si në dasma dhe festa popullore zhvilloheshin në praninë e Bajrakut dhe Flamurit Shqiptar.

Mundësit popullore të krahinës së Gollobordës janë shquar jo vetëm në garat e mundjes të zhvilluara me rastin e festave dhe dasmave në fshatrat e krahinës, por edhe në pjesëmarrjet e mundësve më të mirë dhe më të forte të krahinës në garat jashtë kufijve zyrtarë të Shqipërisë, si në Dibër të Madhe, Strugë, Tetovë,



Mundja - Foto © Fehmi Lleshi

Gostivar e Shkup dhe më herët deri në Selanik e Stamboll.

Pas çlirimit të vendit, thekson Cibaku, aktiviteti i parë zyrtar i Mundjes në Qarkun e Dibrës është zhvilluar në vitin 1954 në Ostren. Në atë aktivitet kanë marrë pjesë mundësit më të mirë të Gollobordës, por edhe nga Peshkopia, Shupenza, Bulqiza, Maqellara, Klosi, Burreli etj. Në këtë aktivitet u zgjodh ekipi përfaqësues i Qarkut të Dibrës, të gjithë mundës nga fshatrat e Gollobordës, me trajner mundësin e shquar, “Nderi i Mundjes Shqiptare”, Hiqmet Elezi dhe përgjegjës ekipi Shaban Saden nga fshati Tucep. Organizatore të atij aktiviteti kanë qenë Ismet Bellova, ish inspektor i Fiskulturës së Qarkut Dibër, komentator i shquar sportiv dhe z. Rexhep Rama, Inspektor i sporteve të rënda në Ministrinë e Arsimit.

Në vitin 1962 për herë të parë u zhvillua aktiviteti kombëtar i mundjes në Ostren (Lagjen e Gurit), me pjesëmarrjen e mundësve më të shquar nga gjithë Shqipëria.

Golloborda është djepi i mundjes Shqiptare. Mundësit nga Golloborda, krahas përfaqësimit me dinjitet dhe rezultate të larta të ekipit “Korabi”, kanë furnizuar të gjithë ekipet e mundjes që nga Partizani, Dinamo, 17 Nëntori, Durrësi, Fieri, Elbasani, Berati, Shkodra, Kukësi etj., duke u shpallur kampionë kombëtarë, mjeshtra dhe mjeshtra të merituar të sportit, nderi i mundjes Shqiptare, nderi i mundjes Dibrane etj. Disa prej tyre kanë përfaqësuar dhe nderuar Shqipërinë në veprimtari ndërkombëtare, duke ngritur lart Flamurin Shqiptar.

Ky është një nder i madh që këta djem të fortë i kanë bërë Gollobordës, Dibrës dhe

Kombit tonë, thota Xhelil Cibaku.

Kupën e Mundësit më të fortë të krahinës së Gollobordës në vite e mori Mjeshtri i Sportit dhe Nderi i Sportit Shqiptar, Rrahim Rama. Me kupa u nderuan mundësit kampionë nga Golloborda Fiqiri Osmani, Qamil Muca, Njazi Karasani dhe Haxhi Dani, ndërsa mundësja Laura Rama u nderua me medaljen “Nderi i mundjes së Gollobordës”. Me medalje “Nderi i Mundjes Shqiptare” dhe “Nderi i mundjes së Gollobordës” disa mundës. Në orën 12 filluan edhe ndeshjet zyrtare për këtë kampionat. Gjyqtaria kryesohej nga Tasim Bixhi, Besnik Shehu dhe Nexhi Dordabelli, ndërsa gjyqtarë të ndeshjeve ishin vendasit Shefqet Karasani dhe Reiz Avdia. Ndeshjet u zhvilluan me sistem eliminimi.

Për brezin e tretë (mosha shkollore) konkurruan 24 mundës. Pas 21 ndeshjeve fitues i vendit të parë u shpall Marsild Muça nga Ostreni.

Për brezin e dytë (mosha deri 20 vjeç) konkurruan 20 mundës dhe pas 18 ndeshjeve fitues i vendit të parë u shpall Ilir Rexhepi nga fshati Smollik. Mes emocioneve, ovacioneve dhe garës shumë të fortë sportive u zhvilluan ndeshjet për brezin e parë, trofeun e Kupës: fitimin e dashit të zbukuruar me lule e ngjyra. Konkurruan 10 mundës, mjaft prej tyre edhe ish kampionë kombëtarë dhe mjeshtra sporti. Në finale u ndeshen Bardhyl Karasani nga Radoveshi dhe Asllan Osmani nga Trebishti. Ndeshja zgjati 23 minuta dhe u fitua nga Bardhyl Karasani, i cili fitoi “Dashin” dhe Kupën e Aktivitetit.

Kjo veprimtari do të mbahet mend gjatë në Ostren, sidomos të rinjtë. Këto ngjarje sportive i shërbejnë edukimit të rinisë me traditë kombëtare, kulturën sportive, i mban ata larg alkoolit, drogës dhe veseve të keqia; nxisin komunikimin, bashkëpunimin dhe zhvillimin e turizmit kulturor e sportiv.

Korresp. Rr.A.

Figura e femrës në letërsinë shqipe

Stërmilli, Kokalari, Migjeni, Koliqi

Nga Dr. VIRON GRAÇI*

Punimi i Mentor Hoxhës ka një objekt të qenësishëm: figura e femrës në letërsinë shqipe të viteve '30. Po ashtu tema bëhet më e rëndësishme sepse janë katër autorë të dalluar të letërsisë shqipe: Haki Stërmilli, Musine Kokalari, Migjeni, Ernest Koliqi. E, duke e parë sipas shtirjes gjeografike-etnozakonore, duke përjashtuar krijimtarinë e Musinesë, ky punim dhe autorët e trajtuar/analizuar prej tij bëhet njëkohësisht analizë etno-zakonore e juridiko-morale të Shqipërisë Veriore. Nisur nga shprehje letrare të fuqishme, sikurse janë veprat e autorëve të trajtuar këtu, M. Hoxha ka mundur të dallojë mirë dhe ti shprehë me saktësi temat mbizotëruese, dhe, në radhë të parë, personazhet femra dhe problematikën e tyre.

Në kapitullin e parë kemi: karakteret femërore në veprën e Haki Stërmillit- dhe hetohet në imtësi sipas objektit vepra e Stërmillit. Këtu mund të duket pak e diskutueshme emërtesa -at-dhetarizmi i guas dibrane. Statusi real shoqëror-familjar i femrës së asaj kohe, niveli kulturor dhe mënyra e jetesës e pamundëson krijimin dhe përshfaqjen e një vetëdije të tillë. Dhe në letërsinë artistike të autorëve të sjellë këtu, për shkak të prapambetjes së thellë të mënyrës së jetesës, femra ka mundësinë të kristalizojë në vetëdijen e saj ëndrra dhe horizonte që kapërcejnë territorin e saj të banimit.

Në kapitullin e dytë: imazhe femërore në letërsinë e Musine Kokalarit, ka gjëra mjaft interesante, por vihen re disa gjëra të panevojshme, pavarësisht kërkimeve sistematike e përqasjeve diakronike të autorit.

Në kapitullin e tretë: Migjeni dhe Koliqi, ngjashmëri dhe përqasje të karaktereve femërore në letërsinë e tyre. Mund të thuhet se ky kapitull është pjesa më përfaqësuese, më e realizuar dhe më e arrirë nga ana metodologjike e punimit. Lënda, analiza dhe përfundimet janë përimtësuar në 9 sytha (nënçështje) e kjo ka bërë më sistematik e më të qartë si lëndën e parë letrare të cituar ashtu dhe argumentat teoriko mbështetës, cituar nga kritika jonë ose dhe mendime origjinale të autorit.

Mund të evitoheshin disa shprehje dhe kategorizime të ligjëritimit bisedor, psh: "zgjimi i popullit shqiptar...", "kundër artit zyrtar të kohës" kjo mund të zvendësohet me autoritetet letrare të kohës", "me Migjenin dhe veprën e tij është marrë Metoda e Realizmit socialist", "kritika komuniste"; ose tatuologji si risi të reja.

Mentor Hoxha

Figura e femrës në letërsinë shqipe

Stërmilli - Kokalari - Migjeni - Koliqi



BOTIMET M & B

FIGURA E FEMRËS NË LETËRSINË SHQIPE (STËRMILLI, KOKALARI, MIGJENI, KOLIQI)

Redaktor: Prof. Dr. Shaban Sinani

Recensa: Dr. Viron Graçi

Korrektore: Miranda Goleci

Çmimi: 500 lekë, 5 Euro.

Kontakt: mentor_hoxha67@hotmail.com

Përmendëm më sipër disa vërejtje të cilat do ta përmirësonin dhe më tepër punimin e M. Hoxhës, por, në gjendjen e paraqitur punimi meriton vlerësimet më të larta. Autori ka lexuar dhe vjelë literaturë të bollshme nga letërsia artistike, nga studimet tona letrare dhe kritika më përfaqësuese për secilin autor. Po ashtu, punimi është konceptuar drejt e kjo ka mundësuar jo vetëm zberthimin e hollësishëm të objektit të punimit, por edhe përcjelljen me saktësi e qartësi të përfundimeve dhe arritjeve.

Përfundimisht mund të themi se kemi të bëjmë me një punim të realizuar me standartet e duhura kërkimore-shkencore. Është shtruar drejt ana konceptuale një tezë e qenësishme për studimet tona letrare, janë trajtuar me një gjuhë të shkathët e korrekte njëkohësisht të gjitha objektivat e paralajmëruara në hyrjen e punimit. Kështu mendoj se tema "Figura e femrës në letërsinë shqipe" meriton vlerësimet më të larta.

* Qendra e Studimeve Albanologjike

Botim i ri

NAIM BERISHA



Dashurinë ta lë në shpirt

Hajke

BOTIME M & B

Naim Berisha

DASHURINË TA LË NË SHPIRT - Hajke

Botimet M&B ISBN: 978-9928-172-50-1

116 faqe, Çmimi: 400 lekë

"Dashurine ta lë në shpirt" është libri më i ri i Naim Berishës. 420 hajket e këtij vëllimi vijnë pas librit të parë me Hajke "Gjindja kishte ngrënë egjë" dhe në planet e afërta të autorit është të botojë edhe hajke të tjera, me synimin të kapë numrin 1001!

HAIKU është forma e artit poetik më të preferuar në letërsinë japoneze. Ai ndërtohet me tri linja ose tre vargje, me një ritëm prej 17 rrokjesh. Dikur, në fillimet e veta, ai shprehej, si në një vijë të drejtë, në një linjë, pra, një rresht a varg të pathyer. Më pas u parapëlqye të thyhet në tre vargje, përkatësisht në: 5-7-5 rrokje.

Naim Berisha është njëri nga të rrallët poetë shqiptare që po e lëvron poezinë trevargëshe, me besimin se do të pëlqehet nga lexuesi...

Pajtohu në gazetën RRUGA E ARBËRIT

Merr versionin PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj



Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë.

ÇMIME TË ARSYESHME për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.

Për individët, njoftimet deri në 50 fjalë (1/16 e faqes) ofrohen falas!

Për informacion:
E-mail: rrugearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603

FTESE PËR BASHKËPUNIM

Gazeta "Rruga e Arbërit" në bashkëpunim me Botimet M&B ka në projekte për disa veprimtari dhe botime në fushën e kulturës, me vlera historike, kulturore dhe kombëtare për Dibrën dhe gjithë Shqipërinë.

Ftojme individë, shoqata apo institucione vendore të bëhen bashkërealizuese të këtyre projekteve.

Për më shumë informacion mund të shkruani në email

mmbotime@gmail.com, rrugearberit@gmail.com

ose mund të telefononi në numrin **069 20 68 603**.

Faleminderit!

Librat e botuar nga Botimet M&B mund ti gjeni në Tiranë pranë librarisë së Shtëpisë

Botuese M&B, në rrjetin e librarive "Adriion",

si dhe në disa librari kryesore në Tiranë.

Në Peshkopi: Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.

Në Durrës: Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353

Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603 068 65 08 441 / 067 30 73 265

E-mail: mmbotime@gmail.com